Rruga Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 11 (67). NENTOR 2011. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

Market KEN
Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

AKTUALITET

Minatorët e vrarë, familjet në mjerim

Nga: **HYSEN LIKDISHA** - FAQE 5

PERSPEKTIVË

Mrekullitë e mollës

Nga: **DR. SELMAN MEZIU** - FAQE 8-9

STUDIM

Oena - qyteti i vjetër i Ilirisë

Nga: **DR. ISLAM CANIA**- FAQE 6

VENDLINDJA

Brezhdani i urbanizuar që në mesjetë

Nga: **FATMIR XHARRI**- FAQE 7

Të shpëtojmë Radikën!

Maqedonia i shfrytëzon resurset natyrore të qyteteve shqiptare

Nga **BARDHYL MARKU** *

Dibranë të nderuar,

Më rastisi të takohem me disa persona, me të cilët kohë më parë kemi bashkëpunuar në kuadër të aktiviteteve të mia ambientaliste me shoqatën ekologjike "Deshat" Dibër, të cilët më dhanë një alarm për të cilin mendoj se duhet të senzibilohen të gjithë qytetarët në Dibër por edhe më gjerë dhe të reagohet në mënyrë adekuate.

Bëhet fjalë për planet e ELEM-it (respektivisht të Z. Çingoski) që si e si të risë profitin e kompanisë të cilën ai e udhëheq, duke mos mare parasysh aspak normat në fuqi për ruajtje të ambientit dhe ligjet pozitive në Maqedoni të cilat rregullojnë këtë sferë.

Dy janë elementet të cilat e tangojnë komunën tonë, ndërtimi i pendës në fushën e Lukovës dhe i asaj ne urë të Boshkut.

Lidhur me ndërtimin e urës së Boshkut nuk kam shumë informata dhe nuk e di se cilat do jenë pasojat për Radikën dhe liqenin e Dibrës, por shpresoj strukturat kompetente në Dibër të jenë më për së afërmi të informuar për këtë plan dhe pasojat e tij qofshin pozitive apo negative.

Ndërtimi i vetë pendës në fushë të Lukovës ndoshta nuk është alarm edhe aq i madh për Dibrën dhe dibranët, pasi ajo do të ndërtohet në pjesë të parkut nacional të Mavrovës, por alarmi për ne ndizet kur kuptojmë se për të furnizuar me ujë këtë pendë të re, do të bëhet kapja e të gjitha ujërave nga pellgjet të cilat sot e furnizojnë lumin e Radikës dhe me kanal special nëntokësor (të gjatë disa kilometra) do ti dërgojnë në liqenin e ri të fushë Lukovës, ndërsa prej atje këta ujëra do vazhdojnë rrugën dhe pasurojnë basenin e lumit Vardar. Pra, po përsëritet diçka e cila njëherë ndodhi para 60 vitesh me ndërtimin e liqenit të Mavrovës, me çka u ndryshua rrjedhja normale e shumë ujërave të pellgut të Radikës, por më planin më të ri nuk do të bëhet vetëm kapja e ujërave të Radikës por do të bëhet tharja totale e këtij lumi. Pasojat e këtij plani nuk përfundojnë me kaq, pasojat janë pjesë e zinxhirit ekologjik. ...

(Lexoni ne faqen 3)

Lumi i Radikës. Foto: Gazmend Kërkuti

Ismail Keta shpallet kampion bote në Taiboks

Një titull për të gjithë shqiptarët

FAQE 12



Historia e panjohur e luznakut, kampioni bote

Akim Manuka, kampioni që nuk njihet...!

NGA: **DEFRIM METHASANI** FAQE 13

Posta e Rruga Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 11 (67). 1 - 30 Nëntor 2011

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Njoftojmë zotërinjtë Mevlud Buci, Nikollë Kola, Hajri Mandri, Islam Çenga se shkrimet e tyre jane planifikuar për numrat e ardhshëm.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**
JU LUTEMI, QË SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAILIT, TË KENË PATJETËR ZANOREN "Ë".
Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!



DREJTOR:
Rakip Suli

KËSHILLI BOTUES:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Kontribuan për këtë numër:

Rexhep TORTE
Hysen LIKDISHA
Vesel HOXHA
Enver KALOSHI
Rexhep DODA
Zamira GJELESHI
Eralda SKARRA
Ilmi DERVISHI
Islam CANI
Defrim METHASANI
Aqif KARAJ
Destan RAMA
Faik XHANI
Dita TORTE
Dionis XHAFA
Fatmir XHARRI
Selman MEZIU

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Vjeshtë pa gjethe në Peshkopi

Nga **SHAQIR SKARRA**

Mëngjesi i nëntorit është i ftohtë në Peshkopi e rrallë shikon njerëz që pinë kafen në tavolinat jashtë lokaleve. Shumica futen brenda ku dhe tymosin pa pushim cigare edhe pse ligji anti duhan është në fuqi. Drurët janë çveshur nga gjethet e vjeshtës që kanë filluar të bien e pastrueset kanë punë më shumë se në çdo stinë tjetër. Rrallë gjen drurë me gjethe në Peshkopi këtë mëngjes të ftohtë nëntori. Fundja agrume si limone, portokalla, mandarina që të rrinë të gjelbërta edhe në stinën e dimrit nuk ka në Peshkopi. Këtu ka hardhi, mollë, kumbull, qershi e gjethet e tyre kudo që të vendosësh këmbën i ke nën vete. Kështu është dhe vetë qyteti në vjeshtë, pa gjethe por dhe kjo stinë është e bukur se dhe pemët e çveshura kanë të veçantën e tyre. Një natë më parë kisha udhëtuar nga Tirana për në Peshkopi por nuk kisha menduar se do bënte kaq ftohtë e domosdo isha veshur dhe paksa hollë. Dola herët në mëngjes nga hoteli se e kisha lënë të takohesha me një shokun tim Haki Përnezhën. Në stinën e vjeshtës qytetit të bukur të Peshkopisë i shtohen mysafirët. Vijnë nga zona të ndryshme të vendit. Në çdo orë të ditës qyteti është i zhurmshëm, lokalet frekuentohen, gjithashtu dhe biblioteka e qytetit. Por më e populluar është shëtitorja e bukur e këtij qyteti që e veshur në të dyja anët me blirë dukesh se futesh në një tunel, por në një tunel plot dritë e të gjelbëruar. Në stinën e pranverës dhe verës aroma karakteristike e blirit të ngacmon hundët që larg. Në fakt qytetit të Peshkopisë vetëm shëtitorja i ka mbetur ende e gjelbër se sa për hapësira të tjera nuk ka më, as ato ekzistueset e as hapësira të reja nuk janë ndërtuar. Por dhe kësaj shëtitorje të bukur e të veçantë nga shumë qytete të vendit tonë i janë shkulur me kohë stolat anash saj që uleshin e çlodheshin qytetarët dikur. Në lokal ku u futa nuk gjeta vend bosh, vetëm në një tavolinë në cep, një plak me gotën e rakisë para po tymoste një cigare të dredhur. E pa se isha në kërkim të një tavoline ndaj më ftoi me gjithë zemërsinë e tij.

-Jam nga Vlora me origjinë por ka vite që banoi në qytetin e Laçit , nisi bisedën i pari plaku. Sulo e kam emrin por jo ai Suloja i kapedanit. Jam Sulo i thjeshtë unë dhe jam kapedan e shkuar kapedanit brenda shtëpisë time por gratë nuk i urrej. Ato janë gjysma e botës. . Kam ardhur që mbrëmë në Peshkopi se mbesa ime vazhdon studimet këtu e ndaj që djalin e kam emigrant kam udhëtuar vetë që të shikoi mbesën. Kam ardhur shpesh në Peshkopi. Isha dhe para një muaj ku qëndrova plot dy javë. Vij bashkë me plakën time për llixha pasi janë llixhat më të mira në vend dhe mjaft kurative. Unë ka pesë vite që i frekuentoi rregullisht. Do t'i që në fakt më kanë bërë mirë. Sikur të kishin qenë në një vend tjetër këto llixha e të ishte investuar ma shumë besoi se nuk do ishin në këtë gjendje që janë sot këtu. Ju dibranët e keni turzmin dhe nuk dini ta menaxhoni bukur. Lugina që të çon tek llixhat e ku mes për mes kalon përroi i banjave siç i thoni ju, rrallë kund ndodhet por që natyra vetëm ju dibranëve bashke me llixhat ua ka falur dhe nuk dini ta mbani siç duhet. . Është katandisur si mos më keq, si mall pa zot. Shtëpitë e shumta me leje e pa leje janë ndërtuar në të dyja anët e luginës, pa asnjë lloj kriteri urbanistik dhe së shumti këto shtëpi janë kthyer dhe në hotele private ku në një prej tyre unë sivjet qëndrova plot dy javë. Sikur të ishin ndërtuar shtëpi të bukura, të veshura dhe me drurë që Dibra shquhet për këto punime, të ishin ngritur dhe hotele kësaj lugine, të ishte sistemuar dhe përroi i llixhave siç është sistemuar Lana në Tiranë ,të kishte gjelbërim pranë llixhave e vend për çlodhje do ishte vërtet një mrekulli. Mjaftojnë vetëm pak stola druri dhe këtu i shikon klientët e llixhave me peshqir në dorë kur asapo dalin nga banjot dhe nuk ka asnjë pjesë të gjelbërt. Biseda me xha Sulon më bëri që të shkoj njëherë nga llixhat, kisha vite pa e shkelur atë zonë qysh kur bënim zborin ushtarak e flinim natën poshtë plepave dhe akacieve që ishin të shumtë në këtë luginë. Pasi erdhi Hakiu, u përshëndetëm me xha Sulon dhe u nisëm drejt llixhave. Rruga ishte e shtruar por mjaft e ngushtë që në periudhën e llixhave kur domosdo që dhe lëvizje ka shumë makinat e kishin vështirë, por duhej menduar që larg ndonjë xhep që të priste njëra e të kalonte tjetra . Dy shpatet , në të dyja anët e përroit ishin zënë me shtëpi të pa sistemuara fare. Shtëpitë dhe ndërtesa të ndryshme kishin ardhur deri në afërsi të rrugës. Sytë nuk më zunë as një plep të vetëm, ndaj u binda se plaku nga Vlora paska patur të drejtë. Shqetësimin tim e vuri re Hakiu ndaj me buzë në gaz mu kthye:

-T'i flet për një kohë që sot i themi e shkuar. Jetojmë njëzet e kusur vjet më vonë e është vërtet një realitet krejt ndryshe, një realitet dhe pse mjaft i hidhur duhet pranuar. Sot ja shikoje luginën e dikurshme ku ishte e veshur me pemë të ndryshme tashmë nuk ka mbetur asgjë nga ajo kohë që kujton ti. U larguam nga llixhat e Peshkopisë vërtet të trishtuar . Për zonat e gjelbërta të qytetit që kanë qenë dikur e dija se nuk ekzistonin ma dhe ishin fshirë vite ma parë nga harta si të gjelbërta. Tek kinemaja apo ish shtëpia e kulturës e vetmja që të kujton dikur këtë lulishte është busti i Heroit të Popullit Gjok Doçi që dhe ai mezi dukej. I ramë rreth e qark qytetit të Peshkopisë bashkë me mikun tim Haki Përnezha por sytë nuk po na shikonin as gjelbërim, as stola për çlodhje që në fakt ka patur dikur. Dikur një lulishte e bukur ka qenë në dalje të qytetit. Këtu u ndërtua dhe një çezme e bukur me gur mermeri të kuq, me ujë që vinte nga bjeshkët e Korabit ku furnizonte qytetin e Peshkopisë. Pikërisht në këtë lulishte e në këto stola çlodheshin udhëtar të shumtë që vinin nga fshatrat e thella në këmbë në Peshkopi, pinin ujë të ftohtë akull që vinte nga thellësitë e bjeshkëve dhe aty pleqtë flokë bardhë edhe dredhnin nga një cigare me duhan të fortë e shkëmbenin ndonjë muhabet dibre.

–Eh ç'na i kujtove ato çezme të bukura me ujë Korabi, thotë Hakiu. Vërtet ka një histori të dhimshme qyteti i Peshkopisë për punën e ujit të pijshëm. Më para pikërisht ky ujë që vinte nga bjeshkët furnizonte jo vetëm qytetin por dhe fshatrat që kalonte tubacioni. Të kishte ndodhur kjo ngjarje në Shkodër apo në ndonjë vend tjetër do ti kishte dalë pa tjetër dhe anekdoda e humorit. Nejse historia e ujit të pijshëm që sot ende vuan Peshkopia është mbyllur, është mbyllur dhe abuzimi që u bë me atë ujësjellës që do furnizonte qytetin e Peshkopisë me ujë të pijshëm porn ë fakt janë qytetarët ato që nuk e mbyllin lehtë se prapë vuajnë pasojat e këtij abuzmi korruptiv. Në fakt që pa nisur, u kritikua ky projekt nga specialist se uji ishte i pa pijshëm por veshët u bënë të shurdhër apo që deshën t'i bëjnë të shurdhër filluan pa marrë parasysh pasojat që mund të vinin zbatimin e këtij projekti. Dhe doli ajo që doli. Erdhi uji në Peshkopi por askush nuk i vu buzët e zhuritura të pinte në të. Lekët ikën e domosdo dëmi ishte i madh por asnjëherë nuk u muar vesh se sa ishte në fakt fondi që u shpërdorua kot, kush mbajti përgjegjësi për të etj. Asnjëherë nuk u muar vesh për këtë projekt misterioz. Nejse nuk ishte qëllimi i këtij reportazhi problem i ujit të pishëm. Për vetë banorët e Peshkopisë ka probleme edhe më të mëdha që media po flet e shkruan, banorët shqetësohen dita ditës e pushteti ka rënë në gjumë të thellë. Këtu varfëria është më e ndjeshme se në çdo vend tjetër dhe papunësia është ulur këmbë kryq mes qytetarëve. Shumica jetojnë me një asistencë që asistencë i thënçin se nuk mjafton të blesh ushqime as për një javë. Vonë, shumë vonë kur qepenat e dyqaneve ishin ulur, shëtitorja ishte boshatisur paksa , dritat e pallateve filluan të ndizen, u nisa drejt Tiranës, me shpresë se herën tjetër kur të ktheheshim, vendlindja jonë do të kishte ndryshuar, këtu do të ishte një realitet krejt ndryshe. Shpresojmë!

aktualitet

Maqedonia i shfrytëzon resurset natyrore të qyteteve shqiptare

ELEM ia merr ujërat natyralë Dibrës së Madhe

Dibranët kohëve të fundit janë tejet të shqetësuar dhe indinjuar lidhur me vendimin e Eletro Maqedonisë për ndërtimin e dy hidrocentraleve, njërin te Ura e Boshkut te Dibra e Madhe dhe tjetrin te Fusha e Llukovës në trekëndëshin Maqedoni-Kosovë Shqipëri.

Gazmend Cami, kryetar i Shoqatës Ekologjike "Deshat" në Dibër të Madhe, thotë se, " Ndërtimi i Hidocentralit te Ura e Boshkut ka ndikim negative, sepse kapja e ujit të Lumit Radikë dhe e përrenjve tjerë dhe futja e tyre në tunelin 9 kilometra të gjatë do ta zvogëlojë sasinë e ujit në këtë segment, do ta zvogëlojë gjithashtu edhe Përroin e Gajres, do të ndikojë negativisht në mundësitë e mbijetesës së llojeve të ndryshme të biodiversitetit, dhe do t'i rrezikojë dukshëm bukuritë natyrore që kësaj zone i japin rrjedhjet e përrenjve".

Ndërkaq sa i takon Hidrocentralit në Fushën e Llukovës, shton Cami, "ai do të ndikojë negativisht në biodiversitetin e Parkut nacional të Mavrovës, do ta zvogëlojë rrjedhjen e Lumit Radikë, që konsiderohet lumi më i pastër në Ballkan dhe Evropë me resurse të shumta për zhvillimin e turizmit natyror. Për këtë hidrocentral ujërat që do të kapen nga përrenjtë e Zonës së Dibrës së Madhe dhe me tunel nëntokësor do të dërgohen në në akumulimin e liqenit Fusha e Llukovës, dhe nuk do të derdhen më në pellgun e Drinit të Zi në drejtim të Shqipërisë dhe Detit Adriatik, por do të ndërrojnë drejtimin e do të derdhen në pellgun e Lumit Vardar në drejtim të Detit Egje. Po përsëritet e njejta situatë kur para 60 viteve me ndërtimin e Liqenit të Mavrovës u ndryshua rrjedhja natyrale e shumë përrenjve që furnizonin me ujë Lumin Radikë dhe u orientuan në drejtim të Liqenit të Mavrovës dhe të Lumit Vardar. E tërë kjo do të ndikojë edhe në shterrjen totale të Lumit Radikë, që është në kundërshtim të plotë edhe me ligjet ndërkombëtare për shfrytëzimin e ujërave. Zvogëlimi i sasisë së ujit në Lumin Radikë do të ndikojë negativisht edhe në pastrimin e Liqenit të Dibrës nga ndotja që i behet përmes ujërave të zeza që vijnë nga Ohri e Struga nëpërmjet Lumit Drini i Zi", thotë Gazmend Cami.

Hidrocntrali te Ura e Boshkut në akumulimin e tij do të kap ujërat e Radikës, të Përroit të Jadovit, Mogorçës, Gajres dhe Jamës.

Hidrocentrali Fusha e Llukovës me akumulimin e tij do të kap ujërat e Radikës, Përroit të Cektë, Guri i Kuq, Niçpur, Grekaj, Përroit të Peshkut dhe Zhuzhnjë.

Është për tu habitur se nuk janë mbajtur as debate të mjaftueshme publike për aspektet ekologjike të këtyre dy hidrocentraleve që do të ndërtohen.

Zvogëlimi sasisë së ujit në Lumin Radikë do të ndikojë negativisht edhe në pastrimin e liqenit të Dibrës, i cili në vazhdimësi ndotet nga ujërat e zeza që nëpërmjet Drimit të Zi vijnë nga Ohri e Struga.

Ky shqetësim i dibranëve vjen gati pas një shekulli, dhe koinçidon me vigjiljen e 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, pas së cilës në vitin 1913 Serbia sulmoi e gllabëroi trojet shqiptare sëbashku me Dibrën e Madhe. Këtij gllabërimi i ndihmoi edhe Konferenca e Ambasadorëve në Londër në vitin 1913 dhe Konferenca e Paqes në Paris 1919-20, kur Dibra e Madhe iu dhurua Beogradit, e që sot ka mbetur në Maqedoni. Gjatë vendosjes së kufirit në Krahinën e Dibrës nuk u zbatua as konfiguracioni natyror tokësor dhe as vullneti politik i dibranëve.

Shkrimtarja amerikane Rous Uajder Lein në vitet e 20-ta të shekullit 20-të, në librin e saj "Majat e Shalës", shkruante se "Qyteti i Dibrës iu muar Shqipërisë me vijën kufitare të vitit 1913, siç nxirret sythi i një patateje". Ndërkaq Dimitrije Tucoviq, reformatori serb, në librin "Serbia dhe Shqipëria", duke përshkruar gjendjen e krijuar në viset shqiptare të aneksuara nga Serbia, thotë se, "aneksimi ndau bujkun prej arës, bagëtinë prej kullotës, tufën prej lugjeve, fshatin prej mullirit, blerësin dhe shitësin nga tregu, rrethin prej qytetit dhe tërë viset malore prej qendrës së tyre ekonomike e hambarët e ushqimit...burimet e jetës u prenë".

Në vitet e 50-ta të shekullit të 20 –të Dibra e Madhe ishte Qark dhe adminitronte gjer në Mavrovë. Në vitet e 60-ta po të këtij shekulli Ohri u bë Qark dhe Dibra e Madhe mbeti nën administrimin e Ohrit. Ndarjet territoriale që u bënë gjatë 20 viteve të demokracisë në Maqedoni me krijimin e komunave të reja Mavrovë – Rostushë dhe Qendër Zhupë, Dibra e Madhe pësoi tkurrje tjera territoriale dhe në popullatë. Aktualisht Dibra e Madhe ka mbetur me 145 kilometra katrorë dhe me popullatë prej afër 20 mijë banorë.

Nëse Dibrës së Madhe i merren edhe ujërat natyrorë të përrenjëve dhe të Lumit Radikë, kjo don të thotë ta çosh këtë qytet legjendar drejt vdekjes së sigurtë. Ndaj duhet ngritur zëri që kjo të mos ndodh.

Rexhep TORTE

Ndërtimi i Hidocentralit te Ura e Boshkut ka ndikim negative, sepse kapja e ujit të Lumit Radikë dhe e përrenjve tjerë dhe futja e tyre në tunelin 9 kilometra të gjatë do ta zvogëlojë sasinë e ujit në këtë segment, do ta zvogëlojë gjithashtu edhe Përroin e Gajres, do të ndikojë negativisht në mundësitë e mbijetesës së llojeve të ndryshme të biodiversitetit, dhe do t'i rrezikojë dukshëm bukuritë natyrore që kësaj zone i japin rrjedhjet e përrenjve".

Zvogëlimi sasisë së ujit në Lumin Radikë do të ndikojë negativisht edhe në pastrimin e liqenit të Dibrës, i cili në vazhdimësi ndotet nga ujërat e zeza që nëpërmjet Drimit të Zi vijnë nga Ohri e Struga.

Është për tu habitur se nuk janë mbajtur as debate të mjaftueshme publike për aspektet ekologjike të këtyre dy hidrocentraleve që do të ndërtohen.

Nëse Dibrës së Madhe i merren edhe ujërat natyrorë të përrenjëve dhe të Lumit Radikë, kjo don të thotë ta çosh këtë qytet legjendar drejt vdekjes së sigurtë. Ndaj duhet ngritur zëri që kjo të mos ndodh.

SHENIM

Të shpëtojmë Radikën!

Nga **BARDHYL MARKU ***

Dibranë të nderuar,
Më rastisi të takohem me disa persona, me të cilët kohë më parë kemi bashkëpunuar në kuadër të aktiviteteve të mia ambientaliste me shoqatën ekologjike "Deshat" Dibër, të cilët më dhanë një alarm për të cilin mendoj se duhet të senzibilohen të gjithë qytetarët në Dibër por edhe më gjerë dhe të reagohet në mënyrë adekuate.

Bëhet fjalë për planet e ELEM-it (respektivisht të Z. Çingoski) që si e si të risë profitin e kompanisë të cilën ai e udhëheq, duke mos mare parasysh aspak normat në fuqi për ruajtje të ambientit dhe ligjet pozitive në Maqedoni të cilat rregullojnë këtë sferë.

Dy janë elementet të cilat e tangojnë komunën tonë, ndërtimi i pendës në fushën e Lukovës dhe i asaj ne urë të Boshkut.

Lidhur me ndërtimin e urës së Boshkut nuk kam shumë informata dhe nuk e di se cilat do jenë pasojat për Radikën dhe liqenin e Dibrës, por shpresoj strukturat kompetente në Dibër të jenë më për së afërmi të informuar për këtë plan dhe pasojat e tij qofshin pozitive apo negative.

Ndërtimi i vetë pendës në fushë të Lukovës ndoshta nuk është alarm edhe aq i madh për Dibrën dhe dibranët, pasi ajo do të ndërtohet në pjesë të parkut nacional të Mavrovës, por alarmi për ne ndizet kur kuptojmë se për të furnizuar me ujë këtë pendë të re, do të bëhet kapja e të gjitha ujërave nga pellgjet të cilat sot e furnizojnë lumin e Radikës dhe me kanal special nëntokësor (të gjatë disa kilometra) do ti dërgojnë në liqenin e ri të fushë Lukovës, ndërsa prej atje këta ujëra do vazhdojnë rrugën dhe pasurojnë basenin e lumit Vardar. Pra, po përsëritet diçka e cila njëherë ndodhi para 60 vitesh me ndërtimin e liqenit të Mavrovës, me çka u ndryshua rrjedhja normale e shumë ujërave të pellgut të Radikës, por më planin më të ri nuk do të bëhet vetëm kapja e ujërave të Radikës por do të bëhet tharja totale e këtij lumi. Pasojat e këtij plani nuk përfundojnë me kaq, pasojat janë pjesë e zinxhirit ekologjik. Kjo do të pasohet me zvogëlimin e dukshëm të sasisë së ujit e cila e furnizon liqenin e Dibrës, njëra rrymë e liqenit (ajo e Radikës) thuajse nuk do të ekzistojë në të ardhmen, ndotjet të cilat na vinë sot prej Ohrit dhe Strugës përmes Drinit të Zi nuk do ta kenë në të ardhmen sasinë e domosdoshme të ujit të Radikës i cili ndihmonte dukshëm në pastrimin e Liqenit. Por pasojat do i vërejmë posaçërisht në verë, kur me siguri niveli i ujit do bjerë në minimum dhe uji i liqenit në pjesën më të madhe verës do jetë i ndotur ndërsa dibranët nuk do të mund të shfrytëzojnë dhe të shijojnë freskinë e liqenit.

Siç do të shihni në dokumentet e bashkangjitura, disa shoqata ekologjike janë duke bërë presion për këtë çështje (edhe pse ata kanë më interesa dhe aspekte tjera) por për ne është i rëndësishëm fati i lumit Radika në të ardhmen.

Në këtë korespondencë janë kopjuar shumë dibranë, pushteti vendor, shoqata të ndryshme etj. Shpresoj të dëgjoj një reagim të përbashkët dhe të fuqishëm në mbrojtje të lumit tonë të Radikës.

Me shpresë se në të ardhmen nuk do shohim lumin e Radikës të tharë.

(Shkrimi i mesipërm është marrë nga forumet sociale në Internet. Titulli është i redaksisë)

opinion

Ne foto: Pamje nga segmenti i papërfunduar i Rrugës së Arbërit që lidh qytetin e ri të Bulqizës me Qafën e Buallit. Ky segment është i hapur për lëvizjen e makinave, megjithëse është akoma i papërfunduar.

Ditët e para të dimrit kanë qënë të ngrohta për vendin dhe udhëtarët dhe drejtuesit e mjeteve janë të kënaqur me shpejtësinë e lëvizjes. Lajme të mira nga ky segment presim të vijnë edhe gjatë ditëve të dimrit, kur bora të mbulojë rrugën. Vitin e kaluar, megjithësë ditët ishin me diell, lajmet nga segmenti i rrugës së Arbërit në vendin e quajtur Pishat e Fushë Bulqizës, vinin për bllokimin e rrugës. Shpresojmë që të njëjtat lajme të mos vijnë edhe nga ky segment rrugor.

Redaksia vazhdimisht ka ngritur nevojën e standardeve të rrugës, duke theksuar funksionalizimin e saj për një rrjet të madh makinash por edhe për gjatë gjithë vitit, pavarësisht nga moti dhe kushtet atmosferike.

Foto: Bujar Karoshi

Rruga e Arbërit, arteria e gjakut të Shqiptarisë!

Nga: **Dionis XHAFA**

Një rrugë 70 kilometra e gjatë…Lidh arteriet kryesore të mbarë trojeve shqiptare, atyre maqedonase dhe shqiptare. Lidh qytetet e Bulqizës, Burrelit, Peshkopisë, Dibrës, Strugës, Kërçovës, Gostivarit, Tetovës, Shkupit e gjer në qytetet e Kosovës: Ferizaj, Kaçanik, Lipjan, Viti, Gjilan, Prishtinë e Mitrovicë. Jo vetëm kaq, por zhvillon edhe portet ndër më të rëndësishme të vendit, që nga Porti i Durrësit, Porti i Shëngjinit, duke e bërë kështu vendin tonë një pikë strategjike për Gadishullin Ballkanik. 1)

Një rrugë që krah për krah me "Rrugën e Kombit" zhvillojnë mbarë veriun dhe një rrugë që i vjen era shqiptarizëm. Aorta, e cila lidh zemrën kuqezi e ndarë nga padrejtësitë historike.

E, megjithatë, ngrihet një pikëpyetje e madhe…Si mundet diçka e tillë? A mund të bëhet realitet njëëndërr shekullore e popullit tonë, ku një rrugë të ketë forcën të thyej çdo kufi e ndasi historike? Po mundet. Përgjigja quhet "Rruga e Arbërit" !

"Rruga e Arbërit" është segmenti, ku nën gërmadhat e kësaj rruge të flet vetë historia dhe konsiderohet ndër rrugët më të vjetra, bashkangjitur me rrugën "Egnatia". Po të gërmosh e hulumtosh nëpër fletë e arkiva historie, kjo rrugë i ka fillesat që në shekullin e parë p.l.K. Romakët e ndërtuan atë për të kryer shkëmbime tregtare me Venedikun, Raguzën etj dhe me vendet e përtej Adriatikut.

Më vonë u përdor nga Dhimitri, "Princi i Madh i Arbërisë" në shekullin e XII-të dhe njohu kulmin e rëndësisë në periudhën më të ndritur të Arbërisë, ku që nga viti 1429 u përdor nga fisi legjendar i Kastriotëve. Rruga e Arbërit lidhte kalatë kryesore të Arbërisë, kalanë e Petralbës, Stelushit, Sfetigradit, Petrelës dhe Krujës. Kjo rrugë u rindërtua dhe funksionoi deri më 1932, kur shënohet ndërtimi i rrugës Krujë – Burrel.2)

Rëndësia primare e kësaj rruge është strategjike për zonat verilindore, pasi lidh Peshkopinë, Dibrën, Matin në një trekëndësh krahinor, gjë e cila do përmirësonte lidhjen infrastrukturore të qarkut Dibër. Tjetër rëndësi ka lidhja mes Shkupit dhe Portit më të madh dhe qytetit të dytë në vend, Durrësin.

Përshkohet me një shpejtësi prej 80 km/orë, kalon itenerarin që nga Tirana-Dajti-Muiza-Gur i Bardhë- Urë e Vashës-Plan i Bardhë-Bulqizë-Urë e Vashës-Plan i Bardhë-Bulqizë-Urë e Çerenecit-Gjoricë-Dibër (e Madhe). Ka filluar tashmë asfaltimi i rrugës nga Bulqiza në Dibër. Duke përshkruar pikat e fshatrave dhe qyteteve që lartpërmendëm, Rruga e Arbërit përfshihat në krahinat e Matit, Dibrës, Elbasanit, Çermenikës, Krujës dhe Mirditës. Nëse do ndërtohet, rruga aktuale shkurtohet me 100 kilometra, përmirëson jetën e 1.5 milionë banorëve përkëtej e përandej kufirit me Maqedoninë. Kjo rrugë përveçse zhvillon zonat malore, ajo shkurton distancën, gjallëron bujqësinë, industrinë dhe përmirëson në tërësi ekonominë e trevave shqiptare të Maqedonisë. Benefitet e kësaj superstrade fillojnë që nga shfrytëzimi maksimal e cilësor të zonave Mat e Bulqizë në veçanti. Tjetër përfitim i vjen turizmit, sidomos atij malor.Mjafton të përmendim vende si: Bistra, Mavrova, Kodra e Diellit në Tetovë etj. Promovohen bukuritë mahnitëse të shtatë liqeneve të Lurës, Liqenit të Dibrës, Strugës, Ohrit, Mavrovës etj. 3)

Të imagjinosh që zonat më të izoluara, komuna më e thellë dhe një zonë punëtore, Kalaja e Dodës, nga 5 orë qëi nevojitet momentalisht një personi për të lëvizur për në Tiranë, do i duheshin vetëm 1 orë e gjysmë. Korabi, mali më i lartë në vend, jo vetëm për këtë fakt, por edhe për bjeshkët e larta e të mahnitshme që mbart, mund të shndërrohet në resort turistik dhe me pista të mrekullueshme skish. 4)

" Një gjysëm mali në derë të Tiranës dhe duket Tirana si dynja tjetër. Ka vlerë Rruga e Arbërit, i rrit vlerën tokës, kafshëve, ujit e jetës dhe nuk e le të shkretohet vendi." – shpjegon një gazetar në një reportazh të tijin.5)

Shtjelluam disa përfitime që rrjedhin nga kjo rrugë, që edhe më qartë i jep vetë inxhinieri i këtij projekti, z.Farruk Kaba. "Via vita est" thonin romakët dhe për Dibrën kjo shprehje është mëse domethënëse dhe kuptim. Kjo do të thotë:

"Me ndërtimin e Rrugës së Arbërit, pasuritë e jashtëzakonshme të trevave të Dibrës andej dhe këtej kufirit do të vihen në lëvizje si kurrë më parë

"Sofja, kryeqendra e Bullgarisë, me rrugën e Arbërit bëhet me afër me Durrësin, pra me Detin Adriatik se sa me Detin e Zi. Në kushtet e një Europe të Bashkuar dhe pa kufij, kjo është shumë domethënësemplotë.

" Parametrat gjeometrike janë të tillë që do të lejojnë një lëvizje me shpejtësi 80 deri 100 kilometra në orë pa probleme, pasi e gjithë rruga do të shoqërohet me një sinjalistikë moderne bashkëkohore.

" Rruga do të ketë dhe një lidhje të veçantë me rrugën nacionale Burrel -Klos - Bulqizë, e cila nga Klosi tek Ura e re e Vashës do të jetë 3 kilometra e gjatë. Në këtë mënyrë edhe Burreli do të lidhet me Tiranën në një distancë prej vetëm 57 kilometra, ndërsa Klosi me vetëm 40 kilometra. Distancat me Tiranën, në rast të ndërtimit të Rrugës së Arbërit, bëhen:

Tiranë – Bulqizë 55 km.
Tiranë – Peshkopi 100 km.
Tiranë – Dibër 83 km.
Tiranë – Gostivar 141 km.
Tiranë – Tetovë 175 km.

Menduat se folëm shumë? Nëse mendoni kështu, e keni gabim. Lidhja më e plotë mbarëshqiptare do bëhej nëse do realizohet autostrada Tetovë-Prizren dhe do t'a quaja "Arterie të të gjakut të shqiptarisë" nëse do ndërtohej edhe rruga e premtuar Dibër-Gostivar. Plotësimi i një vargu të tillë rrugësh, do të thotë "bashkim kombëtar", ku kufijtë shërbejnë për të ndarë shtete, por jo një komb. Mirëpo, ky projekt has dy kundërshtime të mëdha. Së pari: Qeveria maqedonase është e para që premton, por asgjë nuk është realizuar. Gruevski vazhdon politikën "e mbrapshtë" maqedone, ku qytetet shqiptare trajtohen me indiferentizëm nga ata maqedonase, paçka reagimeve të ashpra të kohëve të fundit në çdo aspekt. Deklaratë akoma më kundërshtuese vjen nga Ministri i Transporteve të Maqedonisë, që në lidhje me çështjen në fjalë thotë thjesht: "Nuk kam përgjegjësi! " Edhe më i çuditshëm është fakti që projekti kundërshtohet edhe nga Menduh Thaçi, i cili është deklaruar prerë dhe shkurt: "Projekt i pavlerë". 6

Pavarësisht kundërshtive e problemeve, Rruga e Arbërit ka filluar zbatimin "de jure" që në 2004-trën, miratuar kjo nga Këshilli Kombëtar i Rrugëve. "De facto" është bërë gjysma e një projekti madhor mbarëshqiptar, me vlerë prej 250 milionë eurosh. Unë dua të besoj në fuqinë e kësaj rruge, në një dimension ndryshe të shoqërisë rurale dhe qyteteve të "humbura" në veçanti, në një kapërcim historik, që do mbarte vulën e pulsit të mbarëshqiptarizmi. Dua të besoj që "Rruga e Arbërit" të ngrihet në lavdinë e Arbërisë krenare, por tashmë për një të ardhme. Dua që kjo e ardhme t'a shohë këtë rrugë si "arterien e gjakut të shqiptarisë".

Rruga e Arbërit është kryeura më e madhe e bashkimit të shqiptarëve dhe mënyra moderne që do të mirintegrojë dy gjysmat e kombit. Prej kohësh në BE shkon drejt sfumimit rendësia tradicionale e kufijve tokësorë. Drejt mpakjes po shkojnë edhe "kufijtë" ekonomikë, këtë prirje kanë edhe ata politikë. Ndërkohë prej gjithsecilit shtet përbërës forcohen kufijtë kulturorë dhe ato të identitetit kombëtar. E gjithë kjo tablo e re e strukturës së eurobashkimit ndërsa po "harron" kufijtë tokësorë dhe ekonomikë ka vizatuar mbi trupin e të ardhmen e vet të vitit dymijë rrjetin gjigand infrastrukturor të Korridoreve Transnacionalë. Njëri prej tyre, ai me numërin 8, jo ndër më kryesorët e BE-së, kalon nëpër Shqipëri. Ky shembëll e ky mësim evropian qartëson si drita e dielllit mesazhin se vënia në jetë e kompensimit nga pabesia e kryer në vitin 1913 nuk është lufta apo gara ekufijve, por ajo e rrugëve.

1 Rruga e Arbërit, në ndërtim, Vargamal, Nje Gjak, Nje Vullnet!
2 Historia e rrugëvë automobilistike shqiptare, ShkodraOnAirForum
3 Rruga e Arbërit, një korridor gjithëshqiptar, Ramiz Ficorri, Telegraf
4 Të ngremë resorte turistike për Malin e Korabit, 24.10,2011, gazeta "Sot"
5 Midis dy Dibrave në gjurmë të Rrugës së Arbërit
6 LajmiPress, Menduh Thaçi për Dibër-Gostivar
7 A po agon mbi Rrugen e Arberit? Ballkan, 15 prill 2006, Ylli Polovina

e ditës

Minatorët e vrarë, familjet në mjerim e luftë për mbijetesë

Aksidentet në minierë, 7 minatorë të vdekur në 16 muaj

Nga: **HYSEN LIKDISHA**

Dhënia me koncension e Minierës së Bulqizës në korrik të vitit 2001, për kompanitë e huaja Darfo Albania dhe më pas Deko Metal Austria, në asnjë rast nuk kanë rezultuar efiçente. Kjo për faktin se këto kompani nuk investuan në minierë sipas kontratës së lidhur me qeverinë shqiptare, por vetëm shfrytëzuan rezervat e gatëshme, duke bërë kështu që vit pas viti, incidentet me pasojë vdekjen në galeritë e nëndheshme të Minierës së Bulqizës, të vijnë vetëm duke u shtuar, ndërsa me qindra burra duhet të fitojnë bukën e përditshme të familjes së tyre përmes kushteve mesjetare të punës. Në 60 vitet e ekzistencës së saj në minierën e Kromit në Bulqizë, mendohet të kenë humbur jetën më shumë se 350 minatorë. Nëse i shohim shifrat ftohtë, numri mesatar i vdekjeve në një vit duhet të jetë rreth 6. Por në të vërtetë nuk ka qenë kështu. Vitet e para të punës kanë shënuar numër të madh viktimash, ndërsa vit pas viti, me përmirësimin e teknologjisë dhe rritjen e investimeve nga shteti, numri i aksidenteve ra ndjeshëm. Edhe pas marrjes me koncesion nga kompania italiane "DARFO", miniera nuk ishte një vend i pasigurt për minatorët, deri në tetor të vitit 2006. Në këtë muaj, shkëputja nga tavani i galerisë i një masivi kromi vrau minatorin Besnik Alliu nga Fushë-Bulqiza. Disa muaj më pas, minatorët nisën të ngrinin krye, duke kërkuar paga më të larta dhe përmirësimin e kushteve të sigurisë në punë. Deri në qershor të vitit 2007, ata përmendnin vdekjen e Besnik Alliut për të përligjur kërkesat e tyre. Por në qershor, kur protestat arritën kulmin me nisjen e një greve të përgjithshme, dy minatorë të tjerë, Avni Duriçi dhe Hysen Lezi, dy nga minatorët më me përvojë të kësaj miniere, gjetën vdekjen në thellësitë e nëntokës, nga një shpërthim i pakontrolluar i minave. Një muaj e gjysmë më vonë, më 10 gusht 2007, një shembje në galeri i mori jetën Zaim Hysës, i cili sapo ishte zgjedhur sekretar i sindikatës së re të minierës. Në fund të gushtit, një tjetër shembje vrau minatorin Mehdi Jani, baba i pesë fëmijëve. Pas vdekjes së këtij të fundit, qeveria ndërhyri dhe urdhëroi mbylljen e minierës, deri në plotësimin e kushteve të sigurimit teknik. Investimet nisën të bëheshin, por pikërisht një nga njerëzit që punonte për vendosjen e armaturave mbrojtëse, Sami Doga, gjeti vdekjen i shtypur nga një masiv dheu në muajin dhjetor 2007. Viti 2008 u duk se nisi më i mbarë për minatorët e Bulqizës, të cilët arritën më në fund të nënshkruanin kontratat e punës. Por edhe ky vit nuk kaloi pa viktima. Kështu një aksident i rëndë u shënua në këtë vit ku një tjetër minator, Njazi Alliu, vëllai e viktimës së parë të kësaj serie vdekjesh, Besnik Alliut, gjeti vdekjen

VITI I PËRGJAKSHËM 2007. JA MINATORËT E VRARË: Besnik Alliu, Avni Duriçi, Hysen lezi, Zaim Hysa, Medi Jani, Sami Doga, Hekuran Gjeta (në stoqe), Xhevat Bulqiza (në stoqe)

në galeritë e thella të minierës. Jo pak, por 15 ton mineral kromi shtypin trupin e Njazi Alliut 800 metra thellë nën tokë. Alliu kishte mbi 15 vite që punonte në minierë. Përmasat e kësaj ngjarjeje tragjike, ku humbi jetën 50-vjeçari Njazi Alliu, rriten së tepërmi edhe për faktin se për familjen Alliu kjo është viktima e dytë e rënë në minierë, pasi në vjeshtën e vitit 2006 u vra në të edhe vëllai i tij, Besnik Alliu, që shënoi edhe hapjen e serisë së vdekjeve të tjera që pasuan nga puna në këtë minierë.

Kështu, në rreth 16 muaj ky është aksidenti i shtatë me vdekje në minierën e kromit dhe aksidenti i parë për 2008-tën. Ngjarja e rëndë ka ndodhur në nivelin e 16-të, të pusit numër 2, të kësaj miniere, rreth 800 metra thellë nën tokë, ku Njazi Alliu punonte për nxjerrjen e mineralit të kromit. Shokët e punës thanë se aksidenti ndodhi kur minatori 50-vjeçar po mundohej të zhbllokonte një furnel, në mënyrë që minerali i grumbulluar nga plasjet të mund të rrëzohej poshtë në trimonzhën e shkarkimit, ku mbusheshin vagonët. Por teksa me një levë hekuri lëvizte gurët për të siguruar rënien e lirë të tyre, një bllok i madh minerali ka rrëshqitur duke e marrë përpara minatorin. Ai ka përfunduar 16 metra poshtë, në trimonzhën e shkarkimit, i mbuluar nga rreth 15 tonë mineral. Ndërkohë vdekjet në minierë pasojnë njëra tjetrën madje edhe aksidentet me vdekje nuk mungojnë edhe jasht saj. Kështu një aksident në stoqet e mineralit jasht galerive, ka sjellë vdekjen e 43 vjeçarit, Nevruz Gjoka, nga Bulqiza, dhe u plagos Bardhyl Duriçi, 30 vjeç. Aksidentet tragjike pasojnë njëri tjetrin. Fillimi i vitit 2009 shënon vdekjen e minatorit Behar Toçi, 32 vjeç. Viktima punonte në detyrën e vagonistit, në pusin numër 1 të nivelit 52 të minierës, rreth 166 metra thellë nën tokë, kur nga tavani i galerisë është shkëputur një masiv gurësh që e ka goditur vagonistin 32-vjeçar në pjesën e prapme të kokës dhe në shpatull. Goditja ishte fatale, pasi i ka shkaktuar vdekjen e menjëhershme. Edhe pse është e vështirë të nxjerrësh një statistikë të saktë të këtyre vdekjeve, thuhet se gjatë vitëve 2007 deri në 2009, tragjeditë në minierën e Bulqizës, jo vetëm në galeritë e thella të nëntokës, por edhe në sipërfaqe të saj, ndoqën njëra-tjetrën, ku janë regjistruar 17 jetë njerëzore të humbura, 17 gra të mbetura të veja, 43 fëmijë të mbetur jetimë. Ndërkohë që viti 2010 rezultoi i mbarë për minatorët pasi nuk u regjistruan aksidente me humbje jetësh për minatorët, 2011 e prishi këtë ugur të bardhë. Kjo pasi më 18 tetor të këtij viti, regjistrohet një tjetër aksident i rëndë tragjik në nivelin e 16-të të minierës ku nga shpërthimi i gazit të hidrogjenit humb jetën minatory Naim Shyti dhe plagosen 8 të tjerë 3 prej të cilëve në gjendje të rëndë. Dhe në çdo rast të gjitha këto hubje jetësh të minatorëve janë konsideruar si aksidentale, ku faji për ndodhjen e tyre është groposur së bashku me viktimën.



Në foto: Hysen Lezi me me vajzen Adelina. Foto poshtë:Adelina Lezi, nxënëse në klasën e nëntë, tregon ilaçet e së jëmës

Në disa nga familjet e minatorëve të vrarë në galeri, në ditën e Kurban Bajramit

Në ditën e sotme të Kurban Bajramit, kësaj feste tradicionale që në trevën e Bulqizës, ka rrënjë të thella dhe festohet nga të gjithë shkuam në disa nga familjet e minatorëve që kanë humbur jetën gjatë punës në minierë. Së pari ndalojmë në Fush-Bulqizë, tek familja e të ndjerit Sami Doga, vrarë në dhjetor të 2007. Një shtëpi e vogël fshati që kishte mbetur ashtu siç dhe e kishte lënë Samiu, në ndërtim e sipër. Në shtëpi nuk gjejmë asnjeri, Dera e mbyllur. Edhe komshijtë nuk tregojnë se ku ndodhen, por vetëm të thonë se nuk janë këtu. Ndofta bashkëshortja e të ndjerit, së bashku me fëmijët ka shkuar tek prindërit, në përkujdesje për fëmijët e saj në këtë ditë moti të shenjtë të Kurban Bajramit, që siç thamë në Fush-Bulqizë, festohet nga të gjithë. Spostohemi po në këtë fshat, për vizitë tek dy familje të tjera, ata të vëllezërve të vrarë në minierë, Besnik e Njazi Alliu. Por edhe këtu dështojmë në qëllimin tonë për tu takuar me familiarët. Nga komshijtë mësojmë se dy familjet janë larguar nga fshati. Njëra prej familjeve, ajo e Njazi Alliut është larguar në Itali ku dhe punon djali i madh i kësaj familje. Ndërsa familja tjetër ajo e Besnik Alliut, prej tre vitesh është shpërngulur në qytetin e Bulqizës. Këtu familja ka nisur një jetë të re ku bashkëshortja e Besnikut dhe djali i madh i saj janë sistemuar në punë në minierë. Trokasim në derën e një apartamenti në katin e dytë të një pallati në lagjen Gjeologu, ku banon familja e të ndjerit Hysen Lezi. Derën na e hap një vajzë adoleshente Adelina Lezi, nxënëse në klasën e nëntë. Urdhëroni, thotë ajo. Pasi përshëndetemi, Afërdita, bashkëshortja e të ndjerit, nis e tregon për mbijetesën e familjes pas vrasjes në minierë të bashkëshortit të saj. Ndërkohë që Afërdita nis dhe tregon, djali i vogël dhe i vetëm i saj, Klodiani që vazhdon klasën e tretë fillore, i mbush sytë me lot dhe nuk di përse ai nuk pranon që ta fotografojmë. "Jam shumë e sëmurë, fillon të tregojë Afërdita. Sapo kam ardhur nga spitali. Vuaj nga shumë sëmundje si, diabeti, tensioni i lartë, azotemia, ndërkohë që kam kaluar edhe 5 operime në trup. Bashkëshorti im Hysen Lezi, ka qenë ndër minatorët më të mirë të minierës. Por, përkundër kësaj në si familje trajtohemi me një pension prej 160 mijë lekë të vjetra. Madje dy vitet e para pas vrasjes së bashkëshortit, kam marrë vetëm 45 mijë lekë të vjetër pension. Tani që djali më ka mbushur 8 vjeç, pensionin prej 160 mijë lekësh të vjetër ma kanë përgjysmuar. Vetëm bashkia Bulqizë, më ka ndihmuar ku me jep përkrahje sociale prej 38 mijë lekësh. Pensioni që marr për rritjen e fëmijëve jetimë, nuk më del as për të blerë ilaçet që për çdo muaj duhet të paguaj 130 deri në 140 mijë lekë të vjetër. Shikoni sa ilaçe marr dhe vendos mbi tavolinë disa tableta me ilaçe si dhe aparatin e marrjes së insulinës për të luftuar diabetin si dhe atë të mëtjes së tensionit të gjakut. Që nga vdekja prej 5 vitesh e bashkëshortit tim, Hysenit, në shtëpinë time nuk më ka ardhur askush, as nga shokët e tij, as nga miqt, as nga drejtuesit e minierës, apo strukturave të tjera shtetërore, për të na u gjetur pranë për të na lehtësuar sado pak dhimbjen tonë të mëdhe për hubjen e njeriut tonë të dashur. Por kanë qenë dhe janë vëllezërit e mi ata që më gjinden pranë në çdo moment. –Ja shiko edhe mishin për ditën e madhërueshme të Kurban Bajramit ma kanë sjellë. Çdo gjë ata e ndajnë me mua, thotë Afërdita. Në këtë ditë moti, dyert e shtëpisë së Naim Shytit, vrarë në minierë më 18 tetor të këtij viti, qendrojnë të hapura, ku vijnë njerëz për të ndarë dhimbjen e pikëllimin me familjen Shyti. Nëntoka ishte buka dhe jeta e tij. Naim Shytit, 36 vjeçari ishte burrë i vetëm i shtëpisë që i kishte vënë shpatullat nën trarët e rënuar të galerisë në thellësitë e së cilës gjeti vdekjen. Për afro 10 vjetë nën tunelet e kromit ka siguruar bukën e përditshme. Ndërsa shtëpia e tij, në fshatin Kokordhak më Fushë-Bulqizë, thuajse është e rrënuar. Një shtëpi përdhese ku syri nuk të sheh asnjë oriendi për të qenë jeton familja Shyti. Në shtëpinë e Naimit nuk ka më krahë pune. Djali i tij më i madh, Fatmiri është vetëm 13 vjeç ndërsa familja prej 6 anëtarësh siguronte mbijetesën nga puna e rëndë e Naimit në minierë. E tash që ai mbylli sytë nuk ka lënë pas veç mjerim.

Rruga Arbërit nr. 67

studim

Oena kërkon njohje të mëtejshme, vizitorë, ndërhyrje shtetërore për zbulime nëntokësore

Oena - qyteti i vjetër i Ilirisë

Oena – si shpend I vogël, I bukur , I përshtatshëm bën pjesë ne familjen capensis oena(latinisht). Kështu çidhnakët e zgjodhën oenen si simbol të përhershëm dhe qyteti I tyre mori emrin OENA.

Nga: **Dr. ISLAM CANI**

Çidhna e sotme- para shume kohesh e ka patur emrin Oenea. Nuk mund të bësh hamendje mbi qytetin e vjetër të ilirisë të cilin e percakton qartë simboli i saj Oena.

Oenea- është një zog që ben pjese ne grupin e shpendeve qe banojne ne kete zone si kurse oena, papagalli, gjeli I eger, shqiponja etj.Eshtë perdorur si simbol ne kete zone që nga koha e pellazge, e ne vazhdim te ilireve e deri tek albanet dhe shqiptaret e sotem. Me sa duket ky shpend qe njihet si oena, bashkjetonte në afërsi te vendbanimeve, në zonat e ulta të shkurreve, te dushkut, por dhe ne vendet e banuara prane kasolleve e shtepive të vogla. Njihej si shpend komunikues, lajmetar me zërin e tij dy kohësh dhe njeri i shkurtër dhe i fortë dhe tjetri me i forte dhe i zgjatur, një shpend vigjilent si natën dhe ditën, por afërsia dhe kuminikimi i saj, ka imponuar banoreve te qytetit te ishte simbol dhe idhull për ta. Fluturimi i saj eshte i shpejte, ka tendence për të fluturuar ulet. Ndërton fole dhe qendrojne ne shkurre, dushqe e busha. Femra, vezet i bënë të bardha, dhe inkubohen normalisht ne mënyrë tipike si pëllumbat.

Nga pikpamja e qëndrimit në pozicion vrojtimi, si dhe të kujdesjes i ngjante shumë shqiponjës. Veshja e saj me pupla të zeza në të kafe të lehtë , rreth qafës gri me sqepin e verdhë në portokalli, këmbët e zeza ne gri për meshkujt , ndersa për femrat , puplat më të çelura dhe pjesa e gushës me e bardhe, po ashtu dhe ne flete dhe ne bishtin e saj bardhe e zi. Rritej dhe ushqehej me hedhurinat e familjeve apo me farërat e të mbjellave.

Pellazgët dhe ilirët e kësaj zone që në prehistori, jo më kot e kishin oenën simbol, idhull, perëndi, sepse: qëndronte vigjilent, ne çdo kohe e sinjalizues per çdo lëvizje, në hyrje e dalje të qytetit. Lajmëtar i saktë kur i kanosej dicka e keqe, ai shërbente si sinjalizuese per cdo levizje për banoret e ketyre zonave . Prandaj dhe ishte lajmetar, , idhull e simbol.

Këto shpendë të rrallë i gjen edhe sot në këto zona kudo dhe kur do i dallon lehtë, nga bukuria dhe nga zeri i tyre i vecante. Paraardhësit e shqiptareve të sotëm këta simbole kuptimplote si oenen e qendisnin si symbol per vete dhe dhurate per familjeve të mëdha mbretërore sipas gojedhenave dhe studjuseve ishte e gdhendur e qëndisur mire per mbretin Gent te ilirise.

Mesa duket të parët tanë besonin BESTYNITE PAGANE dhe festonin si të veçantë Ditën e Verës, ku si emblemë kishin shpendin paqësor, jo grabitqar, por informues, sinjalizues, me zë dhe njoftime të tjera siç tregojnë historitë dhe tregimet e të parëve tanë të hershëm ;

O Oenëë pëllumb i shkruar
bashkë me ne t'i ke jetuar
Na ke mbrojtur dhe na ke treguar
për armiqtë që janë afruar
Zëri yt shume herë na ka zgjuar
O oene te falemi Ty
çoje lajmin që të kemi dhënë
shtepi me shtëpi
per te mbrojtur trojet cdo njeri
ruaje amanetin siç din Ti
nën sqep e të lidhur fort në këmbë
Lajmi yne kodo te shkojë
se ty të kemi simbol e mburojë (*baladë e vjetër)*

Oenea- ishte qyteti më i mbrojturi nga pozicioni gjeografik në Dibër. Qyteti ndodhej në mes të maleve ku shtriheshin fusha e shumë burime ujore si: Seta, Klloxhnesha, Shehu i Thatë, Zgjorxha, Saponika, Gjilgjori, Resna, Vokseta, kroi I madh, gjura gjygj, Sheu që kryqëzohej në Kronzë brënda në Çidhën kishte burime te shumta. Te tilla edhe sot ruajnë emrin e tyre dhe ne shumicën e burimeve gjen copa tjegulla, që janë përdorur si lugje për të ruajtur vazhdimësine e këtyre gurrave.

Parimi i fiseve ilire që në kohe të ndryshme historike, per qytetet ishte: se ku ka kala kishte qytet, por dhe zhvillim, urbanizim, bujqësi, karakteristike e kesaj Ashtu sikurse rasti yne origjinal per qytetin e lashte Oenen.

Romakët kur erdhën për herë të parë si nënshtrues e skllavërues (shume kohe para krishtit) u mahniten me pamjen dhe bukurine e qytetit. Kjo ishte dhe arsyeja që çidhna ishte e pamposhtur. Romakët që në fillim ato e njohën çidhnën qytet (citta= qytet) në italisht dhe në emertimin latin qytet = citta.

Me shumë fortesa e kala të cilat u sulmuan dhe nështruan, por ajo që ju kishte mbetur në grykë si halë ishte dhe çidhna, Per të hyrë këtu i duheshin të kalonte disa prita: sikurse tregojnë gojedhenat dhe faktet historike ; ku tre betejat u thyen në Shashar, te Kepi i Qytetit si pika e vrojtimit të qytetit,me pikat e vrojtimit të Harlecit, në maja e Sukës ku ka qene pika e vrojtimit dhe nje kishë. Ashtu dhe pika të tjera përforcuese .

Të gjitha betejat u sprapsën dhe u shuan në grykën e Tërdofit, të Sheut, përballë fushës se Mac – Dhovës.

Kesaj i shërben kënga:
U mbush Seta plot me gjak
Sheu e Tërdofi po merr flakë
Ndeshen trimat shpat më shpatë
Çpo thotë boni e murthaku
lufton trimi Gjon Plaku
Gjoni thotë mos më ndihmoni
se te Tërdofi unë do pushojë

Gjoni – është varrosur në vendin që u vra, pra është dëshmitari dhe heroi i tre pritave me emrin e tre pritave pra tërdof- tre beteja shuan, u zbrapsën e larguan para se sa të merrnin macdhovën. Prita e mac- dhovës ishte me muri të larta disa metra, me frëngji, pra si dritare per të gjuajtur me armë e shigjeta të asaj kohe.

Pra qyteti i Çidhnës ku janë gjetur thesare, ku kanë mbetur me dhjeta të tillë në tokë, për këtë 1862 ku Ismail Lleshi i shkolluar në perandorinë osmane për Gjeologji e Arkeologji- atëhere erdhi dhe ngriti 7 qendra për të gjetur varre dhe thesarë në çidhnes, si dhe nje kult fetar, si personalitet I shquar, informues e bindes, në të gjithë krahinën për kohën ishte njeriu më I dëgjuar ,por jo gjithmonë gjete verpimytarise se tij njeriu mund te dalë fitim tare, ashtu si e quajti populli sheh Ismali I shkoi prapa dhe bëri disa gërmime arkeologjike si:

1. Shëmëtarth
2. Tek Kepi i Qytetit
3. Fushë Bon
4. Në Fushën e Tërdofit
5. Në Volëz
6. Në Linajsht
7. Në mac- dhove
8. Në Lujth
9. Në Kodrën e Gjok Bitrit
10. Në Vakuf tek mani I Gjokës.

Fatkeqësisht 200 metra më larg nga vendi i ku kerkonte ne Pusa tek mani i Gjokës rreth vitit 1977 u gjet thesari nje qyp me para të mbështjela me tjegull dhe nje cipë e hollë bronxi. Parate ishin të kohës Bizante (serma), sipas studiuseve arkeolog. Koha e Sheh Ismalit, njerëzit që e kishin mbështetur në kërkime filluan ju larguan kur ai ne atë kohë nuk gjeti gjë, dhe përhapën fjalën se Shehi më shumë është ëndërrimtar se sa realitet, sepse gjetja e copave me tjegulla, qymyr, ne Shumëtarth, Vilëz, Kodra e Gjokës(Bitrit), Varret e Cullve, në fund të fushës sale me emertimin e mëparshëm mac Dhovës, nuk jua mbushte mendjen ne atë kohë. Megjithëse ato vlerat e Shehu i dinin si psh; perkthim i gjuhës osmane, ndihmonte të varfërit që të ktheheshin nga turqia që rrinin 12 vjet në ushtrinë turke, sepse ai atje kishte nipërit dhe djalin e vet, bënte çmundej që me gjithe djain , nipër e djem të dibrës e të çidhnës i ktheu ne atdhe.

Shehu- ka marrë pjesë në Kongresin e Manastirit dhe në disa të tjera si përkthyes e diskutues për trojet tona që të kohës pellazgo – ilire. Mesa dime ne ai ka folur edhe për Nente Malet e Dibrës. Ai jetoi deri rreth viteve 1922-1924.

Folëm vetëm për kohën e ilrëve, pushtimeve por nuk kemi trajtuar mesjeten dhe kishat, por jemi tek besimi, tek shpendët, që në çidhën ka 11 shpella për shpendë të ndryshëm si : Shqiponja, oena, gjelat e egër, papagallët, jemi tek koha e besimit pagan dhe ndërtimi fetar – kishtar është peridha e bizantëve , turqëve që do tju referohemi më vonë.

Sot me shume folem per emrin e Oenese , Ne te ardhmen do te flasim per shume emra e luftetare te kohes ilire e me vone si dhe shume vende te tjera banimesh me toponime e gojedhena:.

** Ruajmë të drejtat e autorit dhe rezerva informative. Oena (Çidhna)- eshte qyteti me i vjeter dhe me i mbrojturi ne zonen e Dibres, jo me larg se 1.5-2 km larg Drinit te Zi.*

Ka ndodhur nje ngjarje? Keni ndonje shqetesim per te ndare me komunitetin?
Keni ndonje propozim per zhvillimin e zones suaj?
Doni te informoni komunitetin rreth jush per dicka qe ju intereson atyre?
SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!
< rrugaearberit@gmail.com >

vendlindja

Fshati Brezhdan është pjesë përbërëse e fshatrave të rrethit Dibër, dhe bën pjesë në ato fshatra që shtrihen në luginën e Drinit të Zi. Ai ndodhet 3 km në perëndim të qytetit të Peshkopisë.

Brezhdani, fshat i urbanizuar qysh në mesjetë

Nga: **FATMIR XHARRI**

Fshati Brezhdan është pjesë për bërëse e fshatrave të rrethit Dibër, dhe bën pjesë në ato fshatra që shtrihen në luginën e Drinit të Zi. Ai ndodhet 3 km në perëndim të qytetit të Peshkopisë. Sipërfaqia e tij e përgjithëshme është 765 ha, nga të cilat 451 ha tokë arë, ndërsa pjesa tjetër prei 314 ha kullotë. Ai shtrihet në kordinatat 41º 40′ 26" në veri dhe 20º 22′ 56" në lindje dhe ka një pozicion gjeografik shumë të favorshëm, me toka të rrafshëta nën ujë dhe mjaft piellore, sidomos ato që kufizohën më Drinin e Zi.

Fshati shtrihet në një lartësi mesatare që varion nga 300-600 m mbi nivelin e detit.

Kufijtë natyror dhe administrativ të Brezhdanit fillojnë; në lindje me tokat e fshatit Rashnapoië(Rushna-Polie). Kufiri vazhdon në drejtim të Jugut duke përfshirë Kallçishtin (kallçishta-lagje e Brezhdanit), vazhdon më poshtë në kufi me fshatin Ushtelenxë, me të cilin ndahet në të ashtëquajturën "Kodra e Ruçë"(Kodra e Uruçit F.Xh), zbret në krah të tokave të fisit Menga duke vazhduar në drejtim të Kashaneve, ku del dhe kufizohet me fundin e "Rrugës së Dukë", e deri në Drin të Zi. Drini i Zi është edhe kufiri konvecional, qe ndan tokat e fshatit Brezhdan me malin Mollë (Mallë) në pjesën perëndimore. Në anën tjetër të Drinit gjenden fshatrat Luzni dhe Muhurr. Nga fshati Muhurr tokat e Brezhdanit ndahen me anë të urës mbi Drin, e cila lidh Muhurrin me kodrën Gjarrica.

Në vijim, kufiri vazhdon përgjatë rrugës së sotme automobilistike, përgjatë thembrës së kodrës Gjarrica, në kufi me fshatrat Rreth-Kalë(Rreth-Kala) dhe Vakuf dhe gjithmonë duke ndjekur rrugën e sotme automobilistike del në Kubën (Kobilani i dikurshëm), duke u zgjatur deri në kufi me rrjedhën e Përroit të Gjelagjoshtit, dhe vazhdon përgjatë rrugës nacionale, që lidh Suhodollin me qytetin e Peshkopisë, deri në kufi me tokat e fshatit Pilafe dhe Rashnapoië. Pra, në mënyrë të përmbledhur, Brezhdani kufizohet, në Lindje me Rashnapoliën, në Jug më Ushtelenxën, në Perëndim me Drinin e Zi, dhe në Veri me fshatrat Rreth-Kala dhe Vakuf.

POZITA GJEOGRAFIKE DHE RELIEVI

Relievi i fshatit Brezhdan mund të kategorizohet në dy llojësh, fushor dhe kodrinor. Vetë fshati shtrihet në një reliev, të përthyer duke u zgjatur sa në shpate kodrinash të vogla, aq edhe në rrafsha dhe lugëza, që ata formojnë. Relievi fillon të zbresë ngadalë dhe butshëm në dreitim të Drinit të Zi në formë brezaresh e rrafshesh të sheshta, ku formon edhe një fushë me taban të gjerë dhe pjellore.

Fshati zë një pozicion të favorshëm dhe duke u shtrirë më shumë në luginë është i mbrojtur nga erërat. Ka një ekspozion në drejtim të Jugut dhe Jug-Perëndimit duke përfituar pothuajse gjithë ditën rrezet e diellit. Kryesisht shtëpitë janë të dendura në rrafsha dhe lugina me një dhe dykatëshe, ndërsa vijnë duke u rralluar drejt faqeve të shpateve të vogla.

Hapësira tokësore, që shtrihet në pjesën perëndimore mes fshatit dhe Drinit të Zi është pothuaise e rrafshët dhe përbëhet nga një formacion gjeologjik shumë i përshtatshëm për kultura bujqësore; tokë e formuar dhe me ujë. Pjesën tjetër e përbën kodra Gjarrica, e cila ngrihet mbi fushat e Çapit, duke dominuar mahnitshëm të gjithë luginën e Drinit të Zi, të Dibrës së Poshtëme, maja e së cilës është rreth 500m mbi nivelin e detit.

Ajo ka një pozicion gjeografik të mbrekullueshëm dhe e përshtatëshme për frutikulturë dhe turizëm. Nga maja e saj mund të soditësh një panoramë të mrekullueshme të të gjithë luginës. Gjarrica mund të quhet edhe "Kërthiza e Dibrës së Poshtmë". Ajo është e përshtatëshme për kultivimin e frutorëve, si arra, gështenja, hardhi etj.

Kryesisht shpatet kanë drejtimin lindje-perëndim, të cilat formojnë luginëza dhe rrafsha të vogla, të ngrohta dhe të mbrojtura nga erërat, ndërsa shtëpitë janë të orientuara kryesisht drejt Jugut dhe Veriut, sipas rastit. Dallojmë rrafsha, apo të quajtur ndryshe edhe gropa, si; Gropa e Brezhdanit, e cila është e rrafshët dhe shumë pak metra mbi nivelin e Drinit të Zi dhe Zalli i Zdojanit, që gjindet në përroin e Zdojanit, zgjatimi i të cilit të nxjerr në një fushë të gjerë, e quajtur ndryshe edhe Zalli i Zdojanit, që shkon deri në kufi me Vakufin. Nga Gropa e Brezhdanit, apo qendra e dikurshme e fshatit, relievi fillon nga aty që quhet Lugjet e Xharre dhe vjen duke u zgjeruar në një formë hinke në një fushë e gjerë dhe e rrafshët deri në kufi me Drinin e Zi, tokë e butë dhe shumë prodhuese. Kapaciteti i brendshëm ujor i Brezhdanit nuk është i mjaftueshëm për të përballuar sasinë e madhe të tokës, megjithë krojet e shumta që ka. Krojet kryesisht janë prona fisesh. Kohët e fundit një sistem ujitës dhe uji të pijshëm është instaluar. Janë të përmëndur emërtesa krojesh si; Kroi i Sharrës, Kroi i Xharre, Kroi i Kashanë, Kroi i Barbegje, Kroi i Reçe, Kroi i Kallçishtit, Kroi i Dikallarë etj. të cilët furnizojnë me ujë banorët dhe kënaqin një pjesë të vogël të kërkesave për vaditje. Drini i Zi, i cili u kalon tokave të Brezhdanit fare pranë nuk ka mundur të shfrytëzohet nga banorët për vaditjen e tokave të tyre. Gjatë verës edhe Përroi i Zdojanit ka prurie të pamiaftueshme për të patur një ujitje të kënaqëshme të tokave. Lagjet e tjera si Kallçishti, Ashike etj. mbetën me shpresa të ujit të malit. Thatësira në këto lagje është një problem shqetësues për banorët e tyre.

KLIMA

Klima e Brezhdanit është tipike ajo e Luginës së Drinit të Zi, mesdhetare malore. Në këtë zonë vera është e nxehtë ndërsa dimri herë-herë i butë e herë-herë i ashpër. Klima e butë dhe relievi kryesisht i rrafshët, e rrethuar me male dhe e mbrojtur nga vërshimi i erërave të ftohta ka favorizuar zhvillimin e një bimësie të shumëlloishme. Në verë Brezhdani pothuaise zhduket i gjithi nga pemët, kryesisht plepa të butë. Shtëpitë e tij dy apo tre katëshe humbasin sikur të ishin shtëpi kukullash përpara lartësive të plepave të butë, që çuditërisht zhvillohen aq shpejt, sikur t'i rritësh me dorë. Brezhdani mund të quhet ndryshe edhe "fshati i plepave të butë". Bimësia është e larmishme dhe shumë e zhvilluar. Tokat e tij kryesisht të kafëta dhe të zeza, kanë stimuluar një florë të mbrekullueshme. Tokat e kafëta kryesisht gjenden në pjesën kufitare me fshatin si dhe përgjatë shtrirjes së tij dhe në faqet e kodrinave ndërsa tokat e zeza, të përbëra kryesisht nga dhe i shkrifët i tipit humus dhe baltë lumore gjenden përgjatë lumit Drin. Pjesët më të përshtatëshme për banim janë pjesët luginore të mbrojtura nga erërat që vijnë nga veriu dhe shpatet që i ekspozohen diellit, megjithëse infrastruktura në këto pjesë lë shumë për të dëshiruar.

Kultivohen kulturat e drithit, si misri, gruri, patatja si dhe kulturat blegtorale si jonxha, kolsi, thekri i hershëm, etj. ndërsa pjesa kodrinore është ë përshtatëshme për kultivimin e frutorëve, si molla, arra, gështenja, hardhia, kumbulla, qershia etj. Fusha e Brezhdanit e quajtur ndryshe "Çapi" është pjesa më pjellore e Dibrës dhe nga më pjellorët dhe më të gjera në të gjithë luginën e Drinit të Zi.

Brezhdanasit thonë: "Në Çap, verës, piqet buka në diell". Aktualisht vendasit kultivojnë kryesisht drithërat, si misrin dhe grurin apo foragjere dhe mbarështrojnë blegtorinë, kryesisht lopën.

POPULLSIA

Në vitin 1990 Brezhdani numëronte rreth 1000 shtëpi, me rreth 5500 frymë. Aktualisht shumë familie janë larguar dhe janë vendosur kryesisht në zonat e Shqipërisë së Mesme dhe bregdet, si Tiranë, Durrës, Lezhë, Lushnjë etj. Përsa i përket shtririjs dhe pozicionit që fiset zënë, Brezhdani mund të konceptohet në formën e një luginëze, që krijojnë shpatet. Qendra e fshatit Brezhdan quhet "Mecit", nënkupto "mesxhid", nga arabishtia (Mescid), kuptimi i së cilit është; "vend i shenjtë"' "vend ku falesh", ku herët ndodhej një kishë dhe më vonë ajo u rrrënua dhe u transferua në një lloj xhamie, apo vend falje. Edhe sot gjinden rrënojat e asaj kishe aty dhe thonë se është një vend tejet i shenjtë, ku nuk duhet as ta punosh dhe as të përdorësh për ndonjë gjë tjetër, përveçse kishë. Këtu, pra është kryqëzimi i një numri të madh rrugësh. Në të kryqëzohen 9 rrugë lokale, të keqmbajtura, dhe me baltë dhe që lidhin lagjet e fshatit njëra me tjetrën. Ai është i formuar nga një shesh i rrafshët në formë rrethi me një sipërfaqe rreth 5 dynym (5000) m², por që aktualisht është ngushtuar skajshëm nga tendencat e zaptimeve.

E gjithë mikrozona përreth ka gjurmë varresh të vjetra. Varret e vjetra të Krishtera fillonin nga vetë kisha e vjetër në qendër dhe shtriheshin në kodër që shkonte deri në rrugën ku sot është ndërtuar një xhami e re. Vetë xhamia aktuale është në varreza të krishtera. Në fakt Brezhdani njihej si fshati me 5 kisha. Kjo në kohën kur popullata ishte e besimit të krishterë, në kohën Arbërore. Këto pesë kisha ishin; Kisha në Zdojan (tek Reçët dhe Dikallarët në përrua të Zdojanit), Kisha (ku sot gjindet një rrafsh bosh pranë shtëpisë së Eqerem Hakores), buzë rrugës krysore, Kisha e Kallçishtit, Kisha e Kolës dhe Kisha në qendër të fshatit, pra në atë që sot quhet Mecit, në krye të vendit që sot quhët "Lugjet e Xharrë".

Rrugët që lidh qendra e fshatit janë:

1. Rruga e Madhe: Mecit-Xharrë-Buncë-Medë-Varret ë Kacane- Kashane-Ushtelënzë e që del deri në Luzni.
2. Rruga: Meçit-Xharre-Sharrë-Hidre-Domazete-Menge.
3. Rruga: Meçit-Xharre-Gazidede (teqia)-Kodra e Ruçe-Ushtelenzë.
4. Rruga: Meçit-Xharre-Gazidede-Karahasane-Putok.
5. Rruga: Meçit-Lleshe-Gazidede-Karahasane-Putok.
6. Rruga: Meçit-Kroi i Barbegje-Karahasane-Putok.
7. Rruga: Meçit-Hakore-Selishte-Zdojan
8. Rruga: Meçit-Hakore Mëhallë e Poshtme (Gjece, Vojke, Truke Degjone, Prifte, Skure, Tonuze, Seifullahë) që shkon deri në Vakuf.
9. Rruga: Meçit-Lugjet e Xharre - Stallat e Vjetra - Çuku i Xharre-Gjaricë.

Roli i kësaj qendre si kryqëzim dhe si element i rëndësishëm komunikimi është i pazëvëndësueshëm, pavarësisht se banorët e kanë neglizhuar sistemimin dhe mirëmbaitjen e saj. Ajo është ujëmbledhësja e të gjithë krojeve të fshatit dhe nga e cila bëhet më pas shpërndaria në dreitime të ndryshme. Rreth kësaj qendre në distanca të ndryshme dhe duke iu ngjitur shpateve të buta është përqëndruar pjesa më e madhe e popullësisë. Fare pranë banojnë Xharret, Sharra, Bunçet, Barbegjet, Karahasanet, Hakoret, Gazidedet, Hidret dhe më larg në skajet e shpateve nga njëra anë janë Menget e Domazetet nga ana tjetër janë Tuket, Voiket, Gjecet, Degjonet, Skura etj. Pjesa perëndimore në dreitim të fushës, përshkohet nga tre rrugë kryesore, të cilat i shërbejnë komunitetit për të shfrytëzuar fushat e tyre.. Të tilla janë "Rruga e Bunçe" e cila fillon në kryqëzimin që formojnë rrugët te Varret e Kacane, vazhdon mespërmes fisi Bunçi, e Meda del në Vnesh të Këqia, ku takohet me Udhën e Madhe dhe Rrugën e Dukës. Më pas Udha e Madhe shkon deri në Dri të Zi. Udha e Madhe, siç u përshkrua edhe më sipër fillon në Meçit, vazhdon mespërmes asaj që quhet Xharret e Epëra, vazhdon përsëri mes Xharrëve të Poshtëm, në kufi me Arat e Isak Buncit dhe del në Vnesh të Këqia ku bashkohet me Rrugën e Bunçe.

(Vijon në faqen 20)

Rruga Arbërit nr. 67

studim

Foto: B.Karoshi

Mrekullitë e mollës

Dr. SELMAN MEZIU

Natyra forca krijuese dhe trans formuese e njeriut, personazhi më i dashuruar pas sajë, me aktivi në veprimet e ruajtjes e pasurimit të sajë, por edhe në drejtimin vektorial të kundërt. Molla dru i zakonshëm edhe kjo bijë e natyrës me të gjitha karakteristikat botanike të përshkruara nga Karl Lineu, e pranishme në studimet evolucioniste Darviniane, shumohet me shartim e menyra të tjera sipas natyralistit rus Minçurinit. Frymëzoi poetë, shkrimtare, dramaturge e rapsode popullor, pse jo shkencëtar të fushave të ndryshme në çdo njollë natyrale të rruzullit të dheut e hyri me dinjitet në shumë legjenda mitike.

LEGJENDA E KAFSHIMIT TË MOLLES

Dhjata e Re dhe e Vjetër, përbëjnë thesarin e parë të dijenisë njerëzore. Më parë shkruar në greqishten e vjetër e më pas përkthyer në latinisht e kështu në vazhdim në qindra gjuhë të botës, mëkoi brezni të shumtë njerëzish, me besimin te zoti dhe me njohuritë e para në fushën e mitologjisë, historisë, gjeografisë, astronomisë, mjeksisë etj. Dhe ja po shkëputim prej sajë ligjeratën e mëposhtëme:

"Zoti i dha urdher njeriut: Ti mund të hash të gjitha frutat e drurëve të lulishtes Eden, por jo të atijë të njohjes të së mirës e të keqes, sepse sapo juve ta hani, do të vdisni. Gjarpëri ishte kafsha më e djallëzuara nga të gjitha kafshët e egra të krijuara nga Zoti. Pas shumë përpjekjesh ai e bindi gruan Eva. Atëhere ajo i shikonte me shumë deshirë frutat e kësaj peme, e ato ishin shumë të mira për tu ngrënë, e kjo e këputi dhe e kafshoi(mollën), duke ia dhëne edhe Adamit…..,,(6)

Pra ishte ky frut që njeriu i parë e shijoji dhe i nxiti guximin për të marrë inisiativa të reja në kalërimin e qindra shekujve në trasformimin e mjedisit rrethues e të vetëvetes.

PËRSE BIE MOLLA?

Për një shpikje apo për të shkruar një poezi apo tregim pse jo një këngë popullore, në truallin e realitetit lindin shkendiat e para të nxitjes së frymezimit, e më pas nis formimi i një krijesë të re, që të emocionon, të shton besueshmërinë në të ardhmen, tërheqëse e shërbyese për dhjetra brezni njerëzish.

"Një djalosh kamëron mendushëm ne fushat e Wolstborp (Angli), duke shtrirë hapin sa të ishte e mundshme, atë nuk e tërhiqnin vëmendjen shtëpitë të mbuluar me kashtë thekri, e aspak dhitë që hanin gjethet e bimëve qetësisht, po kështu edhe fshatarët të përkulur nga lodhja e përditshme. Mendueshëm, shtrihet nën hijen e një druri molle dhe shikonte kokrrat e sajë që vareshin në drejtim poshtë. Ndërmjet fletëve, frutave e bisqeve të drunjëzuara hyiri drita e fantazisë si e ardhur nga Hëna. "Përse mollët janë të drejtuara me majën në drejtim të tokës? Përse Hëna rrin atje lart e lëviz gjithmonë pranë tokës? Të gjitha këto trupa që shihen në qiell e këto që janë në tokë si lëvizin e ndryshojnë? Këto janë disa nga pyetjet që djaloshi i ri Isak Niuton (1642-1726) i cili më pas zbuloi ligjin e rënies së lirë të trupave pra forcën e gravitetit, kjo lidhet me ketë ditë të vitit 1666, duke pushuar nën kopshtin me mollë pranë shtëpisë ku ai lindi.,,(7)

Rastësia për shkencën është shkëndia që ndriçon rrugën për zbulime të mëdha që i japin shtytje të mëdha zhvillimeve ekonomike e teknologjike në dobi të jetës së popujve.

GJENIU I MOLLËS

Bota mbarë humbi gjeniun e katërqind shpikjeve. " E gjithë bota, ngado që të hedhësh sytë duken gjurmët e thella transformuese, firmosur nga *Xhobs* të gjeniut që krijoi kompiuterin, duke përfshirë funksionimet nga telefoni tek muzika, nga kinematografia tek leximi i materialeve të ndryshme. Inteligjenca teknike e vendosmëria më fanatikja krijoi aparatura me pamje tërheqëse e plotë shije për të gjitha shpikjet, të gjitha për përdorim të përditshëm, që njërëzit tashmë jo vetëm i përkdhelin por edhe i duan shumë,,(9) E gjithë kjo veprimtari e fuqishme ku marrin pjesë në të gjithë botën 175 mijë punonjës, lidhet pasgjithshmërisht me… *"Kam ngranë mollë në komunën e Oregonit, (Kaliforni - Sh.B.A. S.M.) me bashkëmoshatarët e mijë, i tërhequr shumë nga ky frutë, dhe nga deklerata shumë e ngrohtë për Bitëllsëve, një tjetër shtytje thelbësore ishte, simboli i mollës së kafshuar, e paraqitur në një skicë vizatimi e bërë për Stivin,të cilat u rrënjosën në trurin e tijë. Më një Prill njëmijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë Xhobs e Stevën Wozniak formuan Apple(Molla) Kompiuter pasi kishin krijuar në garazhin e shtëpisë të Wozniak. Janë të gjitha krakteristikat qe në vitin 2000 i dhanë Apple (Emri i ndërmarrjes) një sukses planetaresk: një prodhim të një ide të re, i thjeshtë për tu përdoror, shumë i bukur në pamje, e një strategjia për të komunikuar mjaft të thjeshtë e modern. Lindi një kult ishte kulti i Mollës.,,(9)*

Marshimi i Mollës me udhëheqës *Steven Xhobs* ishte triumfal, në rrjedhjen turfulluese të dekadave, dhe ja: e fillon me 20 dollar në vitin 1980, ndërsa tani ajo ka 800 aksione me një vlere astronomike prej 705 miliard dollar, duke sfiduar industrialist e mëdhenj Amerikanë dhe ato të mbarë botës.

MËMËDHEU I MOLLËS

Gjuha Dibranë ka ruajtur me "konsevatorizëm,, mjaft fjalë të lashta, të cilat kamëruan që nga pellazgëgjishtia e dymijëvjetëve para krishtit, Dardha dhe Molla hynë denjësisht në këtë arkiv ose muze të historisë së fjalë formimit të gjuhës shqipe. Kjo sigurisht, pasqyrohet edhe në llojshmërinë e sajë, në varietetet e formuara nga kopshtar, biolog e gjenetikan, të ndryshëm e të përhapura në hapsira të gjëra gjeografike të trojeve Dibrane. Kur e si filloi të zhvillohet pemtaria intensive?

"Fronti i dytë: Ishte nisja apo eksperimentimi i ngritjes së plantacioneve të pemtarisë në Zdojan. Por duhej mendja e Rexhep Dodës dhe dora e specialistit, e të ndierit Xhavit Hysa, për të bërë realitet atë mrekulli , duke realizuar aty, bllokun e parë, e cila është një kryevepër e bujqësisë në Dibër. Kjo eksperiencë u shtri nga Maqellara deri në Shumbat.,,(11)

Ishte viti 1961. Me gurgullimën e kohës peisazhi mahnitës i pranverës me lulesat ngjyrëshumta të luleve, me vjeshtën me plotë fruta që shkëlqenin nga xixellima sheqerore të frutave, mollë etj, nën rrezet e hënës të sapo lindur apo në perëndimin e kuqeluar të diellit, zbukuronin terrenin kodrinor të Topalltajës. Pasmarin e valëzuar me shpate e lugina, me Gurin e Vashës hijerëndë të rrethuar nga nëntëdhjetë mijë drufrutorë që lulëzonin bujshëm në pranverë. Në Gjarecën e arrës e të gështenjës me mollat e lugjut të Lleshe, numëronte njëqindë e tridhjetë mijë rrënjë drurë frutorësh. Kodrat e valezimet e terrenve të Ostushit, lëshonin rrezatime bukurie vjeshtore një numer i madh dru frutorësh të cilat kapnin shifrat njëqindë e pesedhjete e tetë mije. Shumbati, brinja brinja e kodra të amëla rriste me bujari, fruta të cilësishme e rendimente të larta, njëqindë e pesëdhjete e tetë mijë të tilla. Kastriotin dhe Sinën i kishte bashkuar si në shekullin e pesëmbëdhjetë Gjoni e i biri Gjergji i Madh në këto dhjetëvjeçarë i lidhte qylimi bukurindjellës, shumëngjyrësh i pemëve frutore, të punuar me mjeshtëri nga bujqërit i këtyre anëve, përkatësisht me gjashtedhjetë mije dhe nentëdhjetë mijë rrënjë dru frutore. Inventari i vitit 1990 shenon njëmilion pemë frutore, një rekord i padëgjuar e shkruar për Dibrën e Poshtëme.

Të ardhurat nga shitja e tyre brënda e jashtë vendit siguronin rreth pesëmbëdhjetë miliardë lekë të ardhurash vjetore.

KU NDODHEN TASHMË?

"Si relike të një kohe jo të largët ka mbetur ndonjë rrënjë pemë, molle, kumbulle, dardhe, e ndonje gështenjë që ka nxjerrë filliza nga trungu i sakatuar i sopatave të pamëshirshme, djegjet e braktisja e pashpirtëshme. Populli u frymëzua pas viteve nëmtëdhjetë me sllloganin partiak : Ti zhdukim se janë produkt i komunizmit. Dhe ja ky ishte rezultati.,,

Çfarë i ndodhi gjeniut të shekullit të njëzetë e njëzetë e një? Më 13 Shtator 1985 nxehet, shanë e bërtet me administratorin e "Mollës,, Skullein dhe ai e pushon nga puna. Nuk vonoi dhe *Stevën Xhobs* merr kurajon duke krijar ndërmarrjen Next dhe shpikja e vënë në prodhim, aparatin PC e cila i kushton 6500 dollar, dhe me këtë ai rajvizon synyme të reja. Pas njëmbëdhjet vjetësh ai rikthehet në ndërmarrjemn "Molla,,. Udhëtimi i tijë si krijues gjenial, autori i shumë shpikjeve e suksesve gjigande vdese më pese Tetor të këtijë viti, me tetë miliard dollar në llogari të tijë dhe i siguron Apllit suksese e veprimtari të sigurtë ekonomike edhe për katër vjetë në vazhdim punë. Ishte merita e tijë që Presidenti Barak Obama do të shprehet pas humbjes së tijë. *"Bota mbarë ka humbur shpikësin e realizuesin më të madh.,, (8)*

MOLLA NË KENGËT POPULLORE DHE…..

Gjeniu popull ka nxjerrë nga thellësitë e shpirtit të tijë poetik vargje mjaft emocionuese për këte pemë, frutat e bukurine e sajë, që arrijnë në mijëra vargje e strofa.

Në ato të më mëposhtëmet, Tominasit e kërcënojn mollën, dhe ndër kohë e krahasojnë me djalin qe nana nuk e marton: *"U ngrejsh herët në mengjes, i voç mollës me këmesë. A ban koke, a të pres? Nje ke bani molla koka, nana gjalin s'e martoka.,,(13)*

A nuk janë lulet e kultivarëve të mollëve, edhe shembelltyrë e së bukurës edhe tërheqese të insekteve lozonjare e prodhues të mjaltit dhe tërheqëse me erën e këndshme? Bellovasit na e japin me shumë elegancë përgjigjen e kësaj pyetje:

"Fluturoi ni flutur e hollë, prej dardhe e ra në mollë. Merre Ali

perspektivë

Kastriot

Kodra e Ostushit

mollën-o, merre faqebardhën-o.,,(13)

Nuk i mungon krijuesit të thjeshtë popullor, të ngrejë e pasqyrojë edhe cilësitë e mollës, siç është era, shija e amël, ngjyrat, levorja etj. Ja se si e thur me plotë lirizëm vargun e këngës Muhurraku: *''U pajk molla alle-alle, ra në tufa të krahut-o,. Prajte-prajte Ali zogju, lulen e livadhit –o.,,(13)*

Ndërsa Lurjani me të njëjtin këndëvështrim: *"Kam di molla për jelek;për jelek i kam di molla, mora njanën e kërkova, ishte si mjalti e zi si bora.,,(13)*

Nuk i ka shpëtuar nuhatjes së mençurisë popullore, edhe vjelja e mollëve, krahasimet e goditura e lirika tejskashme emocionuese ngjizur kjo me krahasimet e goditura. Dhe ja si shprehet Borovasi: *"Tavani me lule, qylymat me mollë, dil dallëndyshe e vogël, dil e fshijë oborr. Të pa Ali aga , ta bani me dorë, Ta mori shaminë, ta mushi me mollë.,,(13)*

Tridhjetë e pesë vjetë më parë poeti i ri në atë kohë Xhafer Martini do të shkruante vargjet e thekura nga frymëzmi: *''Lamtumirë! Më duhet të iki. Një pjesë të peisazhit po hedh mbi supe. Nga kopshtete dashura me mollë, ja, po këput një mollë të kuqe….,,(5)*

Jane vargje që mbajnë një karikim emocional të vazhdueshëm gjithmonë kënaqësindjellës. Por gjithashtu mëson e vështron frutin e mollës jo vetëm si një frutë biblik, por edhe si një realitet që të befason me cilësitë e tijë, si pemë frutore gjithastu edhe si ushqim mjaft i preferuar qe ka rrënjëzuar edhe në traditën popullore, në shume këndë vështrime.

MOLLA SI USHQIM E SI KOMPLEKS BIO-FIZIOLOGJIK

Njeriu e vuri në përdorim atë për ushqim, duke e shumuar me shartime, me farë apo trasferimin e sajë nga një krahinë në tjetrën. Janë tashmë të njohura, Molla e Zerqani, e Bulaçit, e qafë Murrës apo e Çidhnës. Të cilat u përdorën në mënyrë artizanale, duke u konservuar në tallose apo kashtë thekri e gruri të cilar rronin deri në Shëngjergj, të prera në copa e të thara në levarë si hoshaf. Të pjekura në prushin e oxhakut mbuluar me hirin e thëngjijt e drurit të djegur të lisit haheshin me kënaqësi.

"…Frutat ishin shumë të pakta, i ruanin e i hanin gjatë dimrit pas buke, por shpesh nga se nuk kishin tjetër, plakat sidomos i ruanin veçanërisht mollët, ftojt e arrat, kur shkonin të shikonin ndonjë të sëmurë. Kështu nisi të ndihet më shumë nevoja e mbjelljes dhe e përdorimit të pemëve…,,(3) Kështu lindi si nevojë kultivimi i pemëve frutore dhe më pas u shëndrrua me rrjedhjen e kohës, në traditë si, mbjellja, rritja, dhe përdorimi i tyre.

Duke pregatitur ëmbëlsira te ndryshme me mjeshtri sipas krahinave duke zbukuruar sofrën me raste festash me molla të freskëta shumë ngjyrshe. Podhimi i komposteve, reçelëve, lëngjeve të frutave, marmallatave, likuorëve, verërave, rakisë në fillim me metoda artizanale e më pas nëpërmjet futjes së teknologjive të reja, por gjithmon të shijshme e të ngrënshme mbi të gjitha në stinën e Dimrit e të Pranverës.

Të freskëta ato përdoreshin në festat e ndryshme dhe nderohesh miku duke i treguar prejardhjen dhe tregime, legjenda, këngë te ndryshme mbi Mollën.

Vetë pema e mollës është rezistente, kërkon ujitje në tre vitet e para, teknikë ne punimin e tokës herët në pranverë, dhe krasitjen duke ruajtur formën e kurorës e rralluar degët duke lënë raporte të drejta sythesh që prodhojnë fruta dhe ato që do të çelin gjethet.

Plantacionet me mollë ishin të varieteve të ndryshme, si Starking son, spur; Reneta, Golden, Kihet kanadeze, Gran Smith, Jonathen; Mustafe e dhjetëra të tjera. Vetëm në vendin e lindjes së pemtarisë massive e intensive në Zdojan ishin rreth tetëdhjetë kultivar pemësh frutore.

Prodhoheshin në fidanishte, ku mbillej me farë duke prodhuar drurët nënshartues, ndërsa mbishartesat merreshin varitete e mollëve të ardhura edhe nga jashtë shtetit ose nga krahina të ndryshme të shqiprisë.

PËRÇAPJE MBI TOPONOMISTIKËN

Molla ka zëvendësuar emërtime të vendeve të ndryshme, apo është zhdukur. Rrebeshe e shekujve kanë vepruar me ligjësitë e veta të zhvillimeve, politike, ekonomike e kulturës së pergjithshme shoqërore, kushtëzuar me ligjet biologjike të vetë llojit.

Në krahinën e Lurës ndodhet fshati Arë-Mollë i cili anashkalohet nga një përrua me të njëjtn emër, i cili shtrihet në një thyerje terreni e karakteristika te veçanta në madhësine e rritjes të vetë pemës së mollës e frutave të prodhuar prej sajë.

Maja e Mollës me lartës 707 metra, e veshur me bungë, shparth, Qarrë e ndonjë frashër e shkozë të cilat përbëjnë veshjen bimore drunore. Ngrihet në mes Arapit të Epër në Jug - Perëndim ndërsa në veri lindje me Fushë- Muhurrin dhe së fundi në Perëndim me shpatet qe zbersin vrullshëm në buzët e shtratit të lumit Drin. Të cilat kanë emra të ndryshme si Kodra e Rame, Duksat, Kodra e Ballës, përroi i Derrit, Rrahanajt etj, e cila është vetëm një listë simbolike e toponomistikës së kësaj zone.

Ndërsa *Lugu i Mollës* ndodhet tek lagjia e Mezeze të Epër, ku kufizohet nga Perroi i Zabelit, ara e Bushit, Kepi i Keq, krua ku mbushesh ujë per të pirë nga muaji Tetor deri në Maji të vitit në vazhdim. Ndoshta për krua ose lugje për të pirë ujë blegtoria është përdorur druri i mollës.

Dhe më poshte një toponim çudisjellës në krahinën e Katrgrykëve: *"Lidhja e gjymtyrëve është emër + parafjalë + emër në kallzore: Molla n'Kepa, Shelnia e Gjetës, Ahu i Avdiut.,,*(1)

Ndërsa në kërkimet tona gjejmë emërtime të vjetra, por lista e toponomistikës me këtë emër rinohet me emërtime të reja. *"Mollasi , fshat në rrethin e Kolonjes. Është qendër banimi e re , e ngritur më 1959 për punëtorët e N.B. ''Nasi Vodica,, dhe të minierës së qymyrgurit në Bezhan.,,(15)*

Në librin "Popullsia shqiptare në vitin 1923,, do të gjejmë emrat e disa fshatrave apo krahinave me emrin e saj*: " Krahinaria e Mollasit, në Elbasan. Në Katundet e krahinarit të Shoshit (Shkodër. S.M.) ndodhet Katundi Molla, me 17 shtëpi.,, (2)*

Përdorimi edhe si emër është një fakt që vërteton se sa ishte ngjizur me jetën e popullsisë së Dibrës, molla *" Në vitin 1860-70 dhe gjer te Lidhja Shqiptare e Prizerenit përsëri katërgrykasit Mer Kolecin, Sul Koneshën, Mollë Bajramin,etj. Luajtën një rol të rëndësishëm…,,(4)*

Historiani i shquar Dibranë Hilmi Sadikaj, duke shkruar per prejardhjen e fiseve që kanë populluar fshatin Radovesh, shkruan:

"Ky fis(Rama)kishte dalë nga fshati Kete i Matit. Në fillim, i pari i kësaj familje, Hamza Dish Rama, kishte ardhur në qytetin e Dibrës së madhe. Ketije i kishin lindur shtatë djem: ….Sulejmani- ishte bërë pasha Vilajeti, diku në Turqi, në Molle të Kuqe….,,(16)

Ka edhe fise të tëra me *mbiemrin Molla*.(14) Nuk perjashtohet mundesia që ky emërtim ka ardhur se ato ishin mjeshtër të rritjes se tyre. Te gjitha këto të dhena na shtynë të gjykojmë se kjo pemë frutore ishte një bashkëshoqëruese e bashkëudhëtare e brezave të tërë të banorëve të krahinës së Dibrës së Poshtëme, padyshim edhe të gjithë Shqipërisë.

SI MUND TË PROJEKTOHET E ARDHMJA?

Në brazdat e kohërave, kërkoi embrionin e zhvillimit të kësaj kulture që vjen shtatë bukur dhe krenare nga zotësia për të çarë në labirinthet e shekujve, duke ruajtur llojin e vetë, pasuruar llojshmërinë brënda vetes, e shërbyer njeriut në të gjitha etapat e jetes, moshës e veprimtarisë së tijë.

Me pak guxim, me njohuritë, botanike, biologjike dhe përvojën e grumbulluar përgjatë tridhjetë vjetëve mund te rifillojmë te rikrijojmë blloqe të reja duke zbukuruar peisazhet e dhe hap rrugën zhvillimit.

Në favor të bujkut Dibranë pemtarë është, klima me temperaturën , sasinë e llojin e rreshjeve, toka prodhuese e deshmitare e rendimenteve të larta, ujët e bollshëm, relievet e shumta me kodra, kurrize, brinja e lugina, brezaret akoma të gatëshme për të mirëpritur mollën, kumbullën, arrën, dardhën etj.

Duhet të vihet në lëvizje agranomët me aftësi profesionale, zgjuarsia e politikaneve dhe drejtuesve, në dhënien e direktivave, hartimine projektve për zona të ndryshme, gjetjen e investitorëve, dhe më pas vijne sigurimi i fidanave, mbjellja e tyre, shërbimet agroteknike. Vetëm kështu vihet në shina treni e sukseseve, dhe tradita është llamburitja e dritave dhe energjia pëe lëvizjen e tijë.

Krijimi i strukturave të magazinimit, transportit, gjetjes së tregjeve të brendëshme e të jashtme, zbatimi i teknologjive të reja të përpunimit të frutave. Vlerësimi e paraqitja në panairet ndërkombëtare, dhe reklama e zgjuar me të gjitha mjetet, duke përdorur famën e mollës Dibrane ne të kaluarën jo të largët.

Veprimtarinë gjeniut të Kompiutëreve e filloi nga një garazh, e më pas e shtriu në treqind dyqane e fabrika prodhimi, duke arritur në pesëdhjetë mijë punëtor. Nga Kalifornia në Honkong, nga Barazili në Finlandë e prodhimet e tija sfiduan MAPOT e mëdha në çdo skaj të globit duke u vënë në ballin e vitrinave e përdorur në gjithë veprimtarinë e njeriut, të dijes, komunikimit, argëtimit e në arritjet shkencore në sherbim të njeriut.

Atëhere, mjafton shembulli i tijë e trashgimia profesionale e specialistëve e bujqëve dibranë të cilët janë të gatshëm të shkrijnë të gjithë energjitë e tyre për të prodhuar mollë e fruta të tjera që të sfidojë tregjet kombëtare e ndërkombëtare, duke e dëshmuar me çertifikatën e prejardhjes nga treva Dibrane. Me kokrrat me bukuri tërheqëse me shije të papashme, me çmimin e levërdisshëm dhe freskinë e dëshirueshme e shumë kërkueshme, nga blerësit e qytetëruar, evropian, aziatik, afrikane ndoshta dhe ato amerikanë, duke pushtuar këto tregje edhe me cilësinë e prodhimit edhe me sasinë.

Duhet te rizgjojmë trurin pjellor të agronomëve dibranë të të gjitha moshave, të politikanëve, shkrimtarëve, gazetarëve, të nxjerrim nga mbulesa e blozës të harresës, krijuesit e pare te blloqeve frutore, të shkruajmë në shtyp libra, broshura, internet mbi mrekullinë që krijuan mjeshtërit e pemtarisë Dibrane, zgjidhjet konkrete në nxitjen e fermerëve per investime në këtë fushë. Kështu syte e mëndjes do të shkunden nga plogështia, padyshim do të rizgjohen dhe si rrjedhojë do të prodhojnë sigurisht energji të reja, duke futur në shinat e veta trenin e zhvillimit të pemtarisë dibrane.

* * *

Rikthimi për të studiuar e më pas zbatuar atë që dikur ka dhënë rezultate të shkëlqyera, duke lulëzuar tokën e shkretuar (150.000 ha, ish pemtari e për kultura bujqesore), punësuar banoret e ketyre krahinave e rritur standartin e jetesës, nuk është përulësi, as gjynah, dhe aspak pendim, por përkundrazi, zgjuarsi e udherrëfyese për të arritur suksesin. Ashtu siç u shpreh shtypi boteror pas humbjes të shkencëtarit të madh *Stevën Xhobs se: "Tre mollë kanë ndryshuar botën: ajo e Adamit, Njutonit dhe e Xhobsit.,,(10)*

Padyshim edhe ajo e Dibrës, do të ndryshojë në të gjitha qelizat e veprimtarisë ekonomike kulturore të popullit në Dibrën e Poshtëme, duke i rritur prestigjin shkencës së pemtarisë e bujkut të kësaj treve, në arenën kombëtare e ndërkombëtare dhe për rrjedhojë duke shtuar të ardhurat në fushën ekonomike e sjellë një jetesë normale banorëve të këtyre krahinave. E keshtu do të shtohet mrekullia e mollës që do të jetë e katërta. Besimi im për sa më sipër ka madhështinë e Korabit, kreshtë bukur e mrekullues.

1 – M. Trepça.Vështrim mbi toponimet e Katër Grykëve. Dibra e dibranët. f. 269. Shkodër 1985
2 – T. Selenica. Popullsia shqiptare në vitn 1923. Tiranë 1923
3 - I. Lala, F. Meha. Rreth kulturës së punës të bujkut dibranë. Dibra e dibranët. f. 115. Shkodër 1985
4-F. Perhati, T.Bruçi, H. Lala. Katër Grykët dhe traditate tyre në luftën patriotike. Dibra dhe Dibranët. f. 145. Shkodër 1985
5- Almanak Dibra 1976. Tiranë 1976
6- Il grande libro dei Personaggi. F. 20. Novara 2007
7- La Bibia. f. 32 Varese 2010
8- Il Sole 24 ore. Venerdi 7 Ottobre 2011
9- La Republica. Venerdi 7 Ottobre 2011
10- Il resto del Carolina. Venerdi 7 Ottobre 2011
11- Sali Ajazi. Rexhep Doda një jetë kushtuar atdheut. Rruga e Arberit. f.14. Maji, 2010
12-Murat Koltraka. Bukuri dhe vlerat te natyrës, Dibra apo Skavica. Rruga e Arberit. f.3. Qërshor 2010
13- Hilmi Kolgjegja. Folklor nga Dibra. Tiranë 1990
14- Rruga e Arbërit. Tetor 2010
15- Fjalori enciklopedik Shqiptar. f.721, Tiranë 1985
16- Hilmi Sadikaj Gollobordasit e Dibrës. F. 134,135 Tiranë 1999

Rruga Arbërit nr. 67

veprimtari

Krijohet shoqata etnokulturore "ÇIDHNA DHE KASTRIOTËT"

Me date 28 nëntor 2011, në mjediset e restorant "Edisem" në Tiranë, në praninë e mbi 300 pjesëmarrësve nga krahina e Çidhnës dhe Kastriotit u themelua shoqata etnokulturore "Çidhna dhe Kasttiotët".

Në emër të grupit përshëndeti të pranishmit iniciatori i kësaj shoqate z. Mustafa Tola, dhe më pas, lexuan pjesë të statutit dhe programit, Ali Hoxha, Hysen Repa dhe Bujar Karoshi.

Gjithashtu, në këtë veprimtari përshëndetën edhe disa nga pjesëmarrësit, si Xhafer Martini, Dali Noka, Rrahman Rusi, etj.

I pranishëm në këtë veprimtari ishte edhe këngëtari Qerim Sula, i cili këndoi disa nga këngët patriotike.

Kjo veprimtari shënoi hapin e parë të rregjistrimit të shoqatës dhe zgjodhi kryesinë , e cila do merret me përpunimin e programit të veprimtarive të shoqatës në vazhdim.

Si objekt diskutimi, u la që të punohej edhe në përmirësimin e statutit dhe programit, drafttë cilin po i botojmë në këtë numër të gazetës.

PROGRAMI

QËLLIMI DHE OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQATËS

Qëllimi i Shoqatës është:

-Të qartësojë origjinën "ÇIDHNAKE" të "KASTRIOTËVE" me synim unifikimin e mendimit të Shqiptareve për origjinën e Skenderbeut, figurës kryesore Kombetare.

-Të ndriçojë historine e Krahinës Etnokulturore të ÇIDHNËS, pjesë e së cilës janë fshatrat SINË dhe KASTRIOT.

-Të evidentojë vlerat etnokulturore, mjedisore, gjeomonumenteve Natyrore e Monumenteve Turistike të krahines se Çidhnës,

-Të kontribuoje në ngritjen e një përmendoreje në kujtim të Masakrës së Çidhnës, kryer nga Sulltan Mehmeti në vitin 1466, pas rrethimit të II të Krujës si masakra me e madhe në Historinë Kombëtare të Shqiptarëve,

-Të mbrojë dhe promovojë vlerat me synim zhvillimin e turizmit të kombinuar historiko-malor dhe biznesit në harmoni me mjedisin,

-Të mbështesë dhe të promovojë cdo nisëm që i shërben harmonisë, tolerancës, mirëkuptimit, unitetit të qytetarëve të komunitetit të Cidhnës në vijim të traditës së shtatëdhjetë shtëpive të Has Përnezhës,

-T'u transmetojë brezave traditën dhe kulturën e krahinës dhe t'i zhvillojë ato më tej etj

ANËTARËT THEMELUES

Statuti

KREU I
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA DHE ADRESA E FAQES SE INTERNETIT

Neni 1
DATA E THEMELIMIT, EMRI DHE THEMELUESIT

Sot me datë 28.11.2011(dymijëenjëmbëdhjetë), ditë e hënë, ne themeluesit,

(vijojnë emrat e themeluesve)

-Ne mbeshtetje te Ligjit nr.8750, date 29.07.1994, ndryshuar me Ligjin nr.8781, date 03.05.2001, nenet 39-53 dhe Ligjin nr.8788, date 07.05.2011"Per Organizatat Jofitimprurese" si dhe ne Aktin e Themelimit, hartojme kete STATUT per krijimin e Shoqates Etnokulturore"ÇIDHNA DHE KASTRIOTËT".

Flamuri i Shoqates do te jete:

-Stema dhe Flamuri do te jete Flamuri me shqiponjen qe eshte zbuluar ne Kishen e Kepit te Rodonit qe eshte ndertuar ne kohen e Skendebeut.

NENI 2
QENDRA DHE TERRITORI I VEPRIMTARISË

Qendra e Shoqates do te jete ne qytetin e Tiranes, ne adresen:Hotel "EDISEM", Kthesa e Kamzes, prane shinave te Trenit.

Veprimtaria e saj do te shtrihet ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise duke hapur dege ne rrethe, qytete, komuna si dhe shtete te tjera duke siguruar numrin e anetareve te saj.

NENI 3
QËLLIMI DHE OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQATËS

Qëllimi i Shoqatës është:

-Të qartësojë origjinën "ÇIDHNAKE" të "KASTRIOTËVE" me synim unifikimin e mendimit të Shqiptareve për origjinën e Skenderbeut, figurës kryesore Kombetare.

-Të ndriçojë historine e Krahinës Etnokulturore të ÇIDHNËS, pjesë e së cilës janë fshatrat SINË dhe KASTRIOT.

-Të evidentojë vlerat etnokulturore, mjedisore, gjeo-monumenteve Natyrore e Monumenteve Turistike të krahines se Çidhnës,

-Të kontribuoje në ngritjen e një përmendoreje në kujtim të Masakrës së Çidhnës, kryer nga Sulltan Mehmeti në vitin 1466, pas rrethimit të II të Krujës si masakra me e madhe në Historinë Kombëtare të Shqiptarëve,

-Të mbrojë dhe promovojë vlerat me synim zhvillimin e turizmit të kombinuar historiko-malor dhe biznesit në harmoni me mjedisin,

-Të mbështesë dhe të promovojë cdo nisëm që i shërben harmonisë, tolerancës, mirëkuptimit, unitetit të qytetarëve të komunitetit të Cidhnës në vijim të traditës së shtatëdhjetë shtëpive të Has Përnezhës,

-T'u transmetojë brezave traditën dhe kulturën e krahinës dhe t'i zhvillojë ato më tej.

NENI 4
KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqatës "ÇIDHNA dhe KASTRIOTËT" është e pakufizuar.

KREU II
ANËTARËSIMI NË SHOQATË, ORGANET DREJTUESE, KOHËZGJATJA

NENI 5
ANËTARËSIMI

Anëtarësimi në Shoqatë është i vlefshëm për të gjithë shtetasit pavaresisht racës, gjinisë, nacionalitetit, religjionit apo moshës.

Përjashtimi i anëtarëve bëhet kur veprimtaria e tyre bie ndesh me permbajtjen e statutit dhe qellimin e shoqates ose me largimin vullnetar per arsye fizike ose madhore. Organi me i lartë i Shoqates është Mbledhja e Pergjithshme e Anetareve te Shoqates ose Asambleja e Shoqates. Mbledhja e Pergjithshme vendos per pranimin ose përjashtimin e anëtarëve.

Propozimi per perjashtim behet nga Komisioni Disiplinor dhe miratohet nga Asambleja.

Asambleja miraton programin vjetor të aktiviteteve që do të realizojë shoqata për realizimin e objektit të parashikuar në këtë Statut.

Mbledhja e Pergjithshme zgjedh ose shkarkon keshillin drejtues me votim te fshehtë.

Të gjithë anëtarët e shoqates kanë të drejtë vote të barabartë në Mbledhjen e Përgjithshme.

Vendimet merren me shumicën e votave te anëtareve që janë të pranishëm në mbledhje.Për ndryshimin e Statutit, për perjashtimin e një anetari dhe për shpërndarjen e shoqates duhet të jenë të pranishëm në mbledhje të pakten ¾ e anëtarëve.

Emri dhe adresa e cdo anetari te shoqates do te mbahet ne nje regjister te vecante qe do te quhet Regjistri i Anetareve.

NENI 6
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANËTARIT TË SHOQATËS

-Të perfitoje nga cdo sherbim qe ofron shoqata dhe qe ka lidhje me objektin e veprimtarise se saj,

-Duke siguruar se nuk ka pengesa ose detyrime te tjera te papaguara kundrejt shoqates te marre pjese dhe te votoje ne takimet e Mbledhjes se Pergjithshme te shoqates ose

-Duke siguruar se nuk ka pengesa ose detyrime te tjera te papaguara kundrejt shoqates te votoje per zgjedhjen e perfaqesuesve te saj ose

-Të zgjidhet si perfaqesues i saj, si anetar i Kryesise, i Keshillit Drejtues ose ne ndonje organ tjeter te shoqates ose ne postin e Kryetarit te saj,

-Të kontrollojë librat, regjistrat dhe llogarite vjetore te shoqates,

-Të propozojë tematiken qe do te diskutohet ne Mbledhjen e Pergjithshme lidhur me organizimin dhe aktivitetin e shoqates ose

-Të kerkojë nga perfaqesuesi i tyre qe te propozoje dhe te diskutoje ne takimet e Mbledhjes se Pergjithshme,

-Të shfaqë mendimet e tij, te diskutoje ne cdo mbledhje te organizuar, te kerkoje llogari per harxhimin e fondeve te shoqates, te kundershtoje ne gjykaten kompetente vendimet e Shoqates qe vijne ne kundershtim me ligjin dhe Statutin e Shoqates brenda nje muaji nga dita qe ka marre njoftimin per ate vendim.

Gjithashtu cdo anetar ka për detyrë të zbatojë me rigorozitet dispozitat ligjore në fuqi dhe statutin e shoqates si dhe të derdhë kuotat nje herë ne vit dhe në datën e caktuar.

NENI 7
ASAMBLEJA

Asambleja eshte autoriteti me i larte i kesaj Shoqate.Asambleja ka pergjegjesi per miratimin e programit dhe aktivitetit financiar te Shoqates dhe miraton bilancin nje here ne vit. Ne fillim te takimit Asambleja zgjedh kryesuesin dhe protokolluesin.

Miraton statutin, ndryshimet ne statut dhe programin e punes, pranon rregulla dhe akte te tjera normative,

Voton Kryetarin, Kryesine dhe Sekretarin e Pergjithshem.Cakton pagesen e anetaresise, ndihmon ne mbledhjen e fondeve,

Asambleja mund t'i delegoje c'faredo pergjegjesie kryesise me vendimin e shumices se te pranishmeve ne perputhje me te drejtat e lejuara per Organizatat Jofitimprurese.

Asambleja mblidhet si rregull nje here ne vit si dhe ben mbledhje te jashtezakonshme kur propozohet nga 50% e anetareve ose nga 50% e kryesise.Njoftimi per mbledhje behet 7 dite para dhe zhvillohet kur ne te marrin pjese 50+1 % e anetareve.

Asambleja zgjedh me votim te hapur ose te fshehte Keshillin Drejtues, sipas vendimit qe merr me shumice te thjeshte.

Vendimet merren kur votojne 50+1 % e anetareve te pranishem.Cdo anetar ka nje vote.

NENI 8
KRYESIA E SHOQATËS

Kryetari i pare i Shoqates mund te mos jete Kryetari themelues.Mandati i Kryetarit do te jete 2 vjecar.

Kryesia do te zgjidhet nga Asambleja dhe do te perbehet nga Kryetari Themelues, Kryetari ne detyre dhe kryetari pasardhes qe do te ushtroje detyren pas 2 vjetesh, kur do te rizgjidhet edhe kryetari tjeter pasardhes krahas kryetarit ne detyre.

Sekretari gjithashtu do te kete mandat 2 vjecar me te drejte rizgjedhjeje dhe do te ushtroje aktivitetin ne perputhje me statutin.Ai pergatit raportet e punes, bilancin vjetor dhe propozimet e financimit te aktivitetit sipas programit te punes.Mban koorespondencen, nenshkruan dokumentet, kujdeset per vulen dhe perdorimin e saj sipas ligjit.Kujdeset per dokumentacionin, financen, pergatit evenimentet, seminaret, takimet mujore. Propozon ndarjen e cmimeve ndermjet anetareve te vecante apo organizatave te jashtme, sponsorve etj.Punon per te rritur bashkepunimin me organizata, shoqate, organe shteterore si dhe subjekte te tjera ligjore per qellime te misionit te shoqates.

Propozon planin e punes per periudhat e ndryshme apo aktivitete shtese te shoqates.Pergatit materialet per botim dhe materiale te tjera sensibilizuese.Merr pjese ne mbledhjet e kryesise pa te drejte vote.

Sekretari mund te lirohet nga detyra para perfundimit te mandatit nese nuk i permbahet statutit, i shkakton dem shoqates apo i jep imazh te keq asaj. Per kryerjen e puneve profesionale dhe administrative mundet te ofroje sherbime sipas kritereve te tregut me se paku 2 oferta me miratim te kryetarit ne detyre.Gjithashtu pergatit kontratat me ndermjetesimin e kryetarit.

NENI 9
KESHILLI DREJTUES

Keshilli drejtues perbehet prej anetareve te zgjedhur nga Asambleja e Shoqates.

-Keshilli Drejtues ka pergjegjesi per politiken, strategjine, ceshtjet financiare dhe merr vendime ne emer te shoqates.

-Ben miratimin e projekteve, planeve, planprogrameve afatmesme etj,

-Nese del e nevojshme zgjedh drejtorin dhe cakton pergjegjes per pune te caktuara, duke votuar me 50%+1 vota.

-Keshilli drejtues perbehet nga 31 anetare te zgjedhur nga Asambleja, me mandate 2 vjecar.

-Keshilli drejtues mblidhet jo me pak se cdo tre muaj.Sa here del e nevojshme mblidhet per t'u dhene zgjidhje problemeve qe lindin.

Per caktimin e procedurave te mbledhjes do te miratohet ne Keshillin Drejtues rregullorja e punes.

NENI 10
KOMISIONI DISIPLINOR

Komisoni disiplinor eshte Organi ankues ne Shoqate.

Komisioni disiplinor perbehet nga 3 anetare, nga Kryetari i Shoqates dhe 2 anetare qe zgjidhen nga Asambleja e Shoqates.

Anetaret e Komisionit disiplinor zgjidhen dhe miratohen nga Asambleja me mandat 2 vjecar. Anetaret e Keshillit Drejtues nuk mund te jene anetare te Komisionit Disiplinor.

Vendimi i Komisionit Disiplinor hyn ne fuqi pasi miratohet nga Asambleja.

NENI 11
VULA E SHOQATES

Shoqata ka vulen e saj ne forme te rrumbullaket me diameter 30 milimeter, ne te cilen, ne forme te rrumbullaket shkruhet emri i shoqates ne gjuhen shqipe.Ne qender te vules gjendet logoja e shoqates.

NENI 12
PËRFAQËSIMI

-Në ndjekjen e procedurave të nevojshme për regjistrmin e shoqatës jofitimprurëse autorizohet anëtari i shoqatës Përparim Noka, me profesion Avokat,

-Përfaqesimi ligjor me të tretët i Shoqates Jofitimprurëse"Çidhna dhe Kastriotët"do të kryhet nga Kryetari i saj në detyrë.

NENI 13
MËNYRA E SHPËRNDARJES SË SHOQATËS

Shoqata shpërndahet në keto raste:

-kur numri i anëtarëve është nën tridhjete vetë,

-kur qëllimi i saj është përmbushur apo nuk ka mundësi të përmbushet pasi ka humbur aftësine paguese,

-me vendim të gjykatës kompetente kur shoqata largohet nga qellimi i saktësuar në Statut ose kryen veprimtari të kundraligjshme.

Shoqata shpërndahet me Vendim të Mbledhjes së Përgjithshme të thirrur nga Këshilli Drejtues me shumicen e votave te anetareve.

Në rast shpërndarje të shoqatës ajo ç'regjistrohet, pushon veprimtarine e saj dhe vihet ne likujdim nga komisioni i likujdimit i cili formohet sipas rregullave dhe ligjeve ne fuqi.

Në rast shpërndarje të shoqatës ajo ç'regjistrohet, pushon veprimtarine e saj dhe vihet ne likujdim nga komisioni i likujdimit i cili formohet sipas rregullave dhe ligjeve ne fuqi(Kodi Civil i Republikes se Shqiperise dhe nenet 38 dhe 39 te Ligjit nr.8788, date 07.05.2001"Per Organizatat Jofitimprurese"

Pas vendimit per shperberje Asambleja mund te vendose per kalimin e kapitalit ne cilendo shoqate apo fondacion te ngjashem apo ne disa prej tyre.

NENI 14
NDRYSHIMI I STATUTIT, AKTIT TE THEMELIMIT DHE RREGULLAVE TE BRENDSHME TE SHOQATES

Statuti, Akti i Themelimit dhe Rregullat e Brendshme te Shoqates mund te ndryshohen me vendimin e dy te tretave anetareve te Asamblese se Shoqates.

NENI 15

Ky Statut hyn ne fuqi diten e miratimit te tij ne Asamblene e Shoqates.

ANËTARËT THEMELUES

Mustafa Tola, Xhafer Martini, Agim Kukeli, Shkelqim Koltraka, Ali Hoxha, Rruzhdi Bitri, Perparim Noka, Xhevdet Kariqi, Medat Zoku, Xhevdet Kacani, Huzri Hoxha, Murat Koltraka, Zyber Gjoni Hajredin Toca, Hysen Repa, Rakip Suli, Muhamet Bitri, Islam Cani, Ismail Hasi, Ilmi Kola, Enver Kaloshi, Bujar Karoshi, Haxhi Krashi, Haki Pernezha, Idris Kukeli

edukim

Arsimimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në Maqedoni

Nuk ka kushte për mësim

Nga **Mr. Dita TORTE**

Në Republikën e Maqedonisë viteve të fundit është intensifikuar debati lidhur me mësimin inklusiv në shkollat e rregullta fillore për fëmijët me nevoja të veçanta. Disa mendojnë se mësimi inklusiv mund të aplikohet, ndërsa disa t ë tjerë mendojnë se për këtë lloj mësimi në Maqedoni ende nuk ekzistojnë kushtet e nevojshme.

Shumë dokumente ndërkombëtare na obligojnë që t'i përfshijmë fëmijët me NAV (nevojat për arsimim të veçantë) në procesin e arsimit sëbashku me fëmijët tipikë, të cilët nuk kanë nevoja të këtilla. Me këta fëmijë duhet të punojnë arsimtarë të stërvitur e të përgatitur posaçërisht për klasët dhe lëndët, ndërsa gjatë kësaj duhet ta kenë edhe ndihmën e personave tjerë profesionistë si (Edukatori special-defektologu, logopedi, fizioterapeuti, pediatri etj.). Këta fëmijë duhet të arsimohen sipas plan programit paraprak arsimor, të hartuar e të përshtatur sipas nevojave dhe mundësive individuale të nxënësit. Njohuritë tona na tregojnë se në pjesën më të madhe të rasteve inklusioni është formal dhe kryhet vetëm sa për të përmbushur gjendjen numerike të nxënësve në klasë. Nxënësi me NVA (me nevoja të veçanta arsimore) përderisa ndodhet në mësimin klasor, ai thjesht kalon nga klasa ku ndodhet në një klasë më lartë. Probleme më të mëdha paraqiten në mësimin klasor, kur këta nxënës fillojnë të marin nota të dobëta, kur krijohen probleme në sjelljen e tyre dhe një pjesë e tyre vendosin të vijnë në IVA (në institucionin e veçantë arsimor).

Këta fëmijë që vijnë në shkollat fillore në klasën e pestë ose të gjashtë janë të paarsimuar, të pasocializuar, me pasoja të përhershme në aspektin emotiv dhe me periudhë të vonuar të zhvillimit.

Sipas njohurive dhe hulumtimeve tona, gati askush nuk është i kënaqur nga ky model i inklusionit dhe nga kushtet në të cilat realizohet ai, dhe se janë të domosdoshëm adaptimi dhe të përshtaturit.

Shkolla e posaçme fillore "Idnina" në Shkup realizon mësim edukativ arsimor për nxënësit me nevoja të veçanta dhe është shkolla e parë e këtij lloji hde njëherësh është edhe shkolla më e madhe për këtë lloj arsimimi. Kjo shkollë disponon me kushtet teknike, kapacitetet hapësinore dhe resurset kadrovike.

Në shkollat e posaçme fëmijët kanë ndihmën profesionale nga kuadri profesionist. Me kalimin në shkollat e rregullta fëmija e humb këtë ndihmë. Në shkollën "Idnina" realizuam një sondazh nëpërmjet intervistave, pyetsorëve dhe testimit me nxënësit që kishin ndjekur mësimin inklusiv në shkollat e rregullta dhe që erdhën në shkollën tone, si edhe me prindërit e këtyre nxënësve. Bëmë një analizë krahasuese te nxënësit që kishin ndjekur mësimin në shkollat e rregullta dhe te nxënësit në shkollën e posaçme. Në këto hulumtime u përfshinë dy grupe me nga 30 nxënës të klasës së V-VIII. Njëri grup ishte me nxënës që kishin ndjekur mësimin në shkollën e rregullt, ndërsa grupi tjetër në SHFP "Idnina". Nga hulumtimet që i bëmë arritëm në konkluzion se në shkollat e rregullta nuk ekzistojnë kushte kadrovike dhe organizative për realizimin e mësimit inklusiv. Në shkollat e rregullta nuk ekzistojnë kushte materiale dhe teknike. Nxënësit me nevoja të veçanta pengojnë në realizimin e aktiviteteve me nxënësit e tjerë. Nxënësit në shkollat e rregullta pjesërisht i pranojnë fëmijët me nevoja të veçanta. Prindërit pjesërisht bijnë dakord që fëmija i tyre të ketë shok një fëmijë me nevoja të veçanta. Mësimdhënësit në shkollat e rregullta nëk janë stërvitur sa duhet për implementimin dhe zbatimin e arsimit inklusiv. Inklusioni në shkollat e rregullta nuk kontribon në arritjen më të suksesshme të diturive dhe nuk ndikon në mënyrë stimuluese te fëmijët me nevoja të veçanta.

Inklusioni nuk i përmbushi dëshirat e prindërve dhe mësimdhënësve. Prindërit pjesërisht, ndërsa mësimdhënësit aspak nuk janë të mendimit se fëmijët me nevoja të veçanta do të ndjeheshin më këndshëm, më të plotësuar dhe me më shumë kreativitet. Prindërit dhe mësimdhënësit u shprehën se nevojiten më shumë forma për ndihmë plotësuese, materiale, organizative - teknike dhe kadrovike. Fëmijët që ishin të përfshirë me arsimin inklusiv kishin mbetur të paarsimuar. Fëmijët që ishin përfshirë me mësimin inklusiv nuk ishin socializuar aqë sa duhet.. Fëmijët e përfshirë me mësimin inklusiv kanë çrregullime dhe probleme emotive, si rezultat i talljeve dhe përqeshjeve nga nxënësit moshatarë të tyre. Nxënësit me nevoja pë veçanta nuk kanë qenë të pranuar nga mjedisi i nxënësve të tjerë nq shkollë. Mësimdhënësit nuk u kushtojnë vëmëndjen e duhur fëmijëve me NAV (nevoja arsimore të veçanta). Nuk ka aktivitete cilësore sociale për pranimin e inklusionit në shkollat e rregullta fillore.

Rekomandimet tona për mësimin inklusiv janë se, nevojitet transformim i shkollave fillore të veçanta në qendra rajoanle të resurseve për menaxhim me kuadro përkatëse të nevojshme për arsimin inklusiv. Në shkollat fillore duhet të themelohen komisione për katregorizimin, definimin e parametrave për inklusionin dhe përcaktimin e nevojave arsimore. Përshtatja e sistemit të vlerësimit dhe e dhënies së notave nxënësve me NAV (nevoja arsimore të veçanta arsimore). Aplikimi i inklusionit të kombinuar (lëndë të caktuara do të ndiqeshin në shkollën e posaçme, ndërsa lendët tjera në IFV (në Institucionin fillor të veçantë). Organizimi i aktiviteteve sociale për përfshirjen e nxënësve me NAV (nevoja arsimore të veçanta) në shkollat e rregullta fillore, organizimi i debateve dhe tribunave publike për inklusionin, pranimi i obligimit ligjor për arsimin inklusiv, por me sigurimin paraprak të kushteve në aspektin e ekipimit kadrovik, pajisjes materiale, sigurimit të kushteve teknike dhe aspektit të pranimit social. Pa përmbushjen e këtyre kushteve në Maqedoni nuk mund të kemi mësim inklusiv të suksesshëm, treguan hulumtimet tona të sipërpërmendura.

** Autorja është magjistre e defektologjisë nga Dibra e Madhe, aktualisht jeton e punon në Shkup*

Zenel Sula, mësuesi i të gjithëve

Festohet 80-vjetori i mësuesit, drejtuesit të spikatur dhe intelektualit dibran Zenel Sulës.

Më datë 12 nëntor 2011, në lokal "Brahja" Sauk u organizua kremtimi i 80-vjetorit të lindjes të mësuesit, drejtuesit të spikatur dhe intelektualit të shquar dibran Zenel Sulës.

Për të kremtuar këtë jubile 8 dekadësh kishin ardhur shumë vetë nga të gjithe trevat e Shqipërisë, bashkëmoshatarë dhe nxënës të shkollës së mesme " 8 Nëntori" Peshkopi.

Në këtë ceremoni jubilare nderuan me pjesëmarrjen përfaqësuesi i Ministrisë së Arsimit Fadil Kepi si dhe shumë personalitete si Abdi Baleta, Sulejman Tomçini, Natasha Shehu, Mentor Muça etj.

Veprimtarinë jubilare e hapi studiuesi dhe botuesi Gjetan Strazimiri. Ai ia dha fjalën përshëndetëse z. Shemsi Manjani një nga nismëtarët e organizimit të kësaj veprimtarie, koleg me Zenel Sulën dhe drejtor për pak koh i shkollës Pedagogjike Peshkopi.

Z. Shemsi Manjani u ndal në jetën dhe veprimtarinë plot arritje e dinjitet të Zenel Sulës dhe nënvizoi se ai si nxënës, si drejtues shkolle, si përkthyes dhe si kuadër kudo që punoi e drejtoi u shqua si intelektual vizionar me formim të plotë dhe i përkushtuar.

Zeneli qe edhe një kuadër shumë human e njerëzor. Askujt nuk i bëri keq, përkundrazi gjatë gjithë jetës së tij u përpoq të bëjë mirë pa cënuar ligjet e shtetit. Ai vuri theksin edhe tek dënimi i pamerituar i Zenel Sulës, i cili u transferua nga Ministria e Arsimit në një shkollë të fshatit Kurdari të Matit, në një kohë kur universiteti i Tiranës e kërkonte si pedagog të rrall e me vlera. Për këtë fukosoi çudinë e kolegëve të Ministrisë për këtë ndëshkim: "Mirë ne, po me Zenelin Cfarë patën ?" Ishte çudia e madhe e çdo punonjësi të asaj ministrie.

Për kontributin dhe veprimtarinë e Zenel Sulës përshëndeti edhe përfaqësuesi i Ministrisë Arsimit z. Fadil Kepi.

Të pranishmit i përshëndeti dhe falenderoi edhe bashkëshortja e Zenel Sulës, Sanie Sula, për pjesëmarrjen dhe nderin që i bënë në këtë veprimtari mbresëlënëse.

Po kush është Zenel Sula?

Ai lindi në vitin 1931 në një familje të nderuar dhe arsimdashëse të Zerqanit të Dibrës. U dallua në mesin e fëmijëve të atij fshati dhe pati rastin të gjëndet në konviktet e para të hapura pas luftës në vendin tonë. Fillimisht në Elbasan dhe pas l viti në Peshkopi. Gjatë gjithë kohës shkëlqeu në mësime. Mbaroi shkollën e mesme Pedagogjike shkëlqyeshëm dhe me kujdesin e vet Ministri të Arsimit të kohës Kahreman Ylli u dërgua për studime B.S. Edhe atje me një këmbëngulje e vullnet të rrallë mundi të kapërcejë boshllëqet dhe të mbaroi me rezultate shumë të mira. Pas kthimit në Shqipëri punoi si mësues në shkollën e mesme Pedaogjike Peshkopi, por edhe si drejtor. Qe një nga mësuesit më të kompletuar dhe një nga drejtuesit më të spikatur të kësaj shkolle.

Ish-nxënësi i asaj shkolle Faik Xhani kujton: " Zenel Sula ishte drejtor i shkollës së mesme Pedagogjike, mjeshtër i mësimdhënies që edhe dru të ishe, do të ta hiqte një ashkël dhe do të ta jepte një rreze mësimi e diturie. "

Zeneli ka përkthyer në shkollën e Lartë të Partisë, ka shoqëruar disa delegacione nga Shqipëria, dha mësimin e gjuhës shqipe në Bibliotekën Kombëtare, në Radio Moska etj.

Për pak kohë punoi si shef i Seksionit të Kulturës, në Gazetën "Bashkimi", " inspekor i kulturës masive dhe pastaj Shef i Sektorit të Punës me Librin në Ministrinë e Arsimit. Aty veçoj për përgatitje me nivel të lartë të materialeve të asaj ministrie dhe të instancave të larta. Puna i eci mirë dhe për rezultate e arritje të mira u dekorua, gëzoi respekt, mandej dhe u zgjodh edhe në detyra të tjera drejtuese partie në atë digaster.

Me insistimin e drejtorit të shtëpisë Botuese, Thanas Leci dhe ndihmës që dha Haxhi Lleshi u rikthye, pas dënimit, në këtë institucion, ku punoi derisa doli në pension. Atje ai u dallua për punë të mirë, veçanërisht si redaktor i disa botimeve. Gjithashtu punoi me autor të shquar si Steros Spase, Ali Abdihoxha, Sulejman Krasniqi, Teudor Laço e shumë të tjerë duke lënë mbresat më të mira.

Që nga viti 1991 është pensionist dinnjitoz që ndonëse shëndetlig, aktivizohet dhe jep ndihmesën e tij të vyer në këtë komunitet.

Ndaj me të pranishmit, në jubileun e 80-vjetorit të lindjes së tij bashkohet edhe urimi i gjithë anëtarëvet të shoqatës "Bashkimi i Përgjithshëm i Pensionistëve të Shqipërisë" : "Rrofsh sa më gjatë Zenel Sula, me shëndet të mirë dhe lumturi familjare!"

Faik Xhani

"RRUGA E ARBERIT"

merr kopjen tënde

eshte koha per tu pajtuar...
telefono: (04) 22 33 283

Rruga Arbërit nr. 67

Reportazh nga Mynihu, aty ku Ismail Keta shpallet kampion bote në Taiboks

Një titull për të gjithë shqiptarët...!

Nga **DEFRIM METHASANI**

Arena Cirkus, kjo qendër e madhe dhe nga më interesantet sportive në Mynih, ka qenë arena e një sporti të fortë dhe luftarak, si taiboksi, që zbuloi më së fundi edhe një kampion bote nga Shqipëria. Interesimi i medias vendëse dhe asaj shqiptare, në fakt ka nisur ditë më parë, kur dy protagonistët e titullit më të lartë në këtë sport, Jozef Diklouni dhe shqiptarit nga Bulqiza Ismail Keta, kanë dalë para gazetarëve duke treguar ambiciet dhe përgatitjet e tyre. Ismail Keta ose Xhoni, siç njihet në Gjermani, është rikthyer pas shtatë vjetësh në ring si sportist, me të vetmin qëllim, të dalë kampion bote dhe këtë t'ua dedikojë të gjithë shqiptarëve kudo që jetojnë. Ai u është përgjigjur të gjitha pyetjeve, duke thënë se vlerësonte Gjermaninë, vendin ku u bë sportist dhe u afirmua në këtë sport, por në mënyrë të veçantë atdheun e tij, aty ku ka fëmijërinë, prindërit, gjyshërit dhe gjithë njerëzit e tij, mbi të gjitha simbolet kombëtare, për të cilat ndjehet vërtetë krenar. Dhe kjo ditë ka ardhur, në një mbrëmje që vështirë të harrohet, kur mendon atë emocion që pushtoi një amfiteatër sportiv në një mbrëmje gala, ku organizatorët e kishin pagëzuar me emrin: "Keta frigen gala". Në formën e një spektakli, televizioni më i madh jo publik në Gjermani, Sat 1, kishte sjellë para spektatorëve të shumtë, mes të cilëve edhe mjaft shqiptarë, një natë sa sportive, aq edhe argëtuese, për të thyer sadopak atë egërsi të një sporti, si Kik dhe Taiboksi, që është bukur ta shohësh, por vështirë ta bësh… Fillimisht në ring janë ngjitur sportistë të peshave të vogla dhe të mesme. Ndër të shumtët konkurrentë nga vende të ndryshme të botës, si Turqi, Holandë, vendet afrikane, katër prej tyre ishin shqiptarë. Njëri prej tyre që bëri vërtet mrekullinë, ishte Ferit Keta, kushëriri i Ismail Ketës, që fitoi bindshëm, duke merituar duartrokitjet e publikut dhe duke treguar se së shpejti ky sportist mund të jetë një kampion i madh. Më pas ka ardhur magjia e kësaj mbrëmje, stari për të cilin media kish folur prej kohesëh. Xhoni Keta, siç njihet Ismaili atje. Dalja e tij në publikun e shumtë, kthehet në një emocion të paparë, ashtu si vetë ai din të përcjellë te njerëzit mesazhin e të fortit dhe fituesit, mesazhin e një shqiptari të vërtetë. Me dorën që lëvizte hera-herës, dukej se kërkonte të nxitonte drejt ringut dhe sikur i hanin duart për të rrëmbyer sa më shpejt gjerdanin e artë të kampionit. Himni gjerman është shoqëruar me brohoritje edhe nga qindra shqiptarë të pranishëm, që valëvisnin flamurin tonë kombëtar. Një mbrëmje për t'u mbajtur mend, që nis madhërisht, bukur dhe këndshëm, nga një fitues i lindur si Ismaili, që përballë ka kampionin e Europës, hungarezin 32 vjeçar Jozef Dikouni. Grushtet dhe goditjet me këmbë të tij, janë si një breshëri automatiku. Dëmtimi në hundë, pasi kish kaluar një operacion të vështirë e detyron kampionin të mbrohet mirë në kokë dhe të godasë nga poshtë, një taktikë perfekte që e ndihmoi drejt fitores. Epërsia krijohet që në raundin e parë… Por pas pushimit në këtë raund, nis beteja e vërtetë në ring. Tashmë demi, që thirret nga gjermanët, nuk mbahet dhe kundërshtari bëhet tabelë qitje, sidomos në pjesën më të dobët, tek këmbët, duke e detyruar hera-herës të rrëzohet në tokë… Dhe jo pak, por tre herë, ai pas goditjeve të njëpasnjëshme të Ketës, bie në tapet përdhe si një qenie për ta mëshiruar… Bisha nuk ndalet, por vazhdon serinë e goditjeve të tjera, tashmë një tërmet i fuqishëm shpërthen mbi hungarezin, që pranoi këtë sfidë, pasi kundërshtari tjetër rus, më parë ishte tërhequr... Dhe vjen raundi i tretë, që të duket se akoma pa nisur, mbaron. Goditja rrufe e Ketës ka hedhur nokaut hungarezin, që do t'i duhet kohë për t'u ngritur më pas kësaj rënie, por një kohë, që nuk ka vlerë më për ndeshje, pasi Ismail Keta është fitues i kësaj finaleje dhe meriton me mund, djersë dhe sakrificë titullin më të madh, kampion bote, titull që i mungonte një shqiptari në këtë sport. Një arritje dhe triumf vërtet historik. Pas vendosjes së gjerdanit të artë, Keta ka punë me gazetarët që nuk rreshtin së marri në intervista. Tashmë grupit të xhirimit të TVSH-së i duhet të marrë moment gëzimi dhe entuziazmi, sepse të pranishëm janë edhe miq specialë nga Shqipëria, si kryeakademiku i Shkecave, prof. Gudar Beqiraj, dekani i universitet të sporteve Mehmet Spahiu, drejtori i programeve në TVSh, Bajram Hoxha, ish portieri i kombëtares sonë Perlat Musta, gazetarja e mirënjohur Tefta Radi, si dhe mjaft figura të spikatura, të pranishëm në këtë moment sa sportiv, aq edhe historik. Pas kësaj fitoreje janë shprehur trajneri që stërviti Ketën dhe presidenti i federatës gjermane. Sipas trajnerit, Melvin Matllov, disa herë kampion bote në peshën e rëndë dhe një nga tetë sportistët më të famshëm, Keta për të është një sportist i lindur për të fituar. Përgatitja e tij ishte mjaft serioze dhe isha i bindur që ai do të fitonte këtë ndeshje. Me këtë ai tregoi se nuk duhet të ndahet nga sporti, por paralelisht, të vazhdojë karrierën si sportist dhe si trajner ku është mjaft i suksesshëm.

Ndërkaq që për presidentin e federatës gjermane të tajboksit, Detlev Tyrnau, Keta është modeli i sportistit dhe njeriut. Falë karakterit dhe sedrës sportive, ai arriti deri këtu. I kisha thënë që duhet të rikthehesh në ring, sepse e kuptoja që kishte shumë energji brenda tij, por edhe cilësi të guximit dhe sedrës së shqiptarit njerëz dhe sport të tillë edhe ne si federatë duhet të ndjehemi krenarë, sepse Xhoni është një vlerë e pazëvendësueshme.

Por me lot në sy, është shprehur edhe akademiku dhe njeriu pasionant i sportit, Prof.dr Gudar Beqiraj, që vlerëson këtë arritje, si një pikë kulminante e ngritjes së vlerave kombëtare në një vend si Gjermania dhe përmes saj kudo në botë. Me nota shumë optimiste është shprehur edhe dekani i sporteve në universitetin e Tiranës, Mehmet Spahiu, që e cilëson tashmë Ketën një figurë shumë të respektuar jo vetëm sportive, por edhe kombëtare. Rikthehemi edhe njëherë në ring, në këtë arenë që tregoi me gisht një fitues të madh bote, që ka emrin e një djali nga Bulqiza, që quhet Ismail Keta. Ai menjëherë pas ndeshjes është shprehur se këtë titull ua dedikonte të gjithë shqiptarëve kudo që jetojnë. Kështu shprehej edhe kur e pyesnin gazetarët gjermanë dhe ata të huaj.

Ismail keta është kampioni që tashmë duhet të respektohet edhe nga vetë gjermanët, me të cilët ndau mrekullinë dhe gëzimin e kësaj mbrëmje që kishte emrin e tij, këtë emër që vështirë të harrohet kollaj, tashmë si kampion bote, kësaj here për Gjermaninë, por së shpejti me emrin e Shqipërisë…

sportiv

Historia e panjohur e një shqiptarit nga Luznia, kampioni bote në keç

Akim Manuka, kampioni që jeton dhe nuk njihet…!

Nga **DEFRIM METHASANI**

Akim Manuka ishte kthyer në një përbindësh që dhuronte spektakël, garë dhe mjeshtëri. Ai ishte bërë personazhi i kohës në sport, por prapaskenat e menaxherëve dhe drejtuesve të sportit shkelën mbi djersën dhe historinë e tij, që u mbyll më shpejt se meritonte ky kampion i madh. Më pas ai rikthehet në Belgjikë, ku vazhdon jetën e tij edhe sot e kësaj dite, tashmë duke u bërë vetë organizator i mbrëmjeve spektakël të keçit në lokalet më të mëdha të Brukselit.



Një histori vërtetë interesante, rrënqethëse dhe të duket disi e pabesueshme. Njihet si Akim Manuka, por realisht emri i tij është Hysni. Prejardhja i takon fshatit Luzni të Dibrës, ndërsa aktualisht jeton në Belgjikë. Në vitin 1972 ai shpallet kampion bote në keç në peshën e rëndë dhe që asokohe fitoi shumë famë, duke u bërë një nga mjeshtrit e mbrëmjeve interesante në Bruksel, qytetin ku jeton prej shumë e shumë vitesh. Jeta e tij është e mbushur me ngjarje dhe episode të shumta, mes shkëlqimit, suksesit, prapaskenave dhe halleve të dikurshme. Një patriot që zemra i rreh për atdheun e tij, ashtu si babai i tij Demir Manuka, që nuk jeton, por njihej si një atdhetar i shquar në vite. Pas vitit 1950, familja Manuka arratiset, sepse ishte në kundërshtim me regjimin komunist të asaj kohe. Për afro 15 vjet jetojnë në Maqedoni ose ish Jugosllavi që quhej atëherë. Aty vërtetë kalojnë një jetë plot peripeci, madje kampioni i ardhshëm i botës, punonte në një fermë me panxhar. Pronari, një pasionat i mundjes, organizonte shpesh ndeshje mes djemsh të fortë dhe fituesi meritonte si shpërblim një kavanoz reçel, që ai ia dërgonte nënës për të kaluar një vakt bashkë me familjen e tij. Ky sukses e shoqëronte atë të gjitha ditët e javës, sepse fitonte ndeshjen dhe bashkë me të, fitonte edhe kavanozin e reçelit. Më pas familja ikën nga Maqedonia dhe sistemohet në Belgjikë. Këtu, falë cilësive të tij, ai nis punën në një disko, si ruajtës i qetësisë, falë edhe trupit që filloi t'i bëhej edhe më i bukur dhe muskuloz. Hysniu ishte trim dhe i vendosur. Ai guxonte të ndeshej me çdo lloj kundërshtari. Në një mbrëmje, në një nga lokalet që merreshin me organizime të lojës së keçit, kampioni i skenës kërkon një sfidant nga salla. Hysniu del dhe fiton këtë duel, duke lënë shtangur të gjithë të pranishmit. Që atë mbrëmje ai merr zemër, por tashmë fatin e tij e kishin në dorë menaxheret, që iu vërsulën si shushunja, pasi panë një "peshk" të madh. Një nga shqetësimet e menaxherëve, që më së shumti ishin amerikanë dhe kroatë, ishte emri i tij. Për të rritur marketingun e tij në media, ata vendosën që të ndërrojnë emrin e tij. Por këmbëngulja e të atit ishte tejet e madhe. Demiri, babai i tij, nuk pranonte edhe pse i ofroheshin shuma të mëdha. Tashmë në Bruksel ai ishte një lider në këtë sport dhe ethet për kampion bote kishin nisur. Por kërkohej kjo marrëveshje e emrit. Me shumë vështirësi u gjet një emërues i përbashkët, që të ishte emri Akim, një hero i një filmi vizatimor në xhungël, që Hysniu e vendosi vetë, pasi menaxherët donin emër jugosllav. Me ndryshimin e emrit nis një histori e re. Falë stërvitjes dhe egos së tij, një mbrëmje e bukur e gjeti atë në SHBA, ku jetoi 3 vjet. Pas shumë garave dhe shfaqjeve brilante vjen edhe dita e titullit kampion bote. Ai kishte sfiduar më parë emra të mëdhenj të botës, si Mauel Soto, Kauzo, Rivera, Evans, etj. Shqiptari, që pakkush e njihte si të tillë, bën famë të madhe dhe pushton faqet e gazetave të asaj kohe. Ishte viti 1972. Por fakti që ai kurrë nuk e mohonte origjinën e tij i prish shumë punë. Në një mbrëmje, kur ai fitonte një tjetër finale të madhe, stafi i tij i bën një lojë të habitshme. Katër vajza jugosllave caktohen nga organizatorët që t'i dërgonin lulet në ring kampionit Manuka dhe këtë fitore t'ia faturonin Jugosllavisë. Madje, njëra prej vajzave bie në dashuri me djaloshin shqiptar, i cili pa e ditur nga ishte ajo, pranon ftesën e saj të ndjenjës. Që nga ajo ditë ai u martua dhe jetoi për 25 vjet me vajzën kroate, që e mori për grua dhe lindi 3 fëmijë. Komentatori në ring e quajti Manukën kampionin e luleve, sepse ai, kur mësoi se nga i vinin lulet dhe qëllimin e keq të menaxherëve dhe stafit, nuk e pranoi këtë fitore për hir të ndjenjës patriotike që kishte, por pranoi vetëm lulet, sepse nuk e dinte adresën e tyre nga ishin. Një tjetër mbrëmje e jashtëzakonshme në karrierën e tij ka qenë ndeshja në Montreal të Kanadasë, kur ndeshej dhe fitonte përballë luanit tjetër, Eduardo Karpentier dhe fotot e kësaj ndeshje do të hapnin faqet e gazetave të kohës. Akim Manuka ishte kthyer në një përbindësh që dhuronte spektakël, garë dhe mjeshtëri. Ai ishte bërë personazhi i kohës në sport, por prapaskenat e menaxherëve dhe drejtuesve të sportit shkelën mbi djersën dhe historinë e tij, që u mbyll më shpejt se meritonte ky kampion i madh. Më pas ai rikthehet në Belgjikë, ku vazhdon jetën e tij edhe sot e kësaj dite, tashmë duke u bërë vetë organizator i mbrëmjeve spektakël të keçit në lokalet më të mëdha të Brukselit. Ai njihet nga të gjithë, si një prej specialistëve dhe njerëzve më të shquar, por edhe organizatorëve të rrallë, që zbulon talente të tilla në një sport që në Belgjikë është kthyer në kult. Rreth të 70-tave, me një trup që mbahet mjaft mirë, kur e sheh sot, pakkush e beson që pikërisht ky njeri bënte ligjin në vitet '70 në sportin e keçit në gjithë botën.

Një histori vërtet interesante, por që do të zbulohet pak ditë më pas, kur ai do të bëjë vizitën e tij në Shqipëri dhe do të rrëfejë një jetë misterioze, si një kampion i shpallur dhe i panjohur nga vetë bashkëkombësit e tij, që ai i don me gjithë shpirt…

Mr AKIM MANUKA et EDOUARD CARPENTIER
Combat du Championnat du Monde Poids Lourd
Montréal - Canada

"Nëpërmjet fondeve evropiane në Dibër të Madhe do të arrijë një grup prej 12 të rinjësh nga shkollat e mesme të Normandisë që do të qëndrojnë 10 ditë, me ç'rast do të shoqërohen moshatarët e tyre, ku do të diskutohet për jetën rinore, perspektivat e të rinjve".

Delegacioni nga Dibra e Madhe vizitoi Francën

Bashkëpunim dhe shkëmbim përvojash

Ukthye nga Franca delegacioni nga Dibra e Madhe i kryesuar nga Argëtim Fida, kryetar i komunës Dibra e Madhe, Petrit Imami, kryesues i KK dhe Selim Beqiri, kryetar i komisionit për financa dhe urbanizëm.

Argëtim Fida, lidhur me këtë vizitë para gazetarëve, deklaroi se, "Në bazë të bashkërendimeve paraprake sëbashku dhe Memorandumit për bashkëpunim që nënshkruam në vitin 2008 mes Komunës së Dibrës dhe Komunës If në Normandinë e Poshtme të Francës. Aktivitet i nisur nga Qeveria e Maqedonisë, Ministria e Pushtetit vendor dhe Rajoni i Normandisë së Poshtme në Francë, Disa komuna nga Maqedonia nisën procedurën e bashkëpunimit me komunat e këtij rajoni. Mes këtyre komunave ishte edhe Komuna Dibra e Madhe, e cila nënshkruajti memorandumin me Kominën e IF-it. Pas nënshkrimit të memorandumit patëm disa shkëmbime komunikimi për njohje të ndërsjellë dhe vizita në nivel të kryetarëve të këtyre dy komunave në forma delegacionesh. Ky bashkëpunim u shtri edhe në nivel të OJQ-ve. Klubi i Fotografëve "If Imazh" nga Ifi vizitoi Dibrën e Madhe me ç'rast ata bënë fotografi dhe shfaqën një ekspozitë fotografish në Kaen, kryeqytetin e Normandisë së Poshtme dhe në Komunën e If-it, ku paraqitën bukuritë dhe pejsazhet e Dibrës së Madhe. Në Festivalin e sivjemë të Teatrit në Dibër të madhe, erdhën mysafirë një regjisor dhe dy aktorë nga Teatri i If-it, si edhe një grup këngëtaresh nga Normandia e Poshtme, që para publikut dibran u paraqit me një spektër këngësh të bukura.

Vizita e përfaqësuesve të OJQ-ve nga Dibra e Madhe në Komunën If ishte mundësi për shkëmbimin e përvojave me shoqatat simotra të atjeshme për të aplikuar bashkarisht në projektet e BE për shkëmbime rinore",

Në këtë kuadër, u shpreh Fida, " ne si kryetarë komunash vendosën se ia vlen trë nënshkruajmë edhe një kontratë- marrëveshje për bashkëpunim trevjeçar mes dy komunave tona, ku në mënyrë të ndërsjellë kemi marë obligimet për tri vitet e ardhëshme. Për këtë qëllim më 9 nëntor të këtij viti në sallën " Fransoa Miteran ' në If, në praninë e Zhan Pol Goshar, kryetar i Komunës If, të gjithë këshilltarëve, udhëheqësve të administratës së Komunës IF, ku ishin të pranishëm Argëtim Fida, kryetar i Komunës Dibra e Madhe, Petrit Imami, kryesues i KK dhe Selim Beqiri kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Urbanizëm, u nënshkruajt kontrata për bashkëpunim në tre vitet e ardhëshme. Ky bashkëpunim do të jetë në tri sfera. Në shkëmbimet mes rinisë dhe shoqatave qytetare, në shkëmbimet e përvojave për projektet e kulturës dhe për zhvillim të qëndrueshëm.

Duke folur për zhvillimet e mëtejme, Fida, shtoi se, " Në këtë drejtim ekspertë nga Dibra e Madhe do ta vizitojnë Komunën If dhe rajonin e Normandisë, për tu njohur me zhvillimin e qëndrueshëm, përkatësisht si funksionojnë ndërmarjet komunale, si menaxhohet me mbeturinat, si zbatohet procesi i riciklimit, mbrojtja e ambientit jetësor, shfrytëzimi i resurseve natyrore, si edhe për tu njohur me përvojat e tyre në turizmin kulturor. Me që dy komunat tona janë edhe qytete universitare, Dibra e Madhe me degët e gjuhëve të huaja dhe me Degën e Fizioterapisë, ndërsa If me Degët e Informatikës, telekomiunikacionit dhe shkencat precise. Do të informohen dhe do të kenë bashkëpunim të ndërsjellë për mundësitë banjore e rekreative dhe bukuritë e Dibrës, që viteve të ardhshme mund të arrijnë turistë nga Franca. në Dibër të Madhe për t'i shijuar këto begati, Hotelierët dibranë do të kenë mundësinë që t'i vijojnë kurset e trajnimit në shkollën e mesme më moderne profesionale të hotelierisë e kuzhinierisë në If. Ky bashkëpunim është i frytshëm për dy komunat. Nikoqirët nga Franca shprehën gatishmëri për tu njofttuar me tendencat tona për demokrtizim edhe nëpërmjet "Forumeve në Bashkësi" për krijimin dhe shpenzimin transparent të buxhetit, në funksion të resurseve publike që disponojmë në përmirësim të jetës së qytetarëve".

Rol me rëndësi, theksoi Fida, " do të ketë shkëmbimi i ndërsjellë i vizitave të të rinjve. Nëpërmjet fondeve evropiane në Dibër të Madhe do të arrijë një grup prej 12 të rinjësh nga shkollat e mesme të Normandisë që do të qëndrojnë 10 ditë, me ç'rast do të shoqërohen moshatarët e tyre, ku do të diskutohet për jetën rinore, perspektivat e të rinjve. Pas kësaj një grup i gjimnazistëve dibranë do ta vizitojë Normandinë për tu njohur me aktivitetet dhe jetën rinore në Francë. Në Festivalin e Teatrit në Dibër të Madhe vitin që vjen do të merr pjesë edhe një Teatër nga If-i, ndërsa SHKA "Haki Stërmilli" do të shkojë me një grup folkloric në IF. Këtu është shumë i rëndësishëm edhe aplikimi i përbashkët te fondet evropiane, ku 80 përqind e mjeteve për këto aktivitete mbulohen nga BE. Kjo do tu ndihmojë që të rinjvë tanë të hartojnë projekte dhe të aplikojnë sëbashku, duke e ndje veten si pjesë e Evropës., sepse kështu edhe Evropa mund të vjen mes nesh", than ë fund kryetari Argëtim Fida.

Rexhep TORTE

PREZANTOHET LIBRI "DINJITET PËRBALLË INTRIGËS"

Ditën e premte, më 4 nëntor 2011, në sallën e Teatrit të Operave dhe Baletit në kryeqytet u mblodhën në këtë promovim më shumë se 200 pjesëmarrës, fugura të shqura të penës, të artit e të kulturës, personalitete të larta të fushës së arsimit, jurispondencës, politikës e të gazetarisë, të ciltë recensuan e diskutuan rreth vlerave të librit "Dinjitet përballë intrigës" të autorëve FaikXhani e Ilmi Dervishi.

Si nga referuesit ashtu edhe nga diskutantët u vu në dukje:

Libri "Dinjitet përballë intrigës" është një libër i thjeshtë e modest që i kushtohet një njeriu që çau sfidat e jetës dhe mundi të mposht intrigat e regjimit komunist dhe njerëzve servilë e intrigantë. Ai është Shaban Dervishi nga Lugjejt e Zall-Dardhës së Dibrës. Në faqet e këtij libri përcillet jeta dhe kontributi i këtij njeriu që nga fëmijëria si yzmeqar në dyerët e pasanikëve të Tiranës e derisa arrin të bëhet një kuadër i zot, me emër e me zë. Libri jep me hollësi dëshmi e fakte arkivore e memoristike për intrigat, thashethemet, sajesat e kurthet që i ngritën njerëz smirëxhinj, kuadro pa nivel e dashakeqës deri në strukturat më të larta të partisë Shaban Dervishit. Ky njeri i ndershëm, i përkushtuar dhe i pastër nuk pranoi kurrë të paqenat e akuzat, punoi si më mirë, gëzoi respekt e mirënjohje nga gjithë ajo trevë dhe kudo që punoi e shërbeu. Këmbëngulja, vullneti i pathyeshëm dhe e drejta e tij bënë që gjërat të sqarohen e të shkojnë në hullinë e duhur, por Shabani dhe familja e tij u stërmunduan, vuajtën tmerrësisht, psikologjikisht, por edhe ekonomikisht. Disa prej tyre humbën të drejtën e shkollimit e të ecjes përpara megjithëatë nuk u dhanë, nuk u përkulën dhe i përballuan me dinjitet jetës.

Personazhi kryesor i librit është Shaban Dervishi i Lugjejve të Dibrës. Ai është modeli i njeriut të pastër, të pakompromete ushëm, besnik i idealeve, i devotshëm e i gatshëm për të bërë gjithçka për të mirën e vetes, familjes, popullit dhe kombit.

E rëndësishme është, se libri është pasuruar me shumë materiale arkivore, të cilët i japin frymëmarrje, besueshmeri, seriozitet dhe vlera.

Për vlerat ideo-artistike të këtij libri referuan potesha Fatime Kulli, studiesit e publicistët Velo cfarku e Mevlud Buci. Gjithashtu mendime me vlerë dhanë edhe prof. Nuri Abdiu, drejtuesit e shoqatave joqeveritare si Servet Tartari, Kujtim Çerpja, Agron Gjedia, Enver Hasa, Miftar Fana, Rustem Pira, Hysen Dervishi, Agim Marqeshi etj.

Autori Faik Xhani si dhe personazhi kryesor i librit Shaban Dervishi përshëndetën pjesëmarrësit si dhe referuesit për vlerësimet e përfundimet që sollën për vlerat e librit.

Përshëndetje dhe vlerësim të veçantë pati për djalin e talenuar, me fantazi të mrekullueshme e me një cilësi të lartë bouese Bujar Karoshin. Ai së bashku me stafin e tij është bërë një nga modelet më të mirë të botimit dhe përhapjes së librit në Shqipëri.

Hijeshinë dhe bukurinë këij tubimi promovues ia shtoi prezantimi i spikatur nga gazetari i mirënjohur i RTSH, z. Dëfrim Methasani si dhe këngëtarët e mirënjohur dibranë Lirie Rasha. Qerim Sula e Sherif Dervishi.

Nën tingujt e bukur të këngës së Hajredin Pashës dhe dhurimin e tufave me lule z. Shaban Dervishi dhe autorëve Faik Xhani e Ilmi Dervishi u mbyll ky aktivitet shum pikant dhe mbresëlënës.

/Abdulla Dushku

PREZANTOHET BOTIMI I RI I VENKA CAPES

Një libër me vlera artistike

Këto ditë, të fundit të nëntorit, në një nga sallate Muzeut Historik Kombëtar u bë promovimi i librit me poezi "Prek me frymë" te poetes nga Stebleva Venka Capa. Me një pjesëmarrje dinjitoze në fjalën e hapjes nga poetja Fatime Kulli, njëkohësisht dhe redaktorja e librit, foli në detaje për librin "Prek me frymë" për poezitë e saj sa të ndjera aq dhe prekëse, me një përkushtim për të sjellë të lexuesi me sa më shumë emocione e të besueshme. Për librin foli dhe prof. Murat Gecaj, i cili vuri në dukje disa nga vlerat e poezisë së poetes, Venka Capa.

Në këtë takim foli dhe bashkëfshatari i saj, studiuesi dhe ish kryeredaktori i gazetës "Ushtima e Maleve" Velo Cfarku.

Edhe shkrimtari Kolec Tarabani, foli për vlerat ideo-artistike të librit ndërsa shkrimtari Albert Zholi u ndal në tematikën e poezive të këtij libri, duke e përgëzuar autoren për temat sociale, e cila i trajton në poezitë e saj. Me mjaft interes u prit edhe fjala e poetes Ilirjana Sulkuqi e cila foli jo vetëm për librin e poezitë, por dhe për Venkës si njeri, që ndonëse me aftësi të kufizuara, gjen forcën dhe guximin të jetojë jetën me dinjitet.

Me mjaft emocion është edhe diskutimi i poetes nga Mati Adivie Hoxha, që posaçërisht kishte ardhur nga Durrësi që duke qenë pjesë e komitetit me aftësi të kufizuara, me karrocën e saj u ngjit në katin e dytë të Muzeut Historik Kombëtar. Në fund të takimit me emocionet e herës së parë foli dhe falënderoi edhe autorja, pastaj u dhanë libra me autograf nga poetja Venka Capa me urimin për t'u takuar sërish në takime të tilla, me krijimtari të re.

Ilmi Dervishi

Në lirizmin e 70 poezive të këtij vëllimi, dallohet qartë mendime origjinale që përshkohet nga një shqetësim i natyrshëm i një vajze me probleme shëndetësore, por që ka guximin të ecë e sigurtë në radhën e bashkëmoshtarëve, e motivuar nga bukuritë e kësaj jete

festa

Vetëm arsimimi i shqiptarëve do ti bëjë shqiptarët faktor paqeje dhe stabiliteti në Ballkan dhe do ta qepë hartën e trojeve etnike Iliro- Shqiptare!

Legjenda e flamurit nga gjimnazistët e Maqellarës

Nga **ZAMIRA GJELESHI**

Fusha dhe malet nuk na mungojnë, të paktën natyra ka qenë bujare dhe zemërgjerë me shqiptarët, veçanërisht me ne të Maqellarës. Këtu në këtë provincë të presin bjeshkatarët e Gjimnazit të Maqellarës në këtë fund tetori. E diela e fundit e tetorit është Dita e Bjeshkatarëve të Ballkanit.

Grupi ynë si gjithmonë tenton të kap majat dhe t'i rikthehemi mënyrës së dikurshme të jetës: të pish ujë në gjurmët e kafshëve, të hash bukë rreth zjarrit, të shtrihesh në borë, ndoshta të mbash ndër dhëmbë një fije bari janë ushtrime mendore, që çlirojnë trurin dhe trupin.

Të dëgjosh insektet kur zukasin, të ngjitesh këmba dorës apo me kalë, të mundësh të kapësh kokrrat e thanës, boronicës apo dëllinjës…

Me pak fjalë të mundohesh të shijosh çdo detaj të kësaj pamje piktoreske.

Bjeshka është një nga vendet ideale për të vizituar në këtë fundstinë. Ylli i mëngjesit nuk kishte ikur kur ne u nisëm.Për shkak të mjegullës na u desh më shumë kohë nga sa kishim parashikuar.

Oh, sa mirëështë të nisesh herët, pasi ajri i mëngjesit çliron mendjen nga mendimet dhe të parapërgatit për disa orë të qeta.

Radomira është një shenjë e mirë për të treguar drejtimin. Shkëmbyem përshëndetje të përzemërta dhe bujare me njerëzit e fshatit,veçanërisht me Haxhi Himën edhe pse takoheshim për herë të parë dhe ishim vizitorë të rrallë ai na e lehtësoi udhëtimin. Flladi i bjeshkëve dhe rrezet e para të Diellit na gjetën mes majave Moravë-Portë e Korabit-Korab.

Drejtimi që morrëm ndoshta qe rruga më e mirë. Ora 10 e paradites dhe ne ishim atje , ku koha shqiptaro-ballkanase prek qiellin, Korab 2751m.

Lule manushaqe me vesën mbi petale…

Nuk e mbaj mend mirë ku kam lexuar se manushaqja u dhurohej mbretërve dhe mbretëreshave për të treguar respekt dhe dashuri.

Një mjegull mbuloi majën, duke më rikthyer në legjendën e Rozafës, Ciklin e kreshnikëve,borëbardhat, shtojzavallet rreth bredhash vallëzojnë,…bilbili i Mjedës këndon,

…Shqipja e Alpeve na përshëndeste me fluturimin kryq e tërthor hapësirës, ndërsa ne vendosnim flamurin kuq e zi mbi Korab.

…era sjell ligjërimet e Nënës Ilire…

…Të më duash Ilirinë bir, të më duash gjuhën , zakonet, flamurin,…

Eh sot mbi Korab një legjendë mijëvjeçare të harruar po përjetojmë…

…diku në thellësi të shekujve mall i largët po na fton.

Larg mërgon mendimi im!

Një krismë, të tjera po dëgjoj matanë bjeshkës, shpërthime, mostra të paparë…

…mes mjegullës zbulojmë legjendën e harruar…

Në çdo fillim pranvere , në majat e larta të Alpeve tona, banorët e atyre maleve dalin bashkë me bagëtitë e tyre në bjeshkë për të filluar verimin e mirë, …

Mirëpo kur njerëzit dalin në bjeshkë, trimat kontrollonin majat e maleve për ndonjë rrezik,shembje mali, katastrofa natyrore,…

Trimat përveç kontrollit të gjendjes së natyrës së gjendjes së bjeshkëve, si kontroll kryesor kishin vëzhgimin e territorit tokësor Iliro-Shqiptar…

…se mos ndonjë ushtri e huaj është afruar me çadrat e veta diku rreth trojeve tona dhe po pregatiste ndonjë luftë tinzare…

Njëherë një trim i ri ndodhej në majën e bjeshkëve tona në fillimin e pranverës së hershme . Ai kishte marrë detyrën prej më të vjetërve për të dalë atë ditë për vëzhgim në majën më të lartë të malit, ku siç thonë të vjetrit:

" …as dhia e egër nuk ngjitej dot…"

Mirëpo atë ditë sa kishte dalë trimi në majëmali në anën tjetër po ngjiteshin tinëzisht disa njerëz të maskuar me helmetat e kohërave paraantike.

Trimi lëshoi kushtrimin me zërin e fortë duke thirrur sipas zakonit mijëvjeçar:

"O hiq kush trim moreeeeeeeee, se na ra armiku, o heeeeeeeeeeeejjjjjjjjj….!

Pa mbaruar mirë fjalët, një shigjetë e mprehtë i ra në gjoks dhe gjaku mbuloi trupin.

Trimi në pamundësi për të thirrur nxorri këmishën e gjakosur dhe e valëviste me fuqitë e fundit…

Ai po tunde këmishën në ajër në minutat e fundit të jetës së tij për të lajmëruar njerëzit e tij , të fisit e të krahinës, se një rrezik po u kanosej të gjithëve…

…në ato çaste vjen një shqiponjë malesh me dy kokë, e cila kishte folenë aty afër dhe ia rrëmben këmishën djalit me kthetra fluturon tri herë mbi trupin e tij dhe turret fluturim drejt staneve e njerëzve…

Shqiponja me këmishën ndër kthetra duke e shtrirë në erë në një valëvitje të dukshme….

Trimi ndjen në shpirt një çlirim, pasi në sekondat e fundit të jetës së tij u bind se shqiponja do ta valëviste gjatë në hapësirë dhe njerëzit do ta kuptonin se çfarë ka ngjarë…

Në atë lëvizje të shqiponjës këmisha u hap në ajër e gjakosur,ndërsa njerëzit e shihnin atë skenë të çuditshme. Nëna e djalit e lidhi ngjarjen më shpejt se çdokush tjetër dhe zemra e nënës klithi:

"…ajo është këmisha e tim biri more trima, muleni se ma paskan vrarë djalin…!"

….burrat e gjetën djalin në gërhammat e fundit duke mërmëritur:

"…armiku na ra…"

Shqiponja fluturonte në hapësirën e bjeshkëve me këmishën e gjakosur ndër kthetra…e lëshoi mbi stane…

Njerëzit e morrën ndër duar si shenjë nderimi dhe dhimbje për djalin e ri…

Ata prenë një dru të lartë pishe dhe evendosën në majë mali me këmishën e gjakosur të trimit që u vra në detyrë për të ruajtur trojet etnike Iliro-Shqiptaro.

Aty në majë mali varrosën dhe djalin e ri. Tek ai varr shkonin jo vetëm për të vëzhguar trojet Iliro-Shqiptare, por edhe për të kujtuar djalin, që u bë një i tërë me atë majë mali.

Ai u ngrit si shkëmbi i parë piramidal në legjendat e ruajtjes së trojeve e kufijve të vendeve e kombeve të ndryshëm.

…ajo këmishë vjetrrohej me kohën dhe zëvendësohej me këmisha të tjera të gjakosura me gjakun e kafshëve ….

…më vonë gjetën gjakun në shkëmbinjtë e maleve …

Sa herë vendosej këmisha e re shqiponja e vështronte duke e qarkuar me tre fluturime rreth shtyllës së lartë…si homazh hyjnor, që ajo gjallesë i bënte kujtimit të atij djali…

Të krijohej përshtypja që ajo shqiponjë e kish njohur atë djalë, e kish dashur aq shumë dhe në çastet e fundit i kish shkuar në ndihmë duke i marrë mesazhin e duke e dërguar në mënyrën e vet njerëzve të tij. Nga lartësitë ajo dha atë lajm, si një alarm gjithë njerëzve të vendit, që të mbronin veten dhe Atdheun…

E ëma e djalit ishte një plakë e humbur dhimbjesh e vajesh, ndaj u plak së tepërmi kur i biri i doli nga sytë. Ajo shkonte shpesh në atë majëmalitek varri i të birit për ta kujtuar, në shenjë dhimbje, malli dhe nderimi.

Sa herë vajtonte të birin me ligjërime, ajo shqiponjë dykrenare afrohej dhe zinte vend në majë të atij druri të lartë.

Nëna e djalit e shikonte shqiponjën me dhimbje , por edhe me mall e nderim për ndihmën që ajo i dha birit të saj…

Ajo qante me fjalë të birinnë vajet e saj letargjike:

"…bir,ti nuk je vetëm në këtë majëmali, Shqiponja që më solli lajmin e zi për ty, të rri ditë e natë mbi krye o bir,…ta ruan gjakun tënd në majëmali,…nuk e lë gjakun tënd ta shkelin armiqtë….Ajo është aq e dashur, aq e fortë, aq fisnike sa në majë-mali s'do të lejojë kurrë këmbë armiku.

Ti kurrë nuk do të mbetesh vetëm bir,… edhe kur nëna jote të vdesë Shqiponja dykrenare do të vijë gjithmonë tek gjaku yt…!"

...ndërsa nëna qante me ligjërime të birin , shqiponja fluturonte tre herë rreth majës së malit dhe pushonte mbi majën e drurit duke dëgjuar vajet e nënës për të birin….

Ajo nënë shqiptare mijëra vjet më parë e lidhi fatin e djalit të saj me atë shqiponjë, që i pati sjellë lajmin e zi…

Nëna lidhi detajet e ngjarjes me njëra – tjetrën, duke pasur një dashuri dhe dhimbje të madhe për të birin, ajo krijoi një dashuri për shqiponjën….

Nëna vendosi që në këmishën e gjakosur të qëndisë shqiponjën dykrenare me fijet e flokëve të saj të zi.

Pastaj e qëndiste në një copë të kuqe me krahët të hapur me përmasa sa gjerësia e krahëve të një burri dhe sa gjatësai nga qafa deri pak mbi gju…

Pasi e mbaroi ua dha trimave duke u thënë:

"Kështu do të bëhet gjithmonë dhe do të vendoset majave më të larta si kallzim për brezat se trojet mbrohen me gjak, me gjokset tona, si kallzim për armiqtë se nuk i lëshojmë majat e maleve tona pa derdhur gjakun tonë, gjakun që shqiponjat nuk na e lënë kurrë të humbasë, sepse ne dhe shqiponjat bashkëjetojmë në këto male.

Le të quhet jo më këmisha e trimit, por kraharori i trimit!

Le të shkëlqejë kraharori i trimit për jetë si shenjë trimërie dhe qëndrese!"

Ajo e qëndisi atë copë aq sa jetoi,pasi ndrroi jetë ajo nënë legjendare nënat dhe motrat shqiptare e qëndisën shekull pas shekulli atë, Kraharor trimi.

E qëndisën me flokët e tyre si shenjë kujtimi dhe besnikërie ndaj asaj ngjarjeje legjendare, ku zë fill ngritja e simbolit të qëndresës , ekzistencës, nderimit e të njohjes si popull e si komb Iliro-Shqiptar. Ata e qëndisën si simbol në gjoksore,pazmoret, xhamadanët që vishnin kur shkonin në beteja.

Prej asaj kohe kombi shqiptar u fut në konflikt me fqinjët ballkanas.

Më vonë filloi të organizohej në drejtime mbretërish e ushtrish të rregullta.

Shqiptarët vendosnin atë copë të kuqe me shqiponjën e zezë dykrenare në maja malesh, në kulla,në djepin e fëmijëve,në krye të karvanit të kruqve për marrjen e nuseve, në arkivolin e djemve të rënë për Atdhe."

Sot është fakt se shqiptarët nuk kanë pretenduar të grabisin apo kolonizojnë territore të huaja, por t'i rikthejnë territorret e veta nën sovranitetin dhe pavarësinë e Shqipërisë etnike.

Nuk është e vërtetë se Mitrovica është një çështje jashtëzakonisht komplekse. Kolonializimi serbomadh dhe grekomadh shekullor është një kompleks i pazgjidhur për Evropën e integruar demokratike, për OKB-në e reformuar në frymën e rendit të ri botëror dhe për diplomacinëshqiptare që të mos humb "ndihmat e përjetshme" të Evropës, Malit të Zi, Greqisë,Serbisë e Maqedonisë.

OKB,BE dhe diplomacia antibashkim shqiptare nuk mund të justifikojnë qëndrimin ndaj çështjes shqiptare me rrënjë shekullore në Ballkan.

Duke pasur parasysh që:

Gjermania dhe Franca u pajtuan pas një lufte njëmijëvjeçare, Gjermanët dhe polakët pas më shumë se një mijë vjet u bënë partner, është arritur një miqësi mes gjermanëve dhe izraelitëve pas masakrave të hebrenjve , atëherë konflikti i Ballkanit është më i lehtë.

Pa zgjidhjen e problemit kolonial të shqiptarëve në të gjitha hapësirat e Shqipërisë etnike, s'do të ketë paqe dhe bashkëpunim të qëndrueshëm në Ballkan.

Sot të rinjtë shqiptarë janë në maja malesh duke valëvitur flamurin shqiptar. Kësaj lëvizjeje gjithëshqiptare e vetëorganizuar i bashkohet dhe Gjimnazi i Maqellarës.

Sot në këtë përvjetor Gjimnazistët e Maqellarës po e gdhendin Legjendën e Flamurit në oborwrin e shkollës dhe një grup janë në majë të Kërçinit, që si plak i moçëm, si burrë i shkuar shtetit na vështron madhërisht si gjykatës i lashtë e tepër fanatik mbi pjesën e Tokës që zoti i dha për mbykqyrje për të vendosur Flamurin shqiptar si simbol lirie, qëndrese, njohje dhe autoktonie për shqiptarët në çdo kohë!

Vetëm arsimimi i shqiptarëve do ti bëjë shqiptarët faktor paqeje dhe stabiliteti në Ballkan dhe do ta qepë hartën e trojeve etnike Iliro- Shqiptare!

Rruga Arbërit nr. 67

tregim

Në foto: Autori. Ne sfond Çeliasi dhe fshati Blliçe

Në foto:
Autori. Ne sfond Çeliasi dhe fshati Blliçe

KËSULA

Nga **VESEL HOXHA***

NË VEND TË HYRJES

Në fundin e shtatorit të vitit 2010 më rastisi të punoja përballë vendlindjes time, në vendin e quajtur Çelias (një nga merat tona, kullotë e përbashkët e fshatit), të cilat lokalizohen midis fshatrave të Blliçes, Kastriotit dhe Rrenzit. Isha bashkë me kolegun e punës, profesorin Safet Dogjani, inxhinier gjeofizikant në profesion, që të dy punonjës shkencorë në Institutin e Gjeoshkencave, pranë Universitetit Politeknik te Tiranës. Do të bënim disa matje radiometrike. Me makinë kishim Inxhinierin kurajoz Ardian Minarollin. Nuk kishim probleme me shërbimin e transportit që na ofronte. Kjo, jo thjeshtë për faktin se është një njeri i rrahur me jetën, por kur shoferin e ke të zanatit, është një plus në punimet fushore gjeologjike. Ardiani futej me makinë edhe ne rrugë të vështira atje ku ne kishim nevojë, pa bërë asnjë fjalë, jo si disa të tjerë që ju dhimbset më shumë makina se njerëzit, duke e parë punën e tyre të shkëputur nga puna e gjeologëve apo gjeofizikantëve. Ardiani nuk ishte shofer, kishte ardhur me makinën e tij për të na ndihmuar dhe për të mësuar. Kishim ditë që një punë të tillë po e bënim në disa zona problematike të rrethit të Dibrës. Problemet e rrezatimeve në këto rajone kanë tërhequr vazhdimisht vëmendjen e gjeologëve dhe gjeofizikantëve. Ndaj i pata kërkuar disa herë profesor Safetit, për të ndërmarrë realizimin e disa punimeve fushore sa më shpejt të ishte e mundur, në zona ku nuk kishim bërë matje të tilla, për të ditur nivelin e radioaktivitetit në to. Atë ditë u nisëm herët në mëngjes nga Hotel Korabi i qytetit të Peshkopisë, ku ora 07 ^{00} na gjeti në Përruan e Veleshicës, aty ku lagin këmbët e mëdha e të thinjura në ujtin e ftohtë të saj, një nga pasuritë kolosale të rrethit të Dibrës dhe të gjithë Shqipërisë, Evaporitet (Gjipset) hijerënda e aq të njohura të daljes së Peshkopisë veriore.

INTERMEXO SHQËTËSUESE

Rajoni ku dalin në sipërfaqe Gjipset e Peshkopisë, nga Ilnica e Greva në jug e deri në Kullas e Radomirë në veri, së bashku me rajone të tjera të rrethit të Dibrës dhe atij të Kukësit (nga sa kemi dëgjuar kohët e fundit), janë propozuar për tu miratuar nga qeveria si Park Kombëtar. Ky propozim padyshim është bërë duke u nisur nga dëshira e mirë për të ruajtur natyrën në këto vise të nalta, të cilat për hirë të së vertetës janë vende mjaftë panoramike, me bukuri të rralla, me reliev tejet befasues si nga ana morfologjike ashtu dhe përbërja shkëmbore gjeologjike, me shumë gjeomonumente edhe të rëndësisë europiane (ku pesonalisht kam mbajtur edhe referime në konferenca ndërkombëtarë për promovimin e vlerave të tyre shkencore dhe turistike), me kullota alpine të konsiderueshme, me një florë të pasur, me zhvillim mesatar të drurëve pyjorë kryesisht të ahut, pishës, bredhit etj.. Shkurt, mund të jenë ndër vendet më të bukura të vendit tonë, për një mijë e një arsye. Këtë e bazoj dhe në njohjen time personale, pasi i kam shkelur dhe vazhdoj ti shkel me pëllëmbë ato lartësi hijerënda e të papërsëritshme me të cilat midis të tjerave, nuk ngopesh së shikuari. Por, kur thotë populli, "dardha e ka bishtin prapa". Në se, në këtë propozim janë perfshirë edhe zona me pasuri minerale metalore e jo metalore me mundësi shfrytëzimi për sot e në perspektiv, mendoj se firmat private vendase apo të huaja do të ndodhen para pengesave serioze në lidhje me marrjen e lejeve të shfrytëzimit, për ti vënë ato në qarkullim ekonomik, në të mirën e tyre, të krahinave ku ato do të shfrytëzohen dhe shtetit në tërësi. Në logjikën time kjo gjë duhet të ketë ndodhur nga pakujdesia, ndoshta nga mosnjohja e pasurive në rajonin e propozuar, mangësitë në legjislacion apo moskoordinimi ndërinstitucional etj. Sigurisht, këto janë probleme të qeverisë dhe ministrive të linjës, kësisoj u takon atyre ti zgjidhin këto përplasje në se ka, në kohën dhe momentin e duhur dhe sipas legjislacionit në fuqi. Këtu, desha të shpreh një shqetësim dhe të jap një opinion edhe pse nuk jam as i pari, as i fundit në këtë histori dhe as specialist i fushës. Punonjësit e shërbimit pyjor, me gjithë punën e madhe që kanë bërë në dekada, për shumë e shumë arsye nuk arritën ti mbrojnë si duhet pyjet e Lurës, të Selishtës etj., dhe shumë zonave të tjera afër dhe larg qytetit të Peshkopisë, ku pak plepa apo akacie mbetën pa u prerë, në disa periudha kritike, edhe në Luginën e Lumit Drini i Zi dhe në terracat e përrenjëve që derdhen në të, etj. Tani së fundmi, paskan propozuar parqe të reja, që të sigurojnë edhe pasuritë e tjera në anën lindore. Kjo s'ka asgjë të keqe në parim, përkundrazi, por nuk arsyetoj se duhet ta bazojmë mbrojtjen e natyrës duke shpallur parqe gjithandej, të cilat sipas përvojës shqiptare ngelen parqe në letër. Edhe Lura ishte dhe është Park Kombëtar por e dimë të gjithë se në ç'gjendje është. Në emër të të ashtuquajturës mbrojtje të mjedisit, po bëhet një zhurmë e madhe, duke i parë problemet të shkëputura, në mënyrë të njëanëshme, sikur bota e qytetëruar ku duam të integrohemi nuk i shfrytëzon pasuritë që i ka falur Zoti dhe, të njejtën gjë na rekomandojnë edhe neve. Ne të jetojmë duke shikuar natyrën e thithur ajrin e pastër të saj, pa na u dhënë mundësia që ti shijojmë e shfrytëzojmë të dyja, edhe "pulën e petasit", edhe pejsazhet e pyjet, edhe pasuritë mbitokësore e nëntokësore. Leja minerare e shfrytëzimit për një zonë të caktuar, është dhënë e jepet, vetëm me ligje e rregulla mjedisore nga agjensitë e tyre, dhe ato pyjore nga shërbimi përkatës nëpër rrethe a qarqe. Sidomos në dekadën e fundit, nuk jepet asnjë lloi leje minerare shfrytëzimi pa patur studime mjedisore të plota dhe leje nga pyjet, pa u futur në morinë e kërkesave të tjera të panumurta që në mënyrë taksative, detyron plotësimin ligji i ri në Sektorit Minerar në Republikën e Shqipërisë. Pyjet dhe kullotat i ruajnë vetë banorët e zonave, të interesuar e të ndërgjegjësuar për këtë punë. Shembuj të tillë ka dhe në Dibër, sidomos në Kala të Dodës. Ne nuk jemi kundër parqeve apo zonave të tilla dhe vendimeve që dalin në mbrojtje të tyre, duke financuar struktura përgjegjëse për mbrojten e tyre etj.. Kjo do të ishte një marrëzi të mëndonim dhe gjykonim kështu por, gjërat duhet të mendohen thellë e të propozohen mbi bazën e një studimi tërësor, pa penguar futjen e resurseve në qarkullim ekonomik, realizuar mbi një projekt kompleks, jo thjeshtë nga një propozim i "thatë", në se ka ndodhur kështu, i degëve të shërbimit pyjor apo agjensive përkatëse mjedisore nëpër rrethe a qarqe, që mund të prodhojë më shumë shkresa e ngatërresa se sa punësim, për të cilin është e interesuar gjithë shoqëria dhe strukturat qeverisëse në qendër e në bazë.

KUR TRAZOHEN KUJTIMET E FËMINISË

Nga Përroi i Veleshicës ku filluam punën, vazhduam me rradhë punimet në drejtim të Kubenit, me instrumentin e shtrenjtë që profesor Safeti e ruante dhe e mbante në duar, si një fëmijë të vogël, sa herë e futnim dhe e nxirrnim nga makina e Ardianit, për të bërë matjet e rradhës në formacionet gjeologjike që takonim rrugës. Erdhi dhe rradha e matjeve të zonës së fshatit tim. Rruga e re e asfaltuar e makinës pothuajse kalonte mespërmes vendit të quajtur Çelias ku do të bënim disa matje (rrugë e cila, për fat të keq i kishte "qëndruar besnik gjurmës së vjetër dhe urave te vjetra", pa bërë asnjë shkurtim, shmangie nga formacionet rreshqitëse gjeologjike apo për probleme të tjera inxhinierike, për tu çuditur, pasi qeveria u'a ka dhënë lekët qindarkë për qindarkë për ti marrë parasyshë të gjitha dhe për ta bërë në standarde europiane!?). Tek punonim përballë Tij, në formimet Siluriane (shkëmbinj kryesisht rreshporë të formuar para 250 milion vitesh, me karakter flishor), me reliev të butë, me një bimësi të imët që akoma e ruante ngjyrën jeshile, edhe pse dimri po trokiste, me disa shenja shumë të rralla të trungjeve të drurë frutorëve të mbijetuar nëpër terracat e hapura vite e vite më parë (në periudhën e të ashtuqujaturit socializëm) dhe tani, thuajse të prerë tërësisht, tek shikoja si nëpër legjenda gurët e mëdhenj të kuarciteve (lloi shkëmbi metamorfik, i fortë dhe shumë i vjetër) të shpërndarë nëpër Çelias, secilin me emër, që asokohe nuk dija gjë për këto, kurse atë ditë, në ato çaste, ndërtoja në mendje, historinë gjeologjike të tyre dhe arsyet pse ato gjendeshin pikërisht aty, më trazoheshin edhe shumë e shumë kujtime te fëminisë. Unë nuk jam ndonjë studiues i fushave të tilla të ndjenjave të holla shpirtërore që përjeton njeriu në të tilla raste, as shkrimtar e as poet, por lidhjen që kemi me vendlindjen, e ka shprehur dhe skalitur bukur në vargje (ose më të sakt do të ishte të shpreheshim, një variant të kësaj ndjesie apo lidhje të fuqishme që njeriu ka me të), i madhi Garcia Marquez:

Vendlindja ime,
Lot i përhershëm i zemrës time,
Mall i përhershëm i shpirtit tim,
Jastëk i përhershëm i ënderrave të mija.

Në gurin e kuarcitit pranë xhadesë, isha ulur e vështroja si i humbur fshatin më të bukur në botë, të mbuluar nga drurët frutorë, lisat e moçëm e plepat e gjatë, ato vise e troje të stërlashta, atë pllajë me emrin e vjetër Çelias, emër i lidhur ndoshta me kohën e perandorisë osmane, me zabele e me livadhe, me vorreza të mirëmbajtura në fund të fshatit, me një mikroreliev tërheqës, me lugina e kodra të rrumbullakosura e të pa aksidentuara, falë ndërtimit të tokës prej shkëmbinjëve rreshpor të butë paleozoike të përbërjes argjiloro-ranorike etj.. I shikoja dhe i mbaja mend të gjithë me emër si, Kodrën e Fërrës, Kodrën e Gjatë, Përruan e Lushit, Gurin e Dali Pekut, Gurin e Hajatit, Gurin e Rrafshes, vendin me emrin Lisi i Idrizit edhe pse lisi nuk është më, rrafshen me emrin Varvare, Gështenjat e Kastriotit, Kullën e Fikut, Përroin e Lushit, Livadhet e Çoçit, Përruan e Vneshtëve etj.etj.; më kujtoheshin me rradhë, si në një film dokumentar, me ndodhitë e pafundme të moshës me shokët e fëminisë, tek luanim gjithë ditën, më kujtoheshin edhe të moshuarit, çfarë nuk më kujtohej, tek ky jastëk i përhershëm i ëndrrave të mia. Në atë kohë truri nuk ngarkohej shumë si sot në "epokën dixhitale", me lloj lloj emisionesh televizive dhe kompjutera. As radio nuk kishte, pasi rryma elektrike erdhi në vitin 1971. Kësisoj, rregjistrimet e trurit të njomë, të vegjelisë së kohës tonë, ishin më të forta, më cilësore, të përqëndruara në pak gjëra.

INTERMEXO E DHIMBSHME

Në Çelias vazhdova të isha "banor i rregullt", gjerë në fundin e verës të vitit 1966. Më pas do të shkoja për të vazhduar studimet në Teknikumin e Minierave dhe të Gjeologjisë në Përrenjas të rrethit të Librazhdit, në fushën e bukur të Domosdovës, afër Qafës së Thanës ku, për habinë time dhe afër fshatit Skënderbej. Gjithmonë më ka bërë përshtypje pse e kishte marrë atë emër ai fshat, pasi mendoj se nuk ka lidhje me Skënderbeun, ashtu sikurse dhe qyteti i vjetër i Korçës, ku skuadra e futbollit mbanë emrin e Tij, në vend që ta mbante Dibra, bir i të cilës është Ai. Matjanët e kuptuan më në fund dhe bënë mirë që e hoqën bustin nga sheshi dhe vendosën birin e tyre, edhe pse romani i Godos ua trullosë herë pas here mendjen. Por le të kthehemi tek Çeliasit. Këtu familja më dërgonte kryesisht me dele. Kjo ndodhte, sapo të mbaroja mësimin, të haja pak bukë shpejt e shpejt me çfarë të ndodhej, dhe, duhej të nisesha, për të zëvendësuar ndonjë pjestarë të familjes apo, dikë tjetër që do ti ruante delet, gjersa të kthehesha nga shkolla. Në të shumtën e rasteve, e shtynim bukën e misrit me fasule, dhallë dhe gjizë. Kjo ishte menuja kryesore. Grafiku prishej vetëm kur vinte ndonjë mik. Në këto raste ne të vegjlit gëzoheshim, jo për ato që do vinin, por më shumë për ndryshimin e menusë. Të paktën kështu e mbajë mend unë. Në shtëpinë time, duke përfshirë edhe ca vite kur ishim futur në kooperativë, mbanin dele. Me sa duket akoma nuk qe forcuar kooperativa bujqësore dhe lejoheshin disa gjëra derisa të plotësoheshin furnizimet bazë që kishte nevoja fshatarësia. Fshati im ishte pak i privilegjuar, pasi kishte vend për kullotjen e tyre dhe, ky vend parasegjithash, ishin Çeliasit. Vite më vonë, ne vitin 1974, do të lexoja në Gazetën Mësuesi në dy numra vijues, shkrimin e paharruar, shkrimin historik e të shumëpritur për dibranët, të shkencëtarit të madh, akademikut Kristo Frashëri, nën titullin: "Nga ishin Kastriotët, ku lindi Skënderbeu", i cili midis të tjerave konkludonte ose më mirë arsyetonte se, Skënderbeu ka lindur në Sinë dhe është rritur në Çelias. Kur e lexova për herë të parë, thash me vehte: Unë qenkëm rritur në Çelias, në të njejtin vend, ku dhe është rritur, i madhi Skënderbe. Edhe sot, kur po sistemoj këto shënime, ndjehem mirë

pse jo dhe krenar, se shumica e historianëve dhe studiuesve po e pranojnë se Skënderbeu është Dibran dhe, s'ka si të ndodhë ndryshe, në morinë e fakteve të shumta e të pakundërshtueshme historike që ndeshën në këtë trevë mjaftë interesante, të çertifikuara herëpashere me studime të thelluara shkencore brenda dhe jashtë vendit, me mjaftë botime librash nga dibranët e jo dibranët, edhe sot e kësaj dite. Në Çelias kam patur rastin të takoj për herë të parë dhe shoqëroj për në shtëpinë time (të babës) edhe historianin e ditur e të pasionuar, profesorin e pa harruar Hilmi Sadikaj, nga Golloborda e largët shqiptare, prej të cilit pas atij takimi, do të më jepej mundësia ta takoja e të bisedoja me të në qytetin e Peshkopise, për shumë e shumë gjëra. Ai diskutonte me koopetenca shkencore për ngjarje historike. Kishte njohuri e siguri në ato që thoshte. Shumë gjëra më ka treguar edhe për historinë e të madhit Skënderbe. Nuk di të them sa ka botuar prej tyre. Por le të kthehemi tek fëminia ime, ne ato vite dhe në ato vise në Çelias, pikërisht këtu ku pas kaq e kaq vitesh, më rastisi të bëjë matje, të ushtroj profesionin tim aty ku kisha kullotur delet dhe hidhesha me shokët nga lartësitë e Gurit të Dali Pekut apo Gurit të Hajatit, që nuk u dija emrin, e jo më të gjykoja nga kanë ardhur. Veç afër moshatareve, moshatarëve e afër moshatarëve të mij, si Majune Dauti, Rrushe Dauti, Dije Bitri, Kafile Spata, Sakip Dauti, Munir Hoxha, Ramiz Dauti, Gani Bitri, Imer Bitri, Fatmir Bitri, Ilir Spata, Esat Spata, Ajet Spata, Agim Spata, Hamdi Noka, Nuri Noka, Rexhep Noka, Xhetan Dauti, Halim Dauti, Din Dauti, Hysen Tota etj., shpesh, në Çelias, kam patur rastin të takohem edhe me njerëz të moshuar, bashkëfshatarë dhe bashkëfshatare të mij, që sot të gjithë kanë ndërruar jetë, por që në mendjen dhe zemrën time jetojnë dhe do të jetojnë gjersa edhe unë të mbyll sytë, për sjelljet e tyre, për komunikimet njerëzore, për këshillat, për ndihmat dhe për shumë e shumë gjëra të bukura që më lidhnin me to dhe me ato vite që nuk kthehen pas. Këtu, desha të ndalem e të tregojë një nga ato ngjarje interesante, që më ka gërvishtur më shumë memorien e që lidhet pikërisht me njerin nga këto njerez të thjeshtë, të mençur e të vuajtur, që për mua ngelen të rëndësishëm. Gjatë ditëve ose më sakt gjatë pasditëve kur shkoja në Çelias për të kullotur bagëtinë, më kishte ndodhur shpesh herë, të qëndroja vetëm me Xha Bajramim. Ai, në moshë ishte shumë vite më i madh se babai im dhe, ndërroi jetë rreth viteve 80. Vinte me një trup mesatar, me duar të trasha e të plasaritura si lëkura e pishës, me flokë të plota por të thinjura, me një pamje të vërejtur në fytyrë, por, po të dije ta ngacmoje në tela kur i thone, shpejt i qeshte fytyra dhe kishte një humor karakteristik. Mbante një veshje të thjeshtë, si shumica e bashkëfshatarëve të mij, që portretizonte dhe fliste për varfërinë e kohës ku jetonim. Opingat me gjalma (xhalma) ishin në modë, po ashtu dhe ato të llastikut. Tek tuk ndonjë mbante këpucë thesi apo shumë rrallë ndonjë intelektual, mbante edhe këpucë me lëkurë. Çizmet gjendeshin me vështirësi, veç mundësive për ti blerë. Mbaj mend që i thërrisnim çizme çekosllavake, ishin cilësore dhe shkëlqenin. Si të gjithë fshatarët e asaj kohe që kullosnin bagëtinë dhe Xha Bajrami nuk tregonte ndonjë kujdes të veçant për veshjen. Hë se, me bagëti do të vemi dhe, ky mentalitet, i shoqëron edhe sot e kësaj dite njerëzit e zonave malore, çobanët që kullosin bagëtinë, si në merat afër qendrave të banuara ashtu dhe në pllaja bjeshkësh e male të nalta, kësisoj dhe kujdesi për veshjen nuk është në lartësinë e duhur siç është për shembull, kur ai vete diku mik apo shkon në pazar ditëve të diela. Shkurt, dhe xha Bajrami bënte pjesë në grupin e njerzëve jo fodull në veshje. Ndonëse isha i vogël në moshë, më kishte bërë përshtypje kësula e tij. Isha pothuajse i fiksuar pas saj. Nuk kishte ditë që do ta takoja me dele e nuk do ta pyesja për kësulën. Kësula e bardhë do kujdes të madh për ta mbajtur pastër, aq më tepër kur shkon me bagëti. Unë, nga që kisha vënë re se ajo e kishte humbur bardhësinë, sidomos në pjesën afër kokës, nga djersët dhe nga që ishte vjetëruar shumë, e pyesja shpesh, pse nuk blenë një kësulë te re, Xha Bajram. Ai me buzëqeshje më përgjigjej, fillimisht duke më tundur kokën, pastaj dhe me fjalë. Do ta blejë këtë të dielë në Pazar. Mirëpo unë nuk harroja. Sa vinte e hëna, përsëri e pyesja, hë, e bleve kësulën xha Bajram. Xha Bajrami me atë qetësinë e jashtëzakonëshme që e karakterizonte dhe me atë të folurën e ngadaltë më shqiptonte të njejtat fjalë. Hë mor i biri i hoxhës, këtë të dielë do ta blej se z'bën, pasi nuk dola në pazar, më doli një punë. Bënte si bënte ma jepte një përgjigje, duke u munduar të justifikohej, ndoshta edhe për të më fshehur diçka, mundet dhe arsyen e vertet pse nuk e blente. Deshte ta ruante një sekret, siç mundohen ta ruajnë të gjithë njerëzit e varfër, të drejtë, të ndershëm dhe të thjeshtë. Të dielën tjetër -më thoshte ai -do ta blejë se z'bën. Bajrami nuk ishte nëpunës me pagë mujore, ndonjë punëtorë a specialist në një nga ndërmarrjet e shtetit të asaj kohe. Ai ishte një njeri i moshuar dhe mundohej te jetonte me punën që kishte mundësi ta kryente, me djersën e ballit dhe me ballin lart. Ai nuk kishte marrë rrogë gjatë gjithë jetës. Rroga e Bajramit ishin delet. Po ti ruante e ti shtonte ai fitonte, ndryshe ai nuk fitonte gjë. Pension nuk gëzonte se ashtu ishte koha, nuk kishte punuar as në shtet as në kooperativë. Ekonomia e tregut tek Bajrami kishte ardhur më herët. Jetonte me punën që bënte edhe pse ishte në moshë të thyer. Të ruaje delet ishte punë e vështirë. Fshati vertet i kishte Çeliasit, por ato nuk mjaftonin për të gjithë dhe as ndonjë kullosë të madhe nuk bënin. Këtu vlenë të përmendin thënien e Tij kur e pyeste dikush, a i kullote delet Xha Bajram? Ai përgjigjej gjithë qesendi, i gënjyem pak, i gënjyem, pa harruar ta vinte buzën në gaz. Puna me bagëtinë vertet nuk kishte ndonjë lodhje të madhe fizike, por si çdo punë dhe ajo kishte të fshehtat e mundimet e veta, sidomos kur moti fillonte e ftohej dhe shirat nuk kishin të ndaluar. Pas pyetjes së fundit që i bëra, më afrohet e më thotë: Më ka dhënë fjalën nipi, duke cilësuar emrin e Tij, se, këtë të dielë ai do të dalë në Pazar dhe do të ma blejë kësulën. Besa po, besa po, do të ta blejë një kësulë të re, më ka thënë e më ka premtuar. Dhe unë u besoj njërzëve -përfundoj Xha Bajrami përgjigjen. U gëzova shumë, më në fund thash me vehte, Bajrami do bëhet me kësulë të re. Ditët kalonin shpejt dhe e hëna po ashtu vinte shpejt. Sipas ritualit të zakonshëm edhe atë të hënë unë shkova pasdite tek delet në Çelias. E takova por, më vonë se herët e tjera. Mu desh pak kohë ta kërkoja ku ndodhej, ndonëse ai gjendej pa shumë mund. Kishte një tufë të madhe pasi, nuk ruante vetëm delet e veta por edhe të fisit. Ishte njeri shpirtmadh. E humb se e humb ditën thoshte, pse mos ti ndihmoj dhe të afërmit e mij, kanë halle e fëmijë të vegjël. Do vdesim një ditë. Fjalën e mirë do lemë pas, nuk do marrim gjë matanë. Këto fjalë ja dëgjoja shpesh tek i shqiptonte, duke përkëdhelur delet me shkop dhe duke i drejtuar ato në kullotë. Pasi u përshëndetëm, vura re se Bajrami kishte në kokë kësulën e vjetër dhe mendova të mos e pyesja, të mos bëhesha bajat, kur thonë nga anët tona, duke huazuar fjalën turke. Por, siç ndodhë rëndom, fëmijët nuk e mbajnë fjalën, aq më tepër për raste e biseda të tilla. Kësisoj edhe unë nuk bëja përjashtim. Hë Xha Bajram, nuk ta bleu nipi kësulën e re? - Besa po, besa po më ka thënë, do të ta blejë. Mi tha këto fjalë por, pa dhënë ndonjë shpjegim dhe pa më parë drejtë në sy si herët e tjera, duke ndjekur nga pasë tufën me dele. Që të mos e zgjasë më, atë ditë erdha ta takoja jo për kësulën por, për tu përshëndetur me të, me "shokun tim të fëminisë" që e doja aq shumë dhe që më deshte aq shumë, me të cilin isha rritur në vendin e bukur me emrin Çelias, poshtë të cilit shtrihet një ndër formacionet shkëmbore gjeologjike më të vjetra në Shqipëri. Erdha të takohem me Ju -iu drejtova Xha Bajramit. Për ta ngacmuar me humor, humor fëmijësh që, në vend që të venë vetullat, nxjerrin sytë, vijova duke i thënë se nuk do të të pyes më për kësulën, nuk do të vijë më me dele, do të shkojë në shkollë. Qeshi pak nën buzë dhe nuk foli. E ndjeva se bëra gabim. Është nga të paktat raste në jetën time që mbajë mend mirë gabimin që kam bërë. Megjithëatë ne u ndamë me dashuri e dhimbje siç ndahen "çobanët e vjetër" me njeri tjetrin, duke më uruar suksese në mësime, duke më rrahur shpatullat e shtërnguar fort dorën, pa harruar të më thotë, mos turpërosh fshatin, mos na turpërosh hoxhën. Xha Bajramin nuk do ta takoja më, por këshilla e tij do të më ndiqte pas tërë jetën. Ashtu më erdhën punët. Kur u ndamë atë ditë unë, as që e çoja ndërmend se më xha Bajramin do ishte hera e fundit e takimit dhe përqafimit me të. Edhe sot e kësaj dite e ndjejë peshën e atij takimi dhe peshën e atij gabimi duke e bezdisur plakun e urtë të Çeliasit, njeriun fisnik të fshatit Blliçe, me atë pyetjen rutinë e fëminore të kësulës. Në atë moshë unë nuk mund ti mendoja të gjitha aq hollë e ti kuptoja në detaje aq shumë hallet e Xha Bajramit, dhe në tërësi hallet e kohës të të ashtuquajturit socializëm. Ndaj, më shumë të drejtë një shkrimtarë i madh ka thënë se, asnjëherë mos harro se një moment i jetës mund të jetë hera e fundit që i shikon njerëzit që do. Xha Bajrami ishte nga ata njerëz që kishte mësuar nga jeta ku, të gjithë duan të jetojnë në "majën e malit", pa kuptuar se, lumturia qëndron në mënyrën se si zbret "faqen e pjerrët". Ai ishte nga ato njerëz që kanë mësuar në jetë, se njeriu ka të drejtë ta shohë tjetrin nga lartë, vetëm kur duhet ta ndihmojë të çohet..... I tillë ka ngelë në mendjen time i paharruari Xha Bajrami.

NË VEND TË MBYLLJES

Vitet do të kalonin, dhe fati do ta sillte që unë të punoja edhe në malet e pllajat e pa sosura të Korabit, Sorokolit, Gramës, Përroit të Lushit, Terfojës, Kallabakut etj., larg të dy familjeve, familjes së madhe, siç isha mësuar ta quaja atë të lindjes në Blliçe, dhe familjes së vogël, ku banoja tashmë në një apartament, në qytetin e Peshkopisë. Në vitet e para të punës së re në këtë rajon, për sa kohë kisha edhe prindërit gjallë, në raste shumë të rralla do kaloja për në Peshkopi pa ndaluar në Blliçe. Malli për prindërit dhe vendlindjen tërheqin më shumë se "familja e vogël". Në një nga ato ndalesa, shkova në shtëpinë e familjes së madhe, ku gjeta e takova nënën, pasi babën në të shumtën e rasteve nuk e gjeja në shtëpi, dhe, pasi u ç'malla pak, midis të tjerash e pyes se çfarë kemi ndonjë të re në fshat. Nëna, duke ditur marrëdhënien time që kisha patur me Xha Bajramin në fëmininë time, nuk më tregon gjë fillimisht, duke ma anashkaluar atë që kishte ndodhur. Ndoshta priste një moment më të përshtatshëm. Më shtron pak bukë për të ngrënë, edhe pse nuk ishte as kohë dreke, as kohë darke, por, me mua kështu ndodhte gjithmonë, vija kur të më sillnin këmbët, duke bërë gjithë atë rrugë malore në këmbë. Siç kam shkruar dhe në tregime të tjera, makinat kanë qënë aq të rralla sa, brezat e sotën, nuk mund ta imagjinojnë, kjo falë dhe rrugës që ishte si rrugë traktori, kurse sot, bëjmë vërejtje për cilësinë e rrugës së asfaltit. Pasi e realizojë "normën e ushqimit" dhe rehatohem disi, për habinë e nënës unë e pyes për Xha Bajramin. Vura re se i ndryshoi pamja e fytyrës, pastaj u drejtua plotësisht nga unë e më tha: Bajrami ka ndërruar jetë, bir. Eh, pshertiva thellë e u ngushtova pak duke lëshuar disa pika loti. Lot dhibjeje, lot dashurie të njeriut për njeriun. Më erdhi shumë keq për vdekjen e Tij, për ndarjen e Tij nga kjo jetë, jo për moshën, se sa për shumë e shumë gjëra të tjera që më tepër ndjehen, sa sa shprehen me fjalë. Pasi u qetësova pak, se si më erdhi dhe përsëri e pyeta nënën: Po Kësulën e re a e bleu? -Jo bir jo, vdiq pa e blerë kësulën -u përgjigj nëna. Jeta të mëson tu japësh rëndësi gjërave jo për vlerën, por për domethënien e tyre. I madhi Garcia Marquez ka shkruar se njeriu duhet të thotë gjithmonë atë që ndjen dhe të bëjë gjithmonë atë që mendon. Mbaji ata që dashuron pranë vetes - shkruante Marquez -thuaju duke mërmeritur se sa shumë ke nevojë për ta, dashuroji, sillu mirë, gjej kohën për ta, thuaju "më vjen keq", "më fal", "faleminderit" dhe të gjitha fjalët e dashurisë që di. Asnjeri nuk do të të mbajë mend për mendimet e tua të fshehta. Do të doja të vazhdoja kur të tjerët do ndalonin, do të doja të zgjohesha kur të tjerët do flinin.

** Autori i shkrimit është antar i stafit akademik të Institutit të Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit dhe, antar i Senatit Akademik të Universitetit Politeknik të Tiranës.*

Dy botë, dy zemra, dy konceptime

Nga: **FAIK XHANI**

Duke lexuar librin e autorit Velo Cfarku "Të parën kemi Dibrën…" përshfaqen dy botë, dy zemra, dy konceptime, të cilët përbëjnë një trinom që përshkruajn gjithë librin. Kjo trio është sa brilante aq edhe zhgënjyese. Brilante për ata që shohin me syrin e duhur dhuratë e perëndisë, me veshin njerëzor e me zemrën e madhe që ka vend për të gjithë dhe zhgënjyese për ata që syve, veshëve dhe zemrës së një trupi të lindur i vendosin patericat e miopisë, dashakeqësisë, smirën e mosmirënjohjen.

E pra, Velo Cfarku, autori i librit : "Të parën kemi Dibrën…" vjen si njeri kollos nga mendimi, vizioni, shprehja, humanizmi, përceptimi e përgjithsimi i njerëzores e në veçanti i një nga trevat më të vyera e me shumë potencë të altarit të kombit e atdheut tonë, Dibrës. Tani,76-vjeçar, Velo Cfarku më duket më simpatik, më i mënçur, më mirënjohës se kurrë, sepse në dyert e Dibrës ka vënë brerorën e vlerës më të lartë " Të parën kemi Dibrën…", duke i kthyer asaj mirënjohjen më brilante për atë trimëri, dashuri, bujari, filozofi, formim e pjekuri që i dha ajo në vite autorit dhe gjithë shqiptarëve.

Pas një libri mirënjohjeje për Dibrën e dibranët me titull: "Një jetë mes dibranëve" sot autori Velo Cfarku vjen me një botim tjetër me titull bombë "Të parën kemi Dibrën…". Është një titull Deduktiv, vlerësues, i gjetur, përkëdhelës, mirënjohës, respektues, por edhe përcaktues e vlerësues, i cili e hap siparin e rrëfimit, derën e librit dhe që në rrjeshtat e parë të mbështjellë me kuriozitetin, konkluzionin, vendosjen në vendin e parë të Dibrës në Shqipërinë veri-lindore. Që në fillim, pa lule, pa sajesa, pa hyrje të stërgjatura autori e vendos lexuesin në dy institucione mençurie, në odën e burrave të Pacit të Tropojës e në atë të Shishtavecit të Kukësit dhe përballë rrëfimit të dy personazheve karizmatik shekullor, dëshmitarë okularë të ngjarjeve, bëmave dhe kontribuimeve të Dibrës e dibranëve në rrjedhat e shekujve e të historisë.

Vetëm një mendje e kthjellët dhe e ndritur siç është ajo e autorit Velo Cfarku din të fokusojë aq bukur institucione mençurie e personazhe tipike qoftë nga kredibiliteti, por dhe nga vlerësimi, mirënjohja e respekti për të vërtetat historike. Është ky autor që me mençurinë e tij rrezaton vlerësimin më të lartë "Të parën kemi Dibrën"nga koncentrati i mençurisë i kullës së Pacit të Tropojës dhe asaj të Shishtavecit të Kukësit, nga goja e Bajram Pacit të Tropojës këtu e 40 vite më parë, burrë kreshnik, me zë e autoritet të padiskutueshëm, shtatlartë si pishë malësie, zotërues e zbatues i zakoneve tradicionale e të kanuneve të Malësisë. (f. 21).

10 vjet më vonë në familjen Myrsel Beqja, familje e dëshmorit Fetish Beqja, emër që mbante "Shtëpia e Kulturës Shishtavecit", me të njëjtët mjete fokusoi të njëjtin përfundim: " Të parën kemi Dibrën…".

Nuk ishte rastësi. Autori me jehonë klithmatike sa ajo e atyre maleve konkludon:" Jo, Jo! Ajo është realitet, realitet historik, ku popujt bashkohen kundër të keqes, duke vënë gurë themeli të palëvizshëm në panteonin e luftës për liri e pavarësi, pra, në histori. (f.28). Ndërsa shishtavecasi i nderuar, me urdhërin e zemrës e të shpirtit dhe me gojën e tij pohon: "Në luftrat për liri (për mbrojtjen e trojeve tona), për pavarësi kundër pushtuesve serbë (këtë e thotë me ton e theks), austohungarezë, bullgarë etj., kurdoherë: Tropojë, Kukës e Dibër kemi qenë njëshë, por të parën kemi patur Dibrën".

Janë 10 faqet e para të librit ku në çdo fjalë e në çdo rrjesht rrjedh vetëm një koncentrat, koncentrati i praruar "Të parën kemi Dibrën" dhe që këtu autori mund ta kishte mbyllur këtë libër me idenë, qëllimin dhe realizimin më të mirë, me xhevahiret e xhevahireve të kontribuimit të Dibrës e dibranëve në shtigjet e historisë. Nuk ndodh kështu, se autori është zemërgjerë, i vendosur për ta çuar deri në fund betimin e tij, për ta strukturuar mirënjohjen, dashurinë dhe respektin e tij për Dibrën e dibranët edhe me 270 faqe të tjera që përbëjnë mozaikun më të mirë e më të spikatur të kontribuimit të Dibrës e dibranëve në obeliskun e nderit të Shqipërisë.

Nga rrjeshti në rrjesht e nga faqja në faqe autori laton, lartëson me fakte, argumenta, bëma e kontribuime se si Dibra qëndron e para në trevat e Shqipërisë Veri-lindore, por edhe ndër më të qenat e më të vlerësuarat edhe në rrang vendi e kombi.

Si seleksionieri më i mirë autori ka ditur të përzgjedh ngjarjet më tipike e personazhet më të skalitur, më me potencë e kredibilitet, të cilët rrëfejnë e dëshmojnë për kontributin e Dibrës dhe dibranëve gjatë rrugëtimit historik. Vazhdon të rikonstruktojë e të plotësojë në mënyrën më të mirë qëllimin e librit me deduksionin e Artistit të Popullit, "Nderi i Kombit" Kadri Rroshi i cili açik dhe qartazi shprehet: " Kur të flasish për Dibrën, duhet të mendohesh shumë si dhe shpreh mirënjohjen e tij si më poshtë: " Jam mirënjohës kësaj treve. Ato më kanë pritur, pritur aq mirë, me një të njohur. Faleminderit!

Vazhdon me poemën e poetit Aqif Doku me titull: "Dibra" ku po veçoj: " Për bëmat e Dibrës që në lashtësi/ Ju tregon Korabi/ Ju flet Drini i Zi/ ju tregon Stelushi/ Ju flet Sfetigradi/. Tre gisht më lart mbi parinë kanë qenë/ Atyre puna, sofra dhe pushka u shkëlqeu/ Se për hatër atë vend s,ua kanë dhënë/ . Vazhdon më tëj me elegjinë për luftën e Lanës së Lurës të të ndjerit Xheladin Tollja ku veçoj: " Qëndroni burra se shkoi vatani/ 108 burra merr masakra/ Që nga Çidhna e Reç e Dardha/. Me luftën e Lanës së Lurës e ultimatumin e Elez Isufit ku autori Strazimiri konkludon: "Janë gati me sakrifikue çdo gja, për me ruajt traditat kombëtare që i kanë më të dashura se jetën e tyre" e për të përfunduar me pjesët me tituj " Se nëntë Malet i ke për mbrapa" dhe rrëfimin e Rexhep Dodës " Ne duam gjanë tonë, or zotni", të cilat janë nga perlat e kontributit dhe ndihmesës së Dibrës e dibranëve nga thellësitë e shekujve e deri në ditët tona që autori Velo Cfarku i ka përzgjedhur me marak e me shpirtin e mirnjojes, si e si për ta ndriçuar e rritur Dibrën.

I qeni mbetet i qenë. Si i till, për t,i dhënë hakën tjetrit i nxit zjarrit të tij, i ndrit derës, fshatit e bashkëfshatrëve të tij duke treguar se kush është e pastaj demonstron

Vlerësimin për të tjerët. Kështu vepron edhe autori i nderuar i librit Velo cfarku, i cili nuk mund të lë pa nxjerr në pah vlerat e kontribuimin të Gollobordës e gollobordasve, i njerit nga Nëntë Malet e Dibrës, i cili në vazhdimësi ka patur zërin e tij vendimarrës në tërë zhvillimet politiko-shoqërore të krahinës e me gjërë. Këtij qëllimi e kësaj ideje i shërbejnë 66 faqe të librit nga ku rrjedh si vala e Drinit djersa, përpjekjet, puna, sakrificat, lufta, bujaria, mençurija dhe rezultantja e një populli artist: "Aftësia e një komuniteti projektues, zbatues e ndërtues, e gollobordasve që shumë bukur përshfaqet në perfundimin e tepelenasit Shefqet Qendro e gjirokastritit Çobo Vipi: " Ata ndërtuan gjithë Shqipërinë"!(f. 202) për të vazhduar pastaj nga faqja 202-213, 250-254, 255-263, që me meritë mund ta klasifikojmë si një minienciklopedi të Gollobordës e gollobordasve nga ku mund të marrësh e përfvetësoshë tradita, zakone, motivime, shërbesa, obligime, kontribuime e modelet më të mira të kontribuimit për vendlindjen, përhapjen e diturisë, mbrojtjen e lirisë, lobimin e vlerave turistike të kësaj treve si dhe menaxhimin sa më efikas të resuseve të Gollobordës.

Libri "Të parën kemi Dibrën" është një gërshetim artistik i disa gjinive. Aty shaqet e realizohet mjaft mirë publicistika moderne, raportazhi, përshkrimi, portreti, rençenca, replika, hulumtimi, kumtesa studimore, dedikimi i veshur me mjete të shumta artistike, ku deduksioni e induksioni përbëjnë bazën e gjithë shtjellimit të matrialit të këtij libri.

Autori duke qenë një nga njohësit e mirë të problemeve të arsimit e kulturës e të punës me njerëzit ka fokusuar me detaje e saktësi veprimtaritë më të mirëorganizuara siç janë ata të promovimit të librave, të kuvendeve të gollobordasve duke përfunduar me një nga veprimtaritë më mbresëlënëse 40-vjetorin e ansamblit të Zall-Dardhës. Si në një kinoditar me metrazh të gjërë përshfaqen personazhe jetikë secili më mbresëlënës se tjetri, të skalitur me pendën e hollë të autorit Velo cfarku si Xhem Teta i Gjurasit, Qzim Biçi i Mazhicës, Xhevdet Daci i Shupenzës, arqitekti i shquar Miço Pepa, veterani Anastas Karanxha, mjeshtri i talentuar dhe skulptori e piktori Thanas Pleushku, Pavli Nikolla, mikpritja e Rrahman Nikës, portretet për Hysen Lalën, Mevlud Bucin e Hysni Budinin e Katër-Grykëve, Artisten e Merituar dhe Mjeshtren e Madhe Drita Agolli, regjisoren dhe skenaristen e talentuar Nadire Buzo(Nuro), për 10 sportistet femra të "Korabit" të Peshkopise, poeti i këngës Naim Plaku, Artistit të Merituar Hazis Ndreu etj.

Duke lexuar me shumë vëmëndje librin e autorit Velo Cfarku konkludoj: Është një libër që ngjason me një arkiv modern ku gjen të skalitur në mënyrën më të mirë mencurinë dhe kontributin e Dibrës.

Për nga tematika që rrok, personazhet, bëmat, ngjarjet, të dhënat që jep, gjeografia e shtrirjes në kohë e hapsirë ngjason me një minienciklopedi e Dibrës dhe Gollobordës.

Është libri ku ajreali i vlerave e shërbesave kontribuese të dibranëve kalon nga geni në gen e nga brezi në brez.

Është një libër refleksioni për tiparet e kalbëzimit të sistemit të Diktarës, për atë që nuk u bë mirë e që mund të bëhej shumë më mire, për të mirën e vendit e të shoqërisë shqiptare.

Ky libër është një qiell i kaltër ku rrezatojnë yjet e atdhetarizmës, të mençurisë, të menaxhimit efikas, shërbesave dhe kontribuimit të Dibrës dhe dibranëve nga thellësitë e shekujve e deri në ditët tona.

Velo Cfarku edhe në krijimtarinë e tij është simboli i bashkimit të vlerave anë e mbanë Shqipërisë dhe tamam, si ajo bleta punëtore që mbledh polenin e luleve më erë mirë edhe ai mbledh vlerat e Dibrës, Gollobordës e të Shqipërisë dhe i ve në bangoprovën e veprimtarive më të spikatura e shërbesave më të mira e më të rëndësishme të trevës së tij, Dibrës e Gollabordës. Ja sepse gjejë rastin ta falenderoj më gjithë zemër. Ti uroj jetë të gjatë, krijimtari të frytshme, shëndet dhe lumturi.

PREZANTIMI

Më datën 19 nëndor 2011, në Teatrin e Operas dhe Baletit u bë promovimi i librit "Të parën kemi Dibrën" me autor zotin Velo Cfarku.Ky aktivitet organizohej nga Unioni i shkrimtarëve të Tiranës ku dhe fjalën e hapjes e mbajti shkrimtari Bahri Myftari. Ishin të pranishëm mjaft shkrimtar, gazetar e publicist jo vetëm nga Dibra por dhe nga vende të ndryshme të vendit që nga Tropoja e deri në Përmet e Tepelenë. Nuk ishte hera e parë që gazetari i njohur Velo Cfarku, njeriu që iu përkushtua me mund e sakrifica gazetës së atëhershme lokale "Ushtima e Meleve" të mblidhte shokë e miq në aktivitete të tilla.Nuk ishte libri i parë i tij por ishte një libër totalisht që i dedikohej Dibrës dhe dibranve, njerëz që autori i kishte njohur nga afër, kishte punuar me to por dhe kishte shkëmbyer eksperiencën gjatë punës. Dhe gjeografia e personazheve ishte e madhe, që nga Kalaja e Dodës e deri

në Lurë, nga Stebleva e deri në Selishtë se vetë Velo Cfarku i shkeli me këmbë këto vise dhe domosdo dhe la gjurmë të mira kudo që vajti. Këto shënime të bukura, këto mbresa, personazhe e ngjarje që kanë lënë gjurmë në jetën dhe punën e Velo Cfarkut na vijnë të freskëta në faqet e këtij libri sikur ngjarjet të kenë ndodhur sot dhe pse mjaft persdonazhe të librit nuk janë më midis nesh. Poeti librazhdas Qazim Shehu në fjalën e tij ndër të tjera tha: "Autori Velo Cfarku si njohës i mirë i Dibrës, si njohës i folklorit na sjell nëpërmjet këtij libri një galeri njerëzish që portretizohen përmes njohjes së autorit që është e pasur e nga kjo pasuri, portretet shpëtojnë nga standartizimi i përshkrimit duke u bërë intresant sepse ata më të shumti i përkasin larmisë së jetës se sa larmisë së imagjinatës dhe përfytyrimit për to. Regjizorja e njohur shqiptare Nadire Murra, bijë e Gollobordës mes të tjera tha: "Velo shkruan bukur se shkruan më së shumti për të tjerët.Unë vërtet ndjehem krenare që jam dibrane, ndjehem krenare që kam punuar gjatë në Dibër.Edhe Veo Cfarku ato vite pune që ka punuar një jetë të tërë në ato vise të bukura, mes atyre njerëzve të mrekullueshëm bukur na i jep sot në libër të gjithë ato personazhe që ka njohur e ka punuar, ka ndarë me to të mirën por dhe të keqen".Në këtë aktivitet floën dhe shokët Faik Xhani, Ilir Balili, Mevlud Buci, shkrimtari Sali Leka,Sandri Karanxha, poetja e Gollobordës Venka Capa,Shefqet Mikli, avokati Serxho Mazniku, Vasil Bozo poetja Merita Sina si dhe gazetarja e njohur Fatime Kulli.Në fund një koktej për miqtë e zgjedhur, një trokitje gotash dhe urim për autorin, një foto si kujtim për këtë aktivitet të bukur dhe mbresëlënës.

E.Skarra

kulturë

Qendra Kulturore Gramsh fiton festivalin e 17-të të Odës Dibrane

Më 18 nëntor, në qytetin e Peshkopisë u organizua edicioni I 17-të I Odës Dibrane. Në këtë veprimtari tradicionale etnokulturore morën pjesë Ansamblki "Fluturat" Gjilan, Qendra Kulturore Mat, Ansambli "Josip Rela" Podujevë, SHKA "Hibe Palikuqi" Shkup, Ansambli Shote Galica" Drenasi, Ansambli "Shote Galica" Drenasi, Ansambli "Zeri I Bilbilit" Sarandë, Qendra Kulturore Bulqizë, Qendra kulturore "Vëllezërit Çetiri" Gramsh, Ansambli "Gora" Korçë, si dhe SHKA "Jehona e Malësisë së Sharrit" Tetovë.

Festivalit i parapriu një paradë e kostumeve popullore mbajtur para Pallatit të Kulturës

Ansambli "Fluturat" i Gjilanit, me udhëheqës artistik Xhemajl Berisha, u paraqit me materialet "Melodi me gajde", "Shengjergjat po sillen", "Melodi me çifteli", "Pyet Kosova për një çike", Valle "Ngucaveli", etj.

Ansambli "MATI" Burrel u paraqit me "melodi baritore" dhe Kolazh vallesh.

Ansambli "JOSIP RELA", Podujeve u paraqit me "Valle popullore "Gajdexhiu", dhe këngët "Fryni era u çel taraba", "Prej Podrimes po vjen haberi", "Këndo o zogu i malit", "Në Dardani rreh një tupan", Kënga humoristike "Na këndo një këngë shqiptare" dhe vallja popullore Baresha.

SHKA "HIBE PALIKUQI" Shkup u paraqit me "Nuk din nana qysh me martu djalin", "Këngë per komandant Mjekrën" si dhe "Lamtumir o moj nene loke"

Ansambli "SHOTE GALICA" Drenas Kosove, me udhëheqës artistik Shaqir Hasi u paraqit me "Këngë për Universitetin",."Kosovë o vendi im i bukur","Unë jetime e Kosovës", "Flijimi" dhe "Vashezo".

Ansambli "ZERI I BILBILIT" Sarandë u paraqit " Ç'me zuri sevdaja si një djalë i ri", "Ara e Abazit në grope", "Qaj kalaja mbi Sarande", "Melodi me fyell" dhe "Moj nerenxë grykë zënë".

Qendra Kulturore Bulqizë me udhëheqës artistik Besnik Koçi dhe drejtore artistike Natasha Gjoka u paraqit me "Këngë për Baba Fejzën", valle dyshe burrash të trevës së Gjoricës dhe Gollobordës, , këngën "Moj fushë e Vajkalit", "Trimat e Vajkalit"

Qendra Kulturore "VELLEZERIT ÇETIRI" Gramsh u paraqit me "O Alush o mjekër shtupe", "Kënga e iriqit", "Shkonte dhendërri tek vjehrra", "Me erdhën ca miq për darke", "Plesht or plesht or qerrata".

Ansambli "GORA" Korçë solli në këtë festival një valle tradicionale të burrave të Gorës, valle dyshe grash si dhe këngët "Ky fustani jotë", "Çobankat kur shkojne zallit" dhe "N'ate mal ku fryn veriu"

SHKA. "Jehona e Malësisë së Sharrit" Tetovë dollën vallet "Riti i Kulaçit", Valle Kalanxhoj, Valle Shqiponja, dhe këngët "Djemtë e Sinan Orashës" dhe "Cucat e Katunit"

Çmimin e parë të Festivalit e mori "Qendra Kulturore Gramsh" ndërsa me çmimin e dytë u nderua ansambli "Jehona e Malësisë së Sharrit" Tetove dhe te tretin Ansambli "Zëri i bilbilit" Sarandë.

Të gjitha grupet pjesëmarrëse u vlerësuan me logon e Odës per numrin më të mirë të programit të tyre.

Festivali i Odës Dibrane u organizua nga Qendra Kulturore Peshkopi, me drejtor Veli Vranici, regjinë të Behar Merës dhe udhëheqës artistic Përparim Tomcini. Edhe këtë vit, festivali u mbështet nga Ministria e Kulturës, bashkia Peshkopi dhe sponsorë të tjerë si: "RISKU" sh.p.k., "NDREGJONI" sh.p.k., "PRO-GIPS" sh.p.k., "DAJTI CONSTRUXION" sh.p.k., Hotel "KORABI" Peshkopi, Hotel "VERI" Peshkopi, Hotel "BALLKAN" Peshkopi, Pub "PIAZZA", Hotel "BRUKLIN", "M&B - Botime dhe Studio Grafike"

Mentor Hoxha prezanton librin "Lirika nga Evropa"

Në shkollën "Murat Toptani"në Tiranë u promovua libri "Lirika nga Europa" i poetit dhe gazetarit të mirënjohur Mentor Hoxha. Morën pjesë nxënësit dhe mësuesit ekësaj shkolle, Qani Çela, Fatime Cufa, dhe Agim Xhelili. E ftuar nderi ishte inspektorja e Drejtorisë Arsimore Diana Dajko (Boçi). Një promovim i veçantë me recitime dhe vlerësime për autorin dhe lirikat e tij të mrekullueshme plot muzikalitet, figuracion dhe gjetje letrare. Drejtori i shkollës Arben Beli, falenderoi autorin për pjesëmarrjen, si dhe nxënësit e tij për spektaklin dhe entuaziazmin që dhuruan në sallë përmes duartroktitjeve dhe recitimeve plot ndjenjë dhe talent nga Sara Kola, Armela Allushi, Taipe Muhameti, Dajana Karaj, Xhanina Seferi, Doruntina Lika, Hajrie Kola, Ariel Losha, Xhesika Qelhaka, Xhoi Çeka, Adelina Peshtanjaku, Megi Senka, Teuta Sulejmani, Eglantina Ibra, Joana Bilo, Daniel Shabhasa, Jonida Çuko dhe Ilda Mcini. Të pranishmit e shumtë u njohën me artikujt që mediat kryesore kanë shkruar për autorin dhe 7 librat e tij. Mbi vlerat ideoartistike të librit foli gazetari, poeti, fabulisti dhe mësuesi i dallua r Mevlud Buci. Ai e quajti autorin, pasardhës të Eseninit dhe Lasgush Poradecit. Mentor Hoxha, që shoqërohej nga bashkëshortja, falënderoi për mikëpritjen e ngrohtë drejtorin e shkollës, mësuesit, recituesit dhe auditorin që me duatrokitjet dhe interpretimin e poezive të tij, i dhanë këtij takimi ngrohtësi dhe jetë. "Kam marrë pjesë në shumë promovime të rëndësishme letrare me të ftuar VIP, -tha në fjalën e tij autori, por ky takim i mrekullueshëm me ju , më emocionoi shumë për disa arësye. E para, me kujtoi vitet e gjimnazit kur publikoja poezitë e para në gazeta, e më pas, vitet e mia si mësues i letërsisë në gjimnaz. E dyta, ngrohtësinë, duartrokitjet dhe emocionet që më dhatë ju nuk i kam marrë as në auditoret e mëdha, pasi bota juaj shpirtërore është e çiltër ashtu si shpirti im dhe lirikat e mia. Pra, le të shërbejë ky takim me ju me ju, si starti i një takimi të mrekullueshëm në jetë për të mos patur kurrë finish. Le të shërbejë si urë lidhëse mes nesh për të të mos u shkëputur kurrë më nga njëri-tjetri, si simbol i respektit dhe mirënjohjes reciproke. Në fund nxënësit dhe pjesmarrësit kërkuan shumë autografe nga autori dhe bënë shumë fotografi me të.

Mentor Hoxha, Poradeci dhe Esenini i Dibrës

Nga **Mevlud BUCI***

Çdo lexues e studiues që lexon krijimtarinë poetike të Mentor Hoxhës, ndjen prushin e mallit dhe bukurinë e fjalës. Nuk është apak hyperbolë nëse themi se poeti lirik Mentor Hoxha është një pasues i denjë i lirikut të madh shqiptar, Lasgush Poradeci dhe atij rus Sergei Esenin. E themi këtë, sepse krijimtaria disavjeçare e poetit Hoxha, krahas tematikës së larmishme për dashurinë njerëzore karakterizohet nga një force shprehëse me vlera të rralla edukative plot prushe malli. Në të gjitha strofat e tij mbisundon poetika, figuracioni mjeshtëror, paralelizmi, metaforat, krahasimet, simbolet dhe mjeshtëria artistike e përshkrimit dhe portretizimit. Autori shkruan me stilin esenian duke na dhënë bukurinë dhe fisnikërinë e dashurisë.

*(*Marrë me shkurtime nga gazeta "Republika", datë 6 Nëntor 2011, faqe 16).*

kape kohën...

botime & studio grafike

00355 4 22 33 283
069 20 68 603
mbbotime@gmail.com

Prangosja e Zenel Dodës

Nga: **REXHEP DODA**

Ishte data 30 gusht 1929. Zenel Doda do të shkonte në Tiranë, kurse unë u bëra bashkëudhëtar me të qysh kur u nisëm nga shtëpitë tona. Do të shkoja për të bërë vitin e katërt në "Internatin e Matit" në Burrel.

Nga Burreli në Tiranë, Zeneli mendonte të udhëtojë me një makinë të tregtarit të madh krutan, Xhemal Ferra, që lëvizte dy herë në javë. Burrel-Tiranë e kthim. Natën e kaluar, kishim bujtur te Haziz Kasemi, një mjek popullor, tek i cili, Zeneli kishte dërguar nusen e djalit të madh Imer Dodës, për mjekim.

Rreth orës 9.30 mbasi kishim kaluar lumin e Matit me pak ujë po udhëtonim deri në rreth dy kilometër, ndodheshim pranë kazermave të shkollës së gjindarmërisë. Rruga këmbësore, me shumë pluhur kalonte nëpër një dushk shumë të shkurtër, shkurre, por, ishte e gjerë për këmbësorët. Në drejtim të kundërt me ne, po vinte poshtë një grup xhandarësh dhe karabinierësh italianë, prej rreth 15 vetësh, të komanduar nga një kapiten gjindarmërie.

Kjo "ekspeditë ushtarake", n'atë kohë, quhej "Shëticë". Kur u afruam me ta, në një distancë prej 8-10 metrash, Zeneli dhe unë, pakësuam shumë ritmin e ecjes, për t'ju hapur rrugën ushtarakëve, meqenëse, ata nuk ecshin në njësh kollonë, por shkonin në grupe të vogla prej 3-4 vetash bashkë, sikur ecin edhe tani e kurdoherë kinezët, në grupe, dukeshin sikur kishin dalë të shëtisin, ashtu sikurse dilnim ndonjë të shtunë edhe neve nxënësit e Internatit, kur shkojmë në piknik.

N'atë çast unë vura re një lëvizje, që më bëri përshtypje të madhe. Me shpejtësi, tre xhandarë u shkëputën nga turma dhe dolën mbrapa shpinës së Zenelit, që ishte para meje, por ishte ndaluar për t'ju hapur rrugën. Njëri nga ata të tre, i kapi Zenelit krahun mbrapa shpinës, dhe ja tërhoqi nga e vetja. Të njëjtën veprim bëri dhe xhandari tjetër, duke ja kapur krahun e majtë. I bashkuan të dy duart dhe në sekondë karabinieri italian i vuri prangat në duar mbrapa shpinës.

Siç e gjykoi edhe tani, kjo prangosje u realizua profesionalisht në mënyrën më perfekte. Kapiteni i xhandarmërisë, duke qenë ballë për ballë me Zenel Dodën e prangosur, mori një pozë fodullëku të shtirur, u afrua akoma, i kapi me dorën e vet nagantin A.Z. që e kishte në këllëfin e saj, sipas brezit përpara. E mori në dorë dhe pa e parë me ndonjë interes, e pyeti Zenelin:

"Kush ta ka dhanë ktë nagantë? Zeneli: "Ma ka dhanë naltmadhnia e tij Ahmet Zogu (mbreti i Shqipërisë dhe i gjithë shqiptarëve", iu përgjigj me një zë disi të fortë dhe me ton protestues. Pastaj vazhdoi: "Këndoje zotni kapiten se e ke të shkruar, kush ma ka dhanë, nëse dini shkrim dhe këndim".

Kapiteni i xhandarmërisë u ofendua shumë rëndë nga toni i zërit të të arrestuarit, nga trimëria dhe përmbajtja e përgjigjes së tij. E pyeti përsëri: "Ku e ke lejen me shkrim për këtë armë?" Zeneli: "Aaaa, po tani po të përgjigjem. Lejen e saj, naganta A.Z. e ka në grykën e vet, zotni kapiten, por ju, më lidhët duart me pabesi, mbrapa shpinës, duke mos më lanë mundësi me jua kallxue lejen që ka ajo".

Përgjigje e dytë, e tërboi në kulm kapitenin e gjindarmërisë, kurse Zenelit, nuk ja bënte syri tërr. Nuk ju turbullua aspak gjaku. Zeneli nuk i tha kapitenit se jam ... në rezervë, nuk e kuptova se pse. Kurse unë desha të flas, por ktheva kokën të shoh Zenelin, dhe të marr lejen e tij për të folur, por ai më foli me mimikën e fytyrës, duke më thënë mbylle gojën.

N'atë çast m'u drejtua mue: Nisu ti Rexhep për në shkollë! Jo, i thashë, unë do të rri me ty. Jo, jo! Nisu menjëherë. Hajde të falemi dhe porosia ime asht: të mësojsh sa më shumë, të dalësh i pari i klasës, sikurse deri tani, ashtu siç ka dalë Riza Doda në shkollën e vet" – më tha.

Mua m'u mbushën sytë me lot, por, nuk e dhashë veten. Lotët e mi nuk i pa askush sepse do ta turpëroja burrërinë e Zenel Dodës. E kapërdiva hidhërimin. E përqafova duke e shtrënguar fort dhe i ktheva shpinën, por pa e parë në sy.

Mbasi u nisa për në shkollë dhe qeshë larguar veçse 6-7 metra nga ai, ktheva kokën përsëri mbrapa ta shoh dhe njëherë Zenel Dodën, atë burrë aq të madh të fisit tonë. Doja ta fiksoj në memorien time, për të mos u fshirë kurrë, për gjithë jetën, ajo pamje trimërore e tij. Ai ishte ulur n'atë moment me duart mbrapa shpinës. Rrugëtarët matjanë kalonin lartë e poshtë, shikonin me habi të madh këtë malësor të prangosur dhe largoheshin në punë të tyre, por admironin qëndrimin e tij kaq burërro. Zeneli aty mua më ngjante me një luan të madh, që nuk është mbyllur brenda hekurave të kafazit në kopshtin zoologjik. Ai bën lëvizje shumë të kufizuara brenda mundësive që i lejon dhoma e vogël e kafazit, pa u shqetësuar aspak nga ngacmimet e vizitorëve të vegjël që e shqetësojnë jashtë hekurave.

Kurse vizitorët e Zenel Dodës, në këtë rast, ishin 15 xhandarë e karabinierë dhe një kapiten gjindarmërie, të cilët mua më dukeshin shumë të vegjël, përpara burrërisë dhe trimërisë së Zenel Dodës. Ata flisnin me njëri-tjetrin me zë të ulët, duke e parë me habi të madhe këtë malësor nga fisi i Dodës prej Reçit të Dibrës.

Të nesërmen në shkollë, i shkrova një letër të gjatë familjes së Zenelit, duke e informuar për gjithçka dhe ja postova.

Tani, që e përfundova përshkrimin e prangosjes së Zenel Dodës, duke përjetuar shumë emocione, natyrisht me ato pak hollësira që më kishin ngelur të pashlyera në kujtesën time. M'u kujtua në çast edhe një trim tjetër i ngjashëm kosovar (por që ai ishte shumë më i madh). Quhej Sefë Kosharja. Serbët okupatorë shekullorë të Kosovës, e kapën me tradhti natën në gjumë, dhe mbasi e therën me thika e varin në majën e një lisi të gjatë e zhveshur nga plagët me anë të një rruge që kishte mjaft rashpëritje.

Kosovarët trima atdhetarë dhe patriotë duke kaluar asaj rruge, rastësisht apo enkas, ndaloheshin para tij trimi të varur; përuleshin me nderim të thellë dhe me dhimbje të madhe, por me krenari të ligjshme. E ngrinin kokën lart, e shikonin dhe thonin këto fjalë:

Sefë Kosharja i pari i fisit
Hije t'paska maja e lisit*.

** Sulejman Krasniqi në librin "Mic Sokoli"*

Brezhdani, fshat i urbanizuar qysh në mesjetë

(Vijon nga faqja 7)

Rruga tietër që lidh lagjet e Brezhdanit me fushën është ajo që fillon në Mecit, vazhdon përgjatë "Lugjevë të Xharre", në drejtim të "Stallave të Vjetra", ku bashkohet me rrugën që vjen nga fisi i Skurajve dhe aty ndahet në dy degëzime, nga të cilat njëra të çon në brendësi të fushës ndërsa tietra vazhdon drejt, deri në ekstremitetin e vët në "Çukë të Xharrë" në qafë të kodrës Gjarricë dhe del në rrugën e sotme automobilistike, që lidh Muhurrin me qytetin e Peshkopisë.

Përsa i përket autoktonisë, e gjithë popullësia aktuale e Brezhdanit është relativisht e re. Mund të flitet për një "rishtrezim" apo "mbivendosie" të vonëshme të popullatës. Treva e Brezhdanit, ashtu si edhe rrethinat përreth, kanë qenë të banuara herët dhe gjurmë e dëshmi që na zbulojnë një gjë të tillë ka plot. Përsa i përket anës dokumentare i vetmi dokument, i cili, në fakt, paraqitet tepër i zbehtë, por që mund të hedhë sadopak dritë mbi popullësinë që e ka banuar Brezhdanin, është regjistrimi turk i Marsit 1467. Megjithëse të dhënat e dokumentit në fjalë janë tepër të zbehta, pasi në thelb ai nuk përbën një dokument tipik të gjendies civile, apo të regjistrimit të popullësisë, por një dokument empirik, ai na ndihmon të krijojmë një farë ideje mbi popullatën e asaj kohe. Hasen toponime disi të vietra si; Rruga e Duke, Varret e Kacane, Kroi i Çandrit, Kodra e Ruçe etj.

Është e kuptueshme se Dibra, si qendra e rezistencës Arbërore, zemra e Arbërisë, do të goditej më ashpër se sa çdo rajon tjetër. Në fakt, sipas pohimeve historikë, largimi i popullatës drejt brendësisë së vendit, drejt maleve, drejt jugut dhe drejt Italisë dhe Greqisë kishte kohë që kishte filluar. Me kalimin e kohës, në vendet e mbetura bosh, një popullatë e re filloi të vendosej dalëngadalë, duke pranuar, ku totalisht e ku pjesërisht, të tjera mendësi, të tjera mënyra jetese dhe pse jo edhe të tjera kultura nga ato të mëparëshmet, përfshirë këtu edhe atë të besimit. Është e qartë se në realitetin që u krijua, sidomos në rajonin e Dibrës, e cila, nga qendër rezistence dhe zemër e Arbërisë, u kthye në një tokë të zharritur e të zhuritur edhe popullësia që zhvendosej dhe mbivendosej, sillte rregulla dhe mendësi të reja nga trevat nga të cilat vinin dhe gradualisht filloi proçesi i kryqëzimeve kulturore duke dhënë e duke marrë nga njëri-tjetri. Popullsia që vinte nga piesët malore apo nga rrethe të tjera ishtë e tronditur, e pa organizuar dhe pa lidhje me njëra-tjetrën. Kështu pra rilindi një jetë e re, me një mendësi të ri, që përbëhej nga marrdhënie ritesh e kulturash, duke shkuar drejt kristalizimit të një kulture disi të përbashkët dhe të pranuar nga të gjitha palët. Fiset e mbivendosura filluan të krijonin lidhje fqinjësie dhe miqësie duke bërë hapat e para dreit integrimit social në një terren të ri. Megjithatë, ruaitia e emërtesave të vietra dëshmon për një zinxhir të pashkëputur lëviziesh demografike. Kur flitet p.sh për emërtesa të tilla si Rruga e Duke apo Varret e Kacane, është e vështirë të konstatohet se kur u larguan ata prej aty. Por një pikë kontakti me Kacanet, me të cilët lidhet edhe emërtesa "Varret e Kacanë", mund të gjendet, sa kohë që dihet se Kacanët, pasi u larguan që aty, u vendosën sipër në shpatin malor të Luznisë, në anën tjetër të Drinit të Zi. Arsyet e largimit të tyre nuk na jepen. U tha më sipër se këto emërtesa janë kryesisht të kohës para dhe gjatë pushtimeve osmane, pra, të shek.XIV-XVI. Po a ka gjurmë që të dëshmojnë për qytetërime ende më të herëshme në Brezhdan dhe rreth e rrotull? Kuptohet se këto periudha janë shumë më të vështira për t'u prekur, ashtu siç bëmë me këtë të fundit. Ata i përkasin një kohe shumë më të largët dhe gjurmet e tyre janë shumë më të vështira për t'u zbuluar.

Kalendar

Dibra 2012

... së shpejti në treg

Bëje kalendarin për biznesin tënd të personalizuar me pamje nga DIBRA.

Ofertë: ***100 copë - 200 lekë/ copa***
200 copë - 150 lekë / copa
300 copë - 130 lekë / copa

*** Nëse dëshironi të bëheni pjesë e kalendarit "Dibra 2012", kontaktoni në tel. 069 20 68 603 / (04) 22 33 283.**

Oferta për kalendarët e personalizuar priten deri më datë 10 dhjetor 2010

kujtesë

Pak radhë, për Habibe Shehun (Dervishi)

Gjithnjë e paharruar, mësuesja ime e parë…



Nga:
DESTAN RAMA

Në një ditë të bukur vjeshte, kur po medi toja me vete për vitet e shkuara të jetës sime në arsim, natyrshëm, m'u kujtua mësuesja e paharruar e klasës së parë, Habibe Shehu (Dervishi). Kështu dhe e ndieva detyrim timin moral e shpirtëror, që t'i shkruaja pak radhë për të, në këto festa të gëzuara të fundvitit.

Ja, edhe tani pas kaq vitesh, nuk më shqitet kurrë nga mendja portreti i saj, fizik dhe shpirtëror. Në atë kohë, ishte vajzë e re, me trup mesatar, me flokë të drejta e ngjyrë gështenjë, e shkathët, e dashur dhe tepër e afrueshme me ne, nxënësit. Veshja e saj e thjeshtë, estetike, ia shtonte ende më shumë bukurinë fizike.

Pra, ne e ndienim veten si të ishim vëllezërit, motrat ose fëmijët e saj. Me atë zërin e ëmbël e meliodioz na magjepste, na bënte të qendronim në bankë "gojëkyçur" e të përqendruar në mësim. Kërkonim që çdo fjalë të saj ta bënim pronën tonë.

Mësuese Habibe Shehu (Dervishi) u lind në Krajkë, të komunës së Zerqanit, në rrethin e Bulqizës, më 21 korrik 1937. Ishte nga një familje e madhe, e mirënjohur, pra e Dervishit të teqes së atij fshati, me tradita atdhetare e fetare. Në vendlindje ajo mori mësimet e para, ndërsa shkollën unike (7-vjeçare) e mbaroi në Zerqan. Ka qenë ndër vajzat e para dhe të pakta, e cila theu e prishi me guxim mendësitë dhe zakonet e vjetra prapanike në zonë, për vazhdimin e shkollës. Kjo bëri që, në vitin 1949-1950, ajo mbaroi shkollen unike, bashkë me dy shoqe të tjera nga Zerqani.

Duke u bazuar në rezultatet e larta, që arriti gjatë viteve të para të shkollimit dhe në nevojat e shumta për kuadro në arsim, Seksioni i Arsimit dhe i Kultures i rrethit Dibër, kërkoi që Habibja të kryente detyrën fisnike të mësueses dhe e emroi atë në fshatin Peladhi. Këtë gjë ajo e vlerësoi si nder, por dhe përgjegjësi të madhe për edukimin e mësimin e nxënësve të saj.

Me kalimin e viteve, pasi edhe u aftësua nga ana profesionale, kjo mësuese shërbeu me devotshmëri e pa u lodhur në disa fshatra të Grykës së Madhe, në krahinën e saj. Por viti më i bukur, më mbresëlenës për të, siç kujton edhe tani, ka qenë ai i 1958-ës . Në atë kohë, ajo u njoh me bashkëshortin Fadil Shehu, edhe ky mësues e së bashku punuan në fshatin Dushaj të Bulqizës.

Në bisedën, që bëra me Habiben, ajo kujton: "Në një ditë të bukur nëntori, si tani, kur po shkonim në shkollën e fshatit Dushaj, bashkë me Fadilin, u ndalua një makine "skodë", 5-6 metra përpara nesh. Doli shoferi dhe na foli. Për habinë tonë, ky ishte Ramazan Kthupi, nga Durresi, ish-mesuesi i gjuhës shqipe i klasës së 7-të, në Zerqan. U mallëngjyem, por edhe u kënaqëm, pasi pamë edhe një herë mësuesin tonë, pas 8 vitesh. U ndamë ashtu gjysmë të përlotur, duke i uruar njëri-tjetrit punë të mbarë e jetë të lumtur".

Në misionin e saj fisnik, mesuese Habibja pati gjithmonë në krah shokun e jetës, Fadilin. Ai nuk u kursye për t'i kryer detyrat prindërore, në mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre.

Gjate periudhës së shërbimit në arsim, pa u shkëputur nga puna, Habibja mbaroi vitet e shkollimit të plotë, si edhe kreu disa kurse kualifikimi, në Shkodër dhe në Peshkopi. Kështu, ajo u aftësua më tej dhe u bë specialiste e mirëfilltë në profesionin e mësimdhënëses, veçanërisht në punën me klasa kolektive.

Në çdo shkolle, ku u emërua, kjo mësuese punoi dhe u shërbeu me devotshmëri e përkushtim, nxënësve e fëmijëve të saj të dashur. Kjo bënte që përfundimet e arritura me ta, gjatë tërë viteve të punës, të ishin të larta. Por edhe në punën e saj edukatore kopshti mori vlerësimet më të larta, nga institucioni i arsimit të rrethit, drejtoria e shkollës, kolegët dhe prindërit. Për të gjitha këto, që përmendëm më sipër, gazeta lokale"Ushtima e Maleve", më 2 qershor 1984, në një shkrim të saj theksonte: "Bluzat e bardha-si bora, mjetet e bollshme e me kulturë dhe niveli i lartë i njohurive të fëmijëve, flisnin qartë për punën këmbëngulëse e me pasion të edukatores Habibe Shehu, në fshatin Zerqan. Mbi 90% e fëmijëve të këtij kopshti kishin një përgatitje të plotë, për në klasën e parë".

Urimet dhe falënderimet për mesuese Habiben, në punën e saj si mesuese, edukatore dhe veprimtare shoqerore, ishin të shumta atëhere, por janë edhe sot, kur ajo po gëzon vitet e pensionit.

Habibe Shehu

Brezat e nxënësve, që i ka pritur e përcjellur kjo mësuese e dashur dhe e paharruar, e kujtojnë me mjaft respekt e dashuri, si e para që u mësoi atyre lexim-shkrimin e gjuhës shqipe, me shumë durim, dashuri e pasion.

Megjithëse është e moshuar, sa herë vijnë 7-Marset, pra Ditët e Arsimit tonë Kombëtar dhe festa të tjera, mësuese Habiben do ta gjesh në mes të ish-nxënësve të saj, kolegëve e dashamirësve të dritës e diturisë. Ajo nuk i kursen kurrë këshillat e saj për brezat e rinj të mësuesve, që të përgatisin nxënës të ditur dhe të edukuar. Ata gjejnë tek ajo modelin e qetësisë dhe të dashurisë njerezore dhe, njëherësh, i urojne asaj të festojë me gëzim ngjarje të shunuara, sa të dojë vetë. Njëkohësisht, shprehin mendimin dhe besimin e plotë të tyre se, po të kishte patur konkurse në vitet, kur punonte në arsim, me siguri Habibja do ta kishte merituar vlerësimin "Mësuese Model".

Bulqizë, nëntor 2011

Risi

Edhe kanceri mund të shërohet

Një sëmundje e pashërueshme, që ka gllabëruar, artistë, politikanë të mëdhenj, artiste e shkencëtar në çdo kënd të botës. Por çudia e Doktorit Gjon Bokioti, qëndron në zevendësimin e *Mëlçisë kanceroze të Milena Koltrakës,* dhe ajo do të vahdojë jetën e sajë normale. Dot'iu buzëqesh çiltër nënës dhe babait duke iu dhuruar gëzim e lumturi të pakufishme.

Me shumë sakerfica, me shpenzime të s humta, brodhi familia Koltraka, nga Athina në Stamboll, duke kryer shume vizita e kryer analiza të shumta për të gjetur llojin e sëmundjes dhe diagnozën e sajë. Por mjeksia e këtyre vendeve nuk ishte në gjëndje të shëronte kancerin në mëlçinë e Milenës pesë vjeçare. Prindërit të stresuar, të dëshpruar deri në qelizën më të fundit të zemrës deri në dhimbjen më marramendëse të shpirtit, po treteshin si qiriu. Shpresa, guximi e optimizmi i tyre, i dërgoi ato tek Liri Berisha e cila nepermjet shoqatës''Fëmijët shqipetar Domenik Skalione,, dhe në bashkëpunim me doktorin Gjon Bokioti, i dhanë mundësi vogëlushes Milena që me gjashtë Qërshor të këtijë viti të shtrohej në spitalin Molinetë të Torinos.

Por kjo ndihmë për këtë femijë nuk ishte as e para dhe sipas tijë nuk do të jetë as e fundit, në shërimin e sëmundjeve të ndryshme patologjike, në ndërhyrjen kirurgjikale të natyrave të ndryshme , deri në ndërhyrje të tilla me shpëtim jete të fëmijëve shqiptar.

Kujdesimi i personelit sanitar, i vizitave e anlizave të ndryshme laboratorike, janë kryer me nje përkujdesje të mrekullueshme. Ndërhyrja kirurgjikale është kryer gratis sipas nje marrveshje të spitalit Molinet dhe Qarkut të Piemontes.

Ndërhyrja kirurgjikale, u krye nga Profesor Mauro Salizoni, drejtori i qendrës së trapiantimit (zëvendësimit) të organit të mëlçisë në spitalin Molinetë të Torinos në bashkëpunim me Doktorin Andrea Brunati, të cilët pas një pune të lodhshme me nerva të tendosura e me saktësi matematike arritën të heqin mëlqine e kancerosur e të vendosin atë të renë. Pervoja e tyre në këtë fushë është e madhe, ishte e njëqindëta kjo e vogëlushes Sinjane Milena.

Duhet të theksojme se vashëza dibrane ka qenë e shtruar në repartin Gastroenterologjikë, në spitalin Mbreteresha Margarita , nën kujdesin e vazhdueshëm te profesoreshës Cristina Barbera.

Shpëtoi jeta e një fëmije, e cila në vendin e saj të lindjes nuk mund të kryhej, thuhet në nje kmunikate zyrtare të spitalit, një ndërhyrje e tillë, por shteti italian i krijoji mundësi që fëmijës ti kryheshin të gjitha shërbimet dhe ti shpëtohej jeta. Ajo do të jetë nën vezhgimin e mjekëve dhe të profesorëve akoma edhe gjashtë muaj.

Gëzimi i shpëtimit të jetës së Melenës pesë vjeçare rrezatoi tallaze gëzimi te të gjithë të afërmit e Dashamirit, te shoqëria dhe te Sinjanët dhe ja se si shkruan në një mesazh njëri prej tyre: *''Së pari më gëzove pa masë me lajmin që më solle mbi suksesin e operazinit që iu ba në spitalin Molinetë. Pra Milena shpëtoi, juve familerisht keni rilindur. Mos u prek se edhe unë jam prind, pra edhe unë kam rilindur. Të gjithë do të gëzohen sa ta marrin vesh.*

Iu faleminderit që më dhuruat emozione të pa dimensionshme. Milena do të vazhdoi jetën normale, do të loz e dhuroi buzëqeshjen , dot'iu ledhatoi me dorçkat e njoma. Lexova gjithë komunikatën në lidhje me këtë trapiantim dhe me këtë rast unë shtegëtari shqiptar,i falenderoi megjithë zemer profesorët,doktorët dhe gjithe personelin e shërbimit, për kulturën e larte dhe përkujdesjen njerëzore e të kulturshme që kanë treguar. Këto mendime mund t'iua kmunikoni atyre. Se ato janë Zeusët e rinj që rizzgjojnë shpirtërat. Me guximin në shpirt, dhe me shikimin përpara jeta do të bëhet më e bukur e kopsht lumturie familiare. Urime të pafundme……,,

Dhe me të drejtë familia Koltrka gurgullon falenderimet për gjithë personelim mjeksor sanitar:

''…….u emocionova kur lexova mesazhin tuaj, nuk mund të gjejë fjalë që të përshkruaj shërbimin që i është bërë vajzës time. Duke filluar nga infermieria më e thjeshtë dhe deri tek stafi i doktorëve të Milenit(që ishin mbi dhjetë). Mblidheshin çdo orë dhe diskutonin me njëri tjetrin. Këto janë njerëzt e zotit që i ka sjellë në tokë për të shpëtuar jetë njerëzish. Janë të rralle në planetin tonë njerëz të tillë, Përqafime!,,

SELMAN MEZIU

www.rrugaearberit.com
online
Tel. (04) 22 33 283. E-mail: rrugaearberit@gmail.com.

Rruga Arbërit nr. 67

opinion

Të vdesësh për të jetuar

Nga: **AQIF KARAJ**

Bulqiza është një krahinë e njo hur në defterin turk të viti 1467. Ajo ka zhvilluar beteja për jetë a vdekje, që me udhëheqësin legjendar të viteve 1443-1468 Skënderbeun. Zëri i saj ka shkuar deri në Stamboll, për betejat e saj shekullore nga 1443-1912 e deri në ditët e sotme. Ajo ka luftuar dhe ka nxjerrë mësime të shumta nga brezi në brez, nga luftërat e punët e saj për të mbijetuar. Ajo ka mbrojtur trojet e saj dhe më gjerë, duke luftuar përkrahë trimave dibranë dhe atyre shqiptarë për të mbrojtur nderin dhe kunarin e dibranit dhe të kombit shqiptar. Bulqizaku është ndeshur fytafyt me pushtuesit turq, me pushtuesit serbë me ato bullgar, me austrohungarezët me pushtuesit italianë e gjerman që në vitet 1920 dhe ato të Luftës së Dytë Botërore. Bulqizakët (dibranët) e gjithë shqiptarët në këto luftëra shekullore, të pabarabarta, sakrifikuese e trimërore, janë udhëhequr nga prijësit popullor, trima, punëtorë dhe të mençur, Fezë Canga, Dalip Karaj, Salë Markja, Lam Daci, Hoxhë Moglica, Dan Cami, Halit Lleshi, Haxhi Lleshi, Aqif Lleshi, Mersim Dema, Sheh Mustafa e Sheh Sula i Zerqanit, Mehmet Duriçi etj. Këto burra u vunë në ballë të rezistencës, në udhëheqje të popullsisë deri në shpalljen e pavarësisë në vitin 1912 dhe çlirimin e vendit nga nazifashistët 29 nëntor 1944.

Populli edhe sot u këndon:

Dibra ka djem me huqe,

Këmishën e zezë ta bëjnë të kuqe.

Kjo zonë ka nxjerrë shumë mësime nga vuajtjet dhe varfëria e tejskajshme në shekuj… Ajo nuk mundë të gënjehet prapë, siç u gënjye për 63 vjet të diktaturës, që i jepte të shtetit mbi 40% të buxhetit dhe merrte 3 lekë në ditë. Zëri i tyre as atëherë dhe as sot nuk po dëgjohet?! Ata i kanë dhënë Shqipërisë qindra milionë ton krom të cilësisë së lartë. Ata kanë dhënë jetën e tyre në këtë minierë për të jetuar. Mbi 200 punëtorë kanë ngelur në gërmadhat e këtyre galerive, për faj të drejtuesve të atëhershëm dhe sot?! Asnjëri nuk është dënuar për këto shkelje dhe tragjedi të shumta në këtë minierë?! Vetëm për vitet 2009-2011 janë vrarë mbi 20 ... Ata e kanë lidhur jetën e tyre dhe të familjeve me punën e vështirë të kësaj miniere ku paguhen shumë pak?! Kromi dhe miniera janë pasuria e tyre, ajo është jeta e tyre, e ardhmja e tyre, që nga 18 shkurti i vitit 1948. Ata janë shumë të vendosur që këtë pasuri kombëtare ta ruajnë me jetën e tyre, me çdo çmim... Edhe pas vitit 1990, bulqizakët janë shquar për kulturë e nuhatje politike. Ata kanë përkrahur pa rezerva lëvizjet politike për një demokraci të drejtë e të ndershme...

Ata përfaqësuan, pa rezerva ekonominë e tregut dhe integrimin euroatlantikë të vendit. Tani edhe pse ata i ka lodhur tranzicioni i stërgjatur, po përkrahin të gjitha reformat në fushën ekonomike si privatizimin, koncesionet etj me qëllim që edhe për ata të vijnë ditë më të mira, si për minatorët e familjet e fëmijët e tyre. Në shtetet e tjera të Europës, SHBA, Azia etj., punëtorët e nëntokës punojnë 10-15 vjet dhe sigurojnë jetën e tyre familjare për 3-4 breza, kurse minatorët shqiptarë po punojnë nga 63 vjet dhe nuk po sigurojnë as bukën e gojës, e jo më brezat e ardhshëm e fëmijët e tyre me shkolla, profesione, makina, shtëpi luksoze e një jetë të lumtur familjare. Të gjitha këto për faj të qeverive të më pashme dhe të sotme! Ata nuk mund ta pranojnë, që, përsëri të jemi më të varfrit e Shqipërisë, të cilët mjaft janë robtuar, mjaft janë shfrytëzuar si skllevër të cilët po vdesin për të jetuar?! Ata marrin një pagë minimale?! Një pension minimal?! Mungon infrastruktura e punës dhe lagjet e zonat ku banojnë. Mungon sigurimi i jetës së tyre, sigurimi teknik, mungojnë rrugët e uji i pijshëm, fjetoret, mensat, transporti, strehimi, kinemaja, teatri, fushat sportive, arti, kultura, arsimi, shëndetësia, personeli shëndetësor etj. Qeverisja qendrore e vendore, as nuk duan tía dinë. Çdo gjë bëhet me dashje si korrupsioni, vjedhjet, shkatërimet, droga, prostitucioni, mashtrimi, gënjeshtra. Shfrytëzimi është ulur këmbëkryq në të gjitha fushat, duke shfrytëzuar në maksimum punëtorët e nëntokës?! Qeveritarët vendorë e qëndrorë, vijnë në Bulqizë për të vjedhur dhe për të marrë votat?!

Bulqizakët ecin mbi flori, me këmbëzbathur e barkun bosh. Asnjeri nuk i përkrah, bile edhe moshën e punonjësit nga 50 vjeç, ua bënë 65, nga 5-6 mijë punëtorë kanë ngelur 700 veta?! Ku do hanë, ku do punojnë këto familje?! Ata kanë që në vitin 2007 që bëjnë greva e demonstrata, asnjëri nuk nuk i mbështet, as ministria, as bashkua, grevat e tyre i quajnë greva politike! Ata kanë 4 muaj në greva e demonstrata, të cilët as nuk janë paguar, familjet e tyre po jetojnë me borxhe? Cila është perspektiva e kësaj miniere?! Çdo bëhet me këto 42.000 banorë?! Ku do të shkojnë po të mos modernizohet kjo pasuri e madhe kombëtare jetike për shtetin dhe zonën e Bulqizës, Dibrës, Mirditës, Matit e gjithë shqiptarëve që jetojnë këtu, prej 50 vjetësh?! Ata janë të detyruar të kërkojnë të drejtat e tyre deri në flijimin e jetës së tyre dhe të familjeve të tyre, për deri sa shteti nuk po bën asgjë për përmirësimin e jetës e punës së tyre. Rruga që ndjek qeveria qendrore për pasuritë e saj të nëntokës është e gabuar, ajo është në dëm të popullit të gjitha fushat përfshi dhe bujqësinë, blegtorinë, turizmin, alpetrolin, energjinë, pyjet etj. prandaj shteti jonë është i varfër dhe me këto metoda pune, me këto marrëdhënie midis punëdhënësit, punëmarrësit qoftë me shtetin, me privatet, me shtetet e tjera, ku njerëzit punojnë në të zezë, janë të papunë, paguhen pak, jeta, puna, prona nuk janë të sigurta. Çdo gjë merret nga jashtë, toka është e pa punuar , nuk ka stimul, konkurrencë në asnjë fushë, nuk ka shpërblim. Investimet mungojnë në të gjitha fushat, rendimentet, cilësia lë shumë për të dëshiruar, jo ... infrastruktura, uji për vaditje, kanalizimet, djegia dhe shkatërrimi i pyjeve po e çojnë Shqipërinë e shqiptarët në një varfëri të tejskajshme... E gjithë kjo pasuri kombëtare po shkatërrohet, por nuk po i fiton vlerat e mëdha të saj, po shkojnë në xhepat e pushtetarëve dhe të firmave private?! A e dinë minatorët e Bulqizës se sa lek merr një minator në Austri, Gjermani, SHBA, Azi, madje dhe në vendet fqinje me Shqipërinë. 3,4,5, mijë euro në muaj, kurse punëtorët e minierave në Shqipëri marrin 300-400 mijë lekë. Pse? Se Shqipëria i ka shitur minierat, H/C, ujëvarat, pronat etj. ajo ka hyrë borxh tek shtetet e tjera, si A. Z. Në kohën e tyre. Ajo shumë punë të kryera nga firmat i ka të paguara?! Të gjitha këto e shumë të tjera po e çojnë Shqipërinë në një varfëri të madhe. Thuhet se po ngrenë rrogat e pensionet 400-500 lekë në muaj, kurse çmimet, uji, dritat, gazi, buka, drutë e zjarrit etj., janë shtuar mbi 5000 lekë në muaj për një familje 2-3 veta. Emigrantët që kanë mbajtur gjallë familjet e tyre në Shqipëri, nuk po sjellin më lek, ata po kthehen nga emigrimi pa lekë. Në Shqipëri nuk punë për to! pronat nuk kanë shkuar tek i zoti, tufat e blegtorisë janë zhdukur, fermat bujqësore e blegtorale janë lënë pas dore, vreshtat, ullishtet, pemëtaria, pothuajse nuk prodhojnë asgjë ose shumë pak 1, 2, 3 muaj. Shqipëria i ka të gjitha mundësitë t'i sigurojë vetë e jo t'i blejë të gjitha nga jashtë, deri tek qepa e patatja. Shqipëria mund të krijojë ferma bujqësore e blegtorale, pemëtari. Vreshta e N. B. Të fuqishme, sa të furnizojë gjithë Ballkanin, me mish, vezë, mollë, rrush, pijë alkoolike, duhan, vajra ushqimor, qepë, patate dhe nga të gjitha llojet e frutave e perimeve.

A e dinë shqiptarët se të gjithë punonjësit e nëntokës flenë me vdekjen! Vdekja për ta nuk është fjalë e huaj, për këta heronj të nëntokës! Ata kur futen në galeri i thonë njëri-tjetrit: "Dalshi shëndosh" ose kur dalin: "Shyqyr që dolët shëndoshë". Ato po punojnë kur të munden familjarisht megjithëse në pension, të lodhur, të këputur, të duken sikur janë 100 vjeç prapë, me gjithë familje, fëmijë, ata shkojnë në përrenjtë e stoqet e gurit të keq, për të mbledhur 10 kg krom, që ua shesin privatëve me 3-5 lekë kg, ku privatët, matrapazët e shesin 10-20 lek kg?! Kapitalisti i huaj është pronar në minierat, naftën, H/C rrugët, tokën tonë ai pasurohet në kurriz të minatorëve e pasuri nëntokësore të Shqipërisë. Bashkia, ministria, sindikatat, kuadrot e drejtuesit tonë, janë të paaftë dhe të pazotët për të kundërshtuar qeverinë e pronarët e huaj, që vijnë e pasurohen në Bulqizë?! Shteti shqiptar nuk është i aftë për t'u përballur me këta shfrytëzues të klasës punëtore të Shqipërisë. Prandaj perspektiva e kësaj miniere është e errët?! Bulqiza është kthyer në një ndërmarrje karrakatinë, që po shfrytëzohet nga të huajt. Të gjitha rezervat janë zbuluar para 20 vjetësh! Ata shohin vetëm interesat e tyre, e jo të drejtat dhe interesat e perspektivës të minierës, minatorëve. Në Shqipëri janë vënë në krye të detyrave, të paaftët dhe hajdutët, që nga ministria e Ekonomisë deri në kryesinë e bashkisë së Bulqizës e firmat e ACR. Sindikatat, minatorët e familjet e tyre të hekurt për të mbrojtur këtë pasuri kombëtare. Këto vende pune dhe të drejtat e tyre për një jetë më të mirë në këto zona shumë të varfra. Në Bulqizë ka mbi 10 vjet që nuk po kryhen investime, të gjitha këto për faj të qeverisë qendrore, të hajdutëve vendas e të huaj. Rezervat e zbuluara para 20 vjetëve po mbarohen, tani duhen vite për t'i zbuluar e nxjerrë rezervat e tjera, në qoftë se ka?! Kapaciteti prodhues ka zbritur nga 200.000 tonë në 80.000 ton në vit.

Qeveria shqiptare nuk po e vlerëson krizën botërore në vend dhe në shtetet fqinje, si Greqia, Italia e shumë shtete të tjera në të gjithë globin?! Papunësia në vend, të miliona njerëzve, përfshi dhe 20 mijë emigrantë që po kthehen nga shtetet fqinje, pa një lek në xhep. Ngritjen e çmimeve të artikujve ushqimor, të karburanteve, gazit, energjisë elektrike, druve të zjarrit, ujit të pijshëm e për vaditje, mos punimin e tokave bujqësore, zhdukja e tufave të bagëtive, djegia e shkatërrimi i pyjeve e drufrutoreve mos zbulimi dhe shfrytëzimi i keq i prodhimeve nëntokësore të mineraleve të kromit, bakrit, qymyreve, serës, mermerëve etj., po e varfërojnë popullsinë shqiptare, pa përmendur fatkeqësitë natyrore që vit pas viti, po shkatërrojnë ekonominë e shumë vendeve, përfshi dhe Shqipërinë. Kjo qeveri ka harruar ngrohjen globale, stuhitë, fortunat, rritjen e nivelit të detyrave, lumenjve përrenjve, siç ndodhën në Shkodër-Lezhë. Sëmundjet e pashërueshme, aksidentet, gjakmarrje, ku vdesin mbi 10 veta çdo ditë. Dëmtimin dhe rënien e prodhimeve bujqësore e blegtorale, të mineraleve nëntokësore. Po mbyllen qindra biznese, uzina e fabrika në të gjithë botën, qindra miliona të papunë. Miliarda të tjerë po vdesin nga mungesa e ushqimeve dhe ilaçeve, e kujdesi shëndetësor... Të gjitha këto fatkeqësi vijnë nga natyra dhe qeveritë e paafta, që nuk dinte të menaxhojnë ekonominë e vendeve të tyre, siç ndodhi në Shqipëri. E mjera Shqipëri, të mjerët minatorë, çfarë fatkeqësie i pret, duke lënë jetën e tyre në galeritë e nëntokës, për një copë bukë, duke vdekur për të jetua... Ata ishin e ngelën të varfër edhe pas vitit 1990, ku premtimet janë boshë në të gjitha fushat. Pa industri, pa bujqësi të zhvilluar nuk ka rritje të mirëqenies së kombit Shqiptar si gjithë Europa. Është pak 100.000 lekë në muaj paga e tyre dhe 50.000 pensioni i punonjësve të nëntokës... Këto qeveri duhet të japin dorëheqjen një orë e më parë. Ndryshe vendi po shkon në një gjendje më të varfër se para vitit 1990.

Sindikata, të rinjtë, gjithë populli duhet të marrin frenat e pushtetit, e jo partitë politike, vjedhje të tyre për 20 vet. Kur do të realizohen ëndrrat e këtij populli fukara?! Pozita dhe opozita nuk dëgjojnë zërin e popullit. Kërkesat e tyre ata nuk merren vesh me njëra-tjetrën për 20 vjet?! Të gjitha këto, po e lënë Shqipërinë, pa u futur në gjirin e ngrohtë të BE. Shqipëria po ngelet e varfër...

Për opinione dhe komente mund të na shkruani në adresën: "rrugaearberit@gmail.com". Tel. 00355 4 22 33 283.

OPINIONET DHE KOMENTET E BOTUARA NUK SHPREHIN DOMOSDOSHMËRISHT QËNDRIMIN E REDAKSISË

homazh

Lamtumirë, o njeriu ynë i mirë, Destan Kaloshi

Si gjethet e zverdhura në vjeshtë...

Ja, e tillë qenka jeta!

Plot mistere e të papritura!

Sa më shumë ikin vitet aq më tepër bindemi se jemi në zona të minuara keq dhe nga çasti në çast mund të fluturojmë e të ç'bëhemi sikur të mos kishim qenë.

Megjithatë sikur jemi mësuar kësaj rruge e ia kemi marrë dorën, e ecim, e ecim mospërfillës, të sigurtë se do të bëjmë edhe shumë. Kështu ua thonë të afërmit e të dashurit, kështu ia bëjmë qejfin edhe vetes, edhe pse e dimë mirë se jemi mysafir në këtë botë, se jemi të vdekshëm, se kemi kaluar një jetë me shumë halle e vuajtje, se jemi si ato gjethet e zverdhura në vjeshtë që janë të hapur fort pas degëve e u është mbushur mendja, se do ta hedhin edhe këtë dimër...

Veç mjafton një erë e fortë, murra me shi dhe të gjitha gjethet bien mbi tokë.

Kështu ndodhi edhe me Bajram Hysenin e mirë, poetin e njohur, këngëtarin e 9 maleve të, ... e madh, atë njeri të njohur, gati të harruar nga diktatura e zezë. Sa herë e kisha bërë mend t'shkoja e të ndërroja dy fjalë me të, po s'qe e thënë. U ftik si yjet në qiell me zbardhjen e ditës së re. Kështu u shua edhe Vasillaq Vangjeli, aktori i madh Luftulla Çeka, reumatologu i shquar e zemërbardhë, Tan Deljana, kardiologu virtuoz, i biri i ish-ministrit të arsimti Thoma Deljana.

Kështu ndodhi edhe me Destan Kaloshin e Sinës, djalin e Mehmet Kaloshit të mirënjohur, xhaxhai im i paharruar, ish-asprirant shembullor, ish-arkivi i gjallë, ish-djali i xhaxhait tim, që na preu në besë, na e la pushkën për syri, mua sidomos e shumëtë tjerëve të afërm e të dashur, miq e shokë, bashkëvuajtës e të njohur.

Kur më erdhi haberi se më kërkonte Destani ngaqë e kishte marrë malli për mua, u bëra gati të nisesha menjëherë, po vdekja e gruas së Eminit ma smbrapsi rrugën. Pas varrimit të Minës s'bën pas përcjelljes në varreza të dushkut. Më ndodhën edhe vaki të tjera, kur.. më lajmëruan.

Destani vdiq!

Më dhimbti zemra! Peng do ta kem gjithë jetën që s'munda të çmallem me të, të kuvendonin siç kemi bërë një jetë, të kujtonim të mira e të këqija në këtë botë nallane.

Peng, peng i madh!

Nga shpirti m'u derdhën vargjet bashkë me lotët:
Destan, Destan, o vëllai im shumë i mirë.
Jeta jote Odise, sa pak dritë, sa shumë errësirë
Burgje e vuajtje, tmerre, avap me shpirtin
Zemra jote e bardhë, shpirti yt më i delikti
Vëllai im i dashur Destan, ku je, ku të kam
T'lodhi jeta? Të mërziten? S'ngrihesh në kambë?
T'u ndal zemra? S'e besoj! Do të rrosh edhe më
Ba gajret Destan i shtrenjtë.
Të kam dashur e të dua sa t'kem jetë
Je Destan Kaloshi im, je dibran i vërtet...

Por Destan Kaloshi, si shenjtor, pa prit e kujtuar, bie, për të mos u ngrirut më, i ngriu gjaku me zemër, e la fryma e fundit. Shpirti i tij fluturoi në qiell ndërsa trupi i tij i gjatë, i thante, i tretur, i vendosur në arkivol, po përgatitej të çohej në krahë e në makinë në varreza për t'u prehur përgjithmonë në tokën shqiptare. Fëmijët e Destanit, fytyrë pikërlluar e zemër plasur, nipat e mbesat, kushërinj e kushërira, miq e dashamirë krijojnë deri në ritet e kësaj përcjellje të dhimbshme. Numri i pjesëmarrësve në këtë ceremoni qe i madh nga Tirana e Dibra, nga Fushë-Kruja e Kruja...

Vdekja, xhelaja e pamëshirshme, e pandjeshme, e verbër, e uritur, trokiti vrazhdë në derën e shpirtit të Destanit Kaloshit dhe e grabiti si një korb i zi, duke lënë vetëm trupin e tij të pajetë.

Burrat e mirë dibranë e nga rrethe të tjera s'vunë shaminë e zezë po prisnin e përcillnin njerëzit, sipas zakoneve malësore, shoqëruar me kafe... e biseda, që lidheshin me kësi vakirash, duke përcjellë mesazhe, përmbajtje, sabri e duke u dhënë porosi më të rinjve që t'i ngjanin Destan Kaloshit në virtyte e në të mira.

Destan Kaloshi, nga fisi i shquar i Kaloshëve të Dibrës e Shqipërisë ka qenë atdhetar. Kaloshët e parë në shekuj janë shquar në luftë kundër turqve, serbo-malazezëve e pushtuesve nazi-fashistë në Luftën e Dytë Botërore. Nga kjo derë fisnike janë dalluar burra t ëmëdhenj, Avdi Kaloshi, Murat Kaloshi, Miftar Mane Kaloshi, Arif Xhetan Kaloshi, Selim Xhetan...

Destan Kaloshi lindi në Sinë të poshtme më 1920. Fëmijërinë dhe rininë e kaloi në vendlindje. Mësimet e fillores i kreu në Arras. Më pas kreu edhe një shkollë xhandarmërie nga e cila doli me gradën aspirant. Qe nacionalist i deklaruar dhe gjetkë jeta e tij e pasur, e gjatë (91 vjeçare) e vërteton më së miri. Ka qenë krauh i djathtë, Mehmet Kaloshit e një nga trimat më besnik të tij në Gostivar, ku Mehmeti ishte ishte zv. Rrethkomandant qarku deri në vitin 2000. Kur Mehmet Kaloshi ndërroi jetë, ruajtën dashurinë e thellë për njëritjetrin, respektin më të madh dhe nderimin në shkallën më të lartë. Më pas vendin e Mehmet Kaloshit e zuri autori i këtyre rradhëve si dhe dy djemtë e tjerë të Mehmetit, Irfani e Kadriu që aktualisht ndodhen në Amerikën e përtej oqeanit dhe s'arritën të ishin prezent në lamtumirën e fundit.

Shteti diktatorial i Enver Hoxhës, dora e shtrirë e sllavokomunistëve serbo-malazeze bëri name mbi Kaloshët e familje të tjera të mëdha nga e gjithë Shqipëria. Edhe Destani u burgos e vuajte në burgjet e egra e të zeza të diktaturës në Tiranë më parë e në Peshkopi më pas.

Pas daljes nga burgu Destan Kaloshi iu përkushtua familjes e fëmijëve me merakun që t'i rris e t'i ormis siç e kërkonte origjina e zemra e bardhë e tij.

Destan Kaloshi ka qenë një njeri i ditur dhe i shkathët, i ndershëm dhe i pastër, që ia dinte rendin burrërisë. Vërtet kishte vetëm arsimin fillor e atë të xhandarmërisë që e bëri aspirant, po shkolla e vërtetë e tij nisi që në fillimet e jetës së tij nga mësuesit e pazëvendësueshëm të tij: nënë Vera dhe babai Mexhit Kaloshi. Më pas veç shkollave që zumë në gojë, qe dhe oda e famshme dibrane, universiteti i Çidhnës e i Dibrës, akademia e Kaloshëve të Çidhnës që ka nxjerrë gjeneralë e majorë me vlera të rralla.

Në tetor të këtij viti u botua libri im i dytë "Amaneti". Një zë i veçantë është edhe nëntitulli "Destan Kaloshi – ish-aspiranti, arkiv i gjallë. E kush e mendonte se Destani s'do të arrinte dot ta mbaronte së lexuari. Djali i tij, Shemsiu, tregon se pjesën që fliste për të e lexoi dhe u mbushën sytë me lot. "Të vërtetat ka shkruar Veri – tha – gjithmonë me ka parë me sytë e dashurisë e, as në këtë shkrim s'ka bërë përjashtim pa ndryshme...

Destan Kaloshi deri në ditët e fundit të jetës së tij që i fortë, me sy e me veshë, me këmbë e me duar mendjekthjelltë e me kujtesë të shkëlqyer. Njeri me ndjenja të pastra, e drejtë, i çiltër, trim, i papërkulur nga vuajtjet, hallet, shqetësimet, vetëmohues, shumë i ndjeshëm ndaj padrejtësive e veseve, principial, me norma, me parime, i papajtueshëm me këto tek i cili shfaqet e liga, e pandershmja, vesi. Cilido qoftë ai. Sado i afërt qoftë ai!

Jo rrallë edhe shkruante për ngjarje që i kishte jetuar e njerëz që i kishte njohur. Kujtimet e Destanit janë të vyera. Një pjesë të vogël m'ka dhënë e dha mua për t'parë, i kam shfrytëzuar për librin "Amaneti".

Humbi jeta? Fitoi vdekja?

E vërtetë. Humbi jeta e Destan Kaloshit. Fizikisht ai s'do të jetë midis nesh. Do të ndërroj banesë përgjithmonë. Banesa e tij e fundit do të jetë në Tufinë. S'do t'ia dëgjojnë më zërin, veç në e paçim të regjistruar në "magnetofon". Lus që fëmijët ta kenë filmuar. Sidoqë të jetë Destani do të rrojë gjatë në zemrat e njerëzve të tij të dashur. Kujtesa e të gjithëve do ta ruajë Destanin dhe do të zhvillojë me të bisedë në distancë. Shpirti I tij do të na kumtojë mirësi e virtyte. Fjalët e tij do të kthehen në proverba. Veprimet e qëndrimet e tij do të kthehen në legjenda e pika referimi sa herë të na e lyp rasti. Të ishte Destan Kaloshi gjallë, do të vepronte kështu, jo ndryshe. Destan Kaloshi thoshte një fjalë.

Jam i sigurt se jeta dhe vepra e tij do të jetë shembull për fëmijët, së pari e për të gjithë të afërmit, miqtë e dashamirët.

Trupi i pajetë i Destan Kaloshit u muar në krah nga të gjithë djemtë e kushërinjve dhe u vendos në arkivarr, pasi i vendosën dorën në ballin e ftohtë në atë fytyrë, së cilës, i kishte rënë një nur i bukur.

Prekëse, shumë e dhimbshme që momenti kur arkivoli u vendos në banesën e fundit. U mbajtën fjalët e fundit të lamtumirës nga miq e të afërt. Sadedin Balla, motra e të cilit është martuar me djalin e Destanit, Bashkimin, i mirënjohur nga shumë kush, foli me ndjenjë e dhimbje. Midis të tjerave Sadedini tha: "Fatmirësisht Destani pati një jetë të gjatë. Me plot vështirësi e taksirate, por Destani i kaloi të gjitha sfidat me faqe të bardhë, duke u shfaqur në çdo rast një Kalosh i vërtetë 24 karat. Faqebardhë e Kalosh 24 karat u shfaq edhe në tetor të vitit 1944 kur rrethanat e sollën të binte në duart e komunsitëve, të mbarsur me sllavokomunizëm barbar. Njëri prej tyre, qe ish-komandant i tyre i thotë: "E kemi kërkuar në qiell një Kalosh e tash na vjen në tokë!". Nis të shajë e të bërtasë me mllef e mëri, ia vuri revolen në ballë e i tha: "së shpejti do të të var".

- Mos bre burrë, se je shqiptar – i tha Destani – s'të ka hije kështu me sha, po ta them troç, jam kundër jush, n'daç më vrit, e n'daç më var në litar!

Jeta e Destan Kaloshit, - vazhdoi më pas Sadedin Balla – është brilante në vazhdimësi... Shumë vështirësi, sprova të rënda ku lypej burrëri, durim, zgjuarsi, trimëri, virtyte. Edhe pse provoi në fillim burgun, më pas skamjen, përçmimin, provokimet e lloj-lloj përçudnimesh që komunizmi aplikoi në Shqipëri. Por, ajo qenie e gjatë dhe e thatë, kockë e lëkurë, mbante brenda saj një shpirt të madh, të paepur, që çudiste, i acaronte, i nervozonte e i skandalizonte pushtetarët zollumqarë që s'mundën ta thyenin Destan Kaloshin, i cili s'pranoi kurrë t'u shërbente. Destani e gjeti bukurinë e jetës duke krijuar familje e duke lindur e rritur një tufë fëmijë me edukatë, me besë, burrëri e fisnikëri, me shpresë se fëmijët do të ndjekin rrugën e tij, madje më mirë se ai.

Kryemyftiu i Dibrës Ruzhdi Lata thotë: "Në emër të Dibrës së Madhe shpesh mirënjohjen e fisit të Kaloshëve në Dibër e në Shqipëri. Kur është njeriu i pavdekshëm? - Kur shkruan libër – bën bamirësi – le fëmijë që e nderojnë."

U mbajt një minutë heshtje dhe më pas njëra nga mbesat, Anxhela, 16 vjeçe, në emër të Brunës, Danjelës, Xhulit, Gertit, Renatos, Xhonit, Raldit, Nevilës, Andres, Andit dhe Kleos, me lot në sy, me zërin që i dridhej, duke i bërë edhe të pranishmit të derdhin lot, recitoi:

O gjysh,
Kjo fjalë bën të lumtur çdo fëmijë
Shohim vendin ku qëndroje ti
Ne të kemi në zemër të gjithë, o gjyshi ynë
Kurrë s'do të harrojmë, asgjë tënden, s'e harrojmë
Në gjumë dhe zgjuar do të të kujtojmë
Flokët e bardhë borë të tuat shikojmë
Rrudhat e thella në fytyrë – shenja vuajtje
Pse o gjysh i dashur, na le, pranon lutje
I lutemi zotit në qiell të t'i çeli sytë
Je më i dashuri në botë, si ty s'ka të dytë
Të shohim duke u endur i qetë në shtëpi
Kujtojmë tregimet e moçme që na i tregoje ti
Të ndjejmë kur kuvendoje me t'afërm, me miq
Sa i merrje inat të këqinjtë, njerëzit e liq
Çdo gjë e jotja është e mirë, ah, gjysh, ah
Të shohim ngado, edhe kur luaje shah
I ndjejmë në shpirt të ëmblat përkëdheli
Shëtitjet me ty në park, çokollata na bleje ti
Sa do të na mungojnë trokitjet e shkopit tënd
Ti ishe jeta jonë, ti je në çdo vend
T'betohemi, o gjysh, me ç'kemi n'botë më të shenjtë
Do t'ndjekim mësimet e tua, do t'dëgjojmë me të
O gjysh, o gjysh, ç'na bëre? Na lë vetëm
Sa do të na mungosh, o gjysh, bosh janë zemrat
Ja n'këtë vjershë të thjeshtë janë të gjithë emrat
Bruna, Danjela e Xhuli, Gerti, Reni e Xheni
Raleli, Nevila e Andro, Andi e Kleo
Jemi krenar për ty, o gjyshi më i mirë në botë
N'emër të gjithë këtyre: s'të harrojmë Anxhela
të thotë.

ENVER KALOSHI

Njoftim për bashkëpunëtorët

Të nderuar bashkëpunëtorë

Prej muajsh, redaksia ruan në arkivin për botim disa materiale, të cilat po të botohen zënë një hapësirë prej 2 ose më shumë faqesh.

Për këtë arsye, redaksia e gazetës "Rruga e Arbërit" njofton gjithë bashkëpunëtorë e saj, se shkrimet që sillen për t'u botuar, duhet të jenë jo më shumë se 5 faqe të daktilografuara (përafërsisht 10000 mijë karaktere, pa përfshirë hapësirat). Materialet që vijnë me email ose në çdo lloj forme elektronike, duhet të jenë në **Word**, me fontin **Times New Roman**, të madhësisë **12pt** dhe me hapësirë **1.5**. Gjithashtu, kujtojmë se materialet e pranuara në formë elektronike duhet të kenë patjetër germat **"ë"** dhe **"ç"**.

Çdo material i gjatë do ti nënshkrohet redaktimit dhe shkurtimit për tu botuar në versionin e shtypur të gazetës. Versioni i pa shkurtuar do të botohet çdo muaj në internet në adresën: www.rrugaearberit.com. Autorët mund ti shkurtojnë vetë shkrimet dhe të na i përcjellin në redaksi me dy versione botimi: **për gazetë** dhe **për internet**.

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, ju përcjellim konsideratat më të mira të redaksisë për bashkëpunimin e deritanishëm..

Për sqarime më të hollësishme mund të na kontaktoni me email në adresën <rrugaearberit@gmail.com> ose në tel. 069 20 68 603.

REDAKSIA.

Biblioteka e autorëve dibranë*



Këto dhe shumë botime të tjera të autorëve dibranë mund t'i gjeni pranë librarisë "M&B"

Adresa: Rruga "Zenel Baboci", Pall. Ferar, Tiranë (Pranë Selvisë)
Tel. 00355 4 22 33 283.
Cel. 069 20 68 603
e-mail: mbbotime@gmail.com

-20%

* Janë reklamuar vetëm botimet që mund t'i gjeni pranë librarisë "M&B"